

ODDNÝ EIR

**VENDI I DASHURISË
DHE I RRËNOJAVE**

Përktheu: Xhimi Lazri

SHTËPIA BOTUESE “FAN NOLI”
TIRANË, 2017

ODDNÝ EIR
Jarðnæði

Copyright © 2007 by Jón Kalman Stefánsson
Published by agreement with Leonhardt & Høier Literary
Agency A/S, Copenhagen
© i botimit shqip “Fan Noli”



Co-funded by the
Creative Europe Programme
of the European Union

“This project has been funded with support from the European Commission. This publication reflects the views only of the author, and the Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein.”


**Ky projekt u mundësua me mbështetjen e Komisionit European.
Ky publikim reflekton vetëm pikëpamjet e autorit dhe Komisioni nuk mban
përgjegjësi për përdorimin që mund t'i bëhet informacionit që përmban
publikimi.**

Redaktor Rexhep Hida

Art grafik Aida Kumi

ISBN 978-9928-203-98-4

**VENDI I DASHURISË
DHE I RRËNOJAVE**



Ilustrimi në këtë faqe dhe në faqen 241 është një plan arkeologjik i skicuar nga Uggi Ævarsson, në rrënojat e fermës në Hólsfjöll në Islandën e veriut.

Për ornitologët dhe arkeologët

Ai mendonte se do të ishte tepër e këndshme të shtrihej në varr e të dëgjonte tingujt e paqtë të tokës, thjesht për të ndijuar miqtë e dashur, që mund të gjendeshin diku aty pranë.

Dorothy WordsWorth
Grasmere Journals

*Ishin të bukura ato ditë në atë papafingo.
Mbaj mend si shpuplonin njëzet a më tepër thëllëza.
Këndonim, rrëfenim histori dhe qeshnim me të madhe.
Më e bukura, ama, ishte kur mbaronim e mandej si pastronim,
me jorganë hedhur sipër, dilnim jashtë e silleshim në dëborë.*

Oddný Ólafsdóttir, Seasonal Memories

Rejkjavik, Festa e Shën Luçias

(së cilës i nxorën sytë dhe ua tregonin njerëzve.
Është shenjtorja mbrojtëse e të verbërve)

Është e çuditshme të jesh në shtëpi. Ndihem e lehtësuar, ndonëse më bëhet sikur ende më merr malli për shtëpinë. Gjithnjë jam përpjekur të kem një shtëpi timen. Ndoshta do të jetoj vetëm. Mbase marr një qen. Turp tu vijë atyre që krijojnë kaq e kaq andralla për të udhëtuar me avion përtej detit me qen. Pse, s'është e vërtetë që i venë te bagazhet?

Dashuria dhe jo vetëm ajo, është e verbër. Më duket sikur më kanë lidhur sytë. Dua ta shkul fashën e të shkruaj nën rrezet e agimit. Dielli po rilind.

Rejkjavik

Solstici i dimrit

Sot pasdite, bashkë me mamanë dolëm me makinë për t'i hedhur një sy disa shtëpive.

Kaluam pranë njërës, për të cilën ajo tha se bënte mirë për ushqimin e shpirtit. M'i kujtuar ato të bredhurat lart e poshtë nëpër qytet në kërkim të një shtëpie, në periudhën kur na u duk se ishim bërë ca si shumë në tonën. Mamaja, kur s'ishte në qejf, e quante furrik të qelbur. Kur u kthyem në shtëpi babai dhe vëllai po varnin thëllëzat. Unë dhe im vëlla, mbase s'po kalonim ditët tona më të mira, por, të dy te të tridhjetat dhe të dy sërish beqarë fringo, i festuam Krishtlindjet bashkë në shtëpinë e vjetër, duke kërkuar strehë në folenë e fëmijërisë sonë. Sot, pavarësisht plagëve të ndryshme a ndoshta për shkak të tyre, është vërtet festë kur mblidhemi të gjithë bashkë. Më jep një fuqi të qenësishme.

Është një shkurre, që dëmtohet nga drita por që i ruan gjembat. Manafortat, po të distilohen dhe të përdoren si duhet mund të kthehen në ilaç.

Rejkjavik

Në një papafingo, Festa e Epifanisë

Mbrëmë, ai u ngjit në papafingo veshur me tesha prej leshi të zi, të ngushta e të sajuara dhe vinte aromë kolonje bari. Ndjeva erën e ëmbël të djersës së tij dhe vura re se i ishin fryrë herdhet. Ornitologu, me të cilin ishim njohur në spital një vit më parë, kishte ardhur në qytet. Më i bukur se sa kur kishte qenë i sëmurë. Tani shndrit gjithë kohës.

Këtu banon? Sytë e tij të kaltër prisnin një përgjigje. Jo, kjo është hapësira ime e punës, i thashë e zbavitur që mund ta çonte në mendje se mund të jetoja në një kolibe të tillë. Hodhi sytë rrotull dhe pata ndjesinë se po mendonte në mund të bënim dashuri në atë strofull. Aty brenda dëgjohej gjithçka dhe i tregova me dorë nxënësit që përpiqeshin të përqendroheshin. E ftova të ulej në shtratin tim portativ. E pyeta ku jetonte dhe ai më përshkroi pak a shumë një apartament në një shtëpi përdhese, mu aty pranë, me motive të bukura në çimento, më tha, por plot me fantazma, bile edhe me minj; donte të gjente sa më shpejt një vend tjetër dhe ishte si, as andej, as këndeje.

I zgjata një radio marrëse-dhënëse; kanali ishte i hapur kështu që mund të krijonim kodin tonë. Përpara se të largohej, mori një gjethe dredhkë nga libri që kishte

në xhep dhe ma zgjati bashkë me përshëndetjet nga Pentagonia, mbretëria e territ të pesëkëndëshit të gjelbër. A mund të gjejmë një vend atje? Unë i thashë, sigurisht.

Doli përpara mesnatës. Unë doja të vazhdoja të punoja edhe për pak dhe të sfidoja frikën ndaj territ duke e kthyer si një duel. Por ai, me të mbërritur në shtëpi më mori në radio dhe u nisa drejt e për atje, ku qëndrova deri në mëngjes. Erë miu s'më erdhi gjëkund, por ëndrra të këqija pashë sa të duash. Epo nuk hyhet kaq shpejt në botën e një njeriu tjetër; duhet të mësohesh t'i shoshitësh mirë gjërat. Shpesh herë, unë i kam filluar historitë pa e pasur shumë mendjen, por kalonte ca dhe thoja mjaft më, shëndet e të mira.

Kur e pashë, m'u duk më i rritur e i pjekur nga sa e kisha përfytyruar. Veç kësaj, kishte pastruar tërë rangullinat dhe rraqurinat. S'i erdhi mirë që iu zbulua pushin fëminor te kërthiza. Epo ja që njeriu nuk e pastron dot kurrë veten nga turpi dhe pislëku i qëmotshëm. Zemra, sapo hapet, zë e derdh dashuri. Mandej ama, është ide e mirë që të vazhdojë të pompojë e të pompojë, për të të zëvendësuar depozitat septike dhe lidhjet e tua me detin, në mënyrë që ti të mund të shijosh paqen dhe qetësinë në shtëpinë tënde, në vendin tënd të veçuar.

Veçim është një fjalë speciale. Ku e kam fjalorin etimologjik? Të jetë vallë një çoroditje? “Një vend i veçuar për të pushuar dhe menduar”, si një faltore e qetë dhe e paqtë, e përsosur për t'u zhytur në mendime- a mund të kenë faltoret dhe tualetet kaq shumë gjëra të përbashkëta? A nuk janë tualetet vende ku kryhet lidhja reale mes *chakra*-s së poshtme- anusit pra- dhe asaj më të lartës, hyjnores që kemi në kokë të gjithë? Apo është

një vend paqtie për të kundruar qiejt e lartë, njëlloj siç groprosen mbeturinat gjatë shndërrimeve rrënjësore? Në shtëpitë e aristokratëve europianë, biseda më e frytshme e ditës bëhej te hapësira e veçuar, ku të zotët e shtëpisë hidhnin tepricat e ditës së kaluar dhe përgatiteshin për të nesërmen. Atje, në atë hapësirë të veçuar, ata lidheshin me veten, hidhnin parfumet e reja të provincës dhe parashtronin teoritë e tyre më të fundit.

Po përfundoj së shtypuri kujtimet dhe vargjet e këngëve të fëmijërisë e të rinisë së gjyshes sime, emrin e së cilës mbaj. Do t'i shtyp dhe do t'ia shpije që sot. Ka ditëlindjen dhe do të na gostisë me *crepes* me krem me vezë e qumësht dhe mbase do të na i shërbejë me takëmet e purpurta. Kujtimet e saj zënë fill me Epifaninë, kur ndiqej tradita e *crepes*-ve, siç ndodhi edhe ditën kur lindi gjyshja. Shërbyesja duhej të jetë gëzuar shumë që do t'i gatuante.

Ja disa vargje me një ritëm avazi të gëzuar muzikor, të cilat kur i hedh në letër u jep vendin e merituar.

*Mjekroshi bashkë me shtrigën
na u kthyen në Alping
Pa na sollën dhe një zog,
Në një dorashkë pa gishta.
Mbërritën në shtëpi të dy
Me kockat thyer lart e poshtë
Nëpër gurë e nëpër shkrepë
Burri gërthiti me sa kishte:
“Sillna moj të hamë!”
Dal kur vjen një tabaka
Plot me peshk të njomë,*

*troftë të shkrifët si pambuk
Dhe katër kofshë derri të pjekura.
Mjekra mori një çapë, por
me ta kullufitur
Erdh' e u bë njeri,
Gretir emrin ia thonin.
Ky Gretiri qenkësh i zoti për ca gjëra
Honin e kalonte me një hap,
vinte në gjumë vashat, qetë, viçat
Thonë edhe vetë mbretin.*

Selsundi pranë vullkanit Hekla Dita e petullave me krem

Sot në mëngjes, duke bredhur nëpër luginën e llavës, mes gëmushave të manaferrave dhe shtufës, gjeta një vend të veçuar. Kur një pëllumb alpin më fluturoi sipër tek rrija ulur galiç, m'u bë sikur po më shikonte; u afrua vërtet shumë pranë kurorës që mbaja sipër kokës, duke u rrotulluar dhe duke kuakur. Unë ndjeva pak në siklet sepse sapo kisha lënë gurgulenë e qytetit dhe s'para e kapja domethënien e disa gjërave. Përse këta pëllumbat bëjnë vazhdimisht rrathë të tillë?

U ktheva te çadra dhe ai ende po flinte, kështu, e gudulisa me një degë peme duke gulçuar *petulla, petulla!* Ai s'mori gjë vesh dhe u kthye nga ana tjetër. Edhe unë, një tu zhveshur bëra dhe u futa te dysheku i fryrë, e mbërtheva me kofshë te këmbët, i mora erë qafës së tij dhe e shkova dorën te herdhet e ngrohta.

U zgjuam në të njëjtën kohë dhe zumë t'i tregonim njëri tjetrit ëndrrat e këqija që kishim parë- kujtime të pakëndshme nga shoqëri të dikurshme. Mezi arrinim të shikoheshim. Ndoshta koka e një njeriu kthjellohet më shpejt kur ndodhet pranë vullkaneve. Hekla mund të shpërthejë nga çasti në çast, por tani kam shumë frikë nga zjarri.

Petullat me krem që kam sjellë me vete janë zgërlaqur,

pasi ai u kishte vënë sipër qypin me marmelatë.

Bëmë një shëtitje të gjatë mespërmes llavës, fillimisht pa folur. Qenka vërtetë bukur të rrih në heshtje, ndonëse është e çuditshme të shëtisësh pa thënë një fjalë të vetme me dikë, të cilin s'e njeh mirë. M'u desh kohë t'i zija besë heshtjes mes nesh, të kuptoja se ishte thjesht një mungesë lidhjeje. U përpoqa të bëhesha e pavarur dhe të mos mendoja se si ndihej ai, si ishte realisht marrëdhënia jonë apo ç'kishim që s'merreshim vesh. Por në një çast të caktuar harrova edhe veten, edhe atë dhe zura të vështroja poshtë mes këmbëve të mia lulet e dimrit, që gjendeshin aty-këtu mes gjurmëve të dëborës. Papritur, një dhelqer kryeneçe zuri të angullinte në një plasë. M'i kishte ngulur aq shumë sytë, sa rashë me turi dhe u zhyta në torfë. U llahtarisa sepse m'u kujtua një histori, që sapo ma kishte treguar Bufi, im vëlla, për ca dhelpra që kishin sulmuar një arkeolog dhe kishin shtrënguar dhëmbët e mprehtë prej shtaze te pulpa e këmbës së tij.

Ai më ngriti në këmbë duke qeshur dhe me një vështrim vjedhacak më shpuri në një guvë të vogël me llavë të nxehtë e të mbuluar me myshk të lagësht. Unë e kapa thelbin e qëllimeve të tij, gjeta një vend të butë e të këndshëm, u shtriva me kurriz dhe e mora në krahë, ndërsa ai gjeti rrugën përmes teshave tona të leshta. Lëvizëm me ritmin e tingujve të gëzueshëm të një dëbore të pëlhurtë, e cila lëshohej nga qielli pa pikën e frikës prej shpërthimit të vullkanit.

Rrugës në kthim, më tha se atë terren e kishte blerë gjyshja e tij dhe se po të donte e po të mundej, mund të ndërtonte një shtëpi verimi. Si të duket të jetojmë këtu të dy bashkë një pjesë të vitit? më pyeti. Po, patjetër,

mendova. E kam ëndërr të jetoj në vende të shkreta të natyrës, në paqe e qetim të plotë. Mos ke gjë nevojë edhe për vetmi të plotë, ? më pyeti. Jo, s'ma do mendja, i thashë.

Trumcaku i dimrit me kokën e buhavitur ishte gati për të plasur. Mbusha me krem petullat e mbetura dhe i kullufitëm fët e fët.

Pak e nga pak, duke llupur, stresi na ra. Ç'të bën bloza e qytetit. Kisha shkruar listën e fjalëve të gjuhës islandeze, që mbarojnë me "ss": *fúss, rass, hoss, spíss, koss, fliss, kross, piss, fuss, suss, tráss, góss, hnoss, hress, bless...* Kisha gjetur dyzet fjalë.

Nuk kam idenë si të krijoj të dhënat për fjalëkryqe, por vendosëm ta bëjmë së bashku. Përgjigja duhet të jetë në një fjalë të vetme, apo jo? Apo në një fjali? Nga mendja s'më shqiteshin fjalët *næði* (paqe, qetësi, ndenje mënjanë, ngé) apo fjala *náð* (pushim, qetësi, hijeshi) apo *jarðnæði* (ngastër toke apo fermë e marrë me qira). Ai më tha se do të ishte më mirë të shkruanim fjalën *náðhús* (veçueshmëri, tualet, banjë) apo fjalën *náhús* (varr), madje edhe *gröf* (llogore, varr) dhe shtova se atje do të gjeja paqe dhe qetësi të përsosur. U gërnjosëm ca dhe mandej m'u bë sikur kisha nevojë t'i shpjegoja ëndrrën time për intimitet. Ai uli kokën poshtë në shqopishtë për të kontrolluar për një çerdhe zogjsh dhe për të gjetur një shteg që e kishte parë në hartë.

Na zuri një stuhi dhe gjetëm strehë në shtëpizën e stërgjyshes së tij, që dikur kishte qenë hangar në Rejkjavik. Stërgjyshi i tij, si i huaj që ishte, kishte pasur goxha nuhatje dhe, duke parandjerë vlerën që do të merrte toka, kishte lënë në testament që nuk mund t'i shitej një

familjeje tjetër. Aty brenda gjetëm një cilindër gazi të mbushur plot dhe një musht të shkëlqyer. Me të gjerbur gllënjikën e parë në mendje më gufuan këto vargje:

*Në strofkën e fshehur nga llava
Thellë në shpirtra ndajmë gëzimet
Zoti i madh, më i dashuri ndër të dashurit,
ma dëgjoftë lutjen
Shend dhe qeti të dhëntë o tokë e pasur
nën tendën e diellit të bekuar,
ndriçoftë strehën në orët e hareshme
dhe poshtë peshës së rëndë të Heklas
kënaqësia e kulluar mbretëroftë*

Jemi ulur në tryezën prej lisi mbuluar me një sofrabez; ai lexon, unë shkruaj. Më duhet të çoj një dorëshkrim të shkurtër, por nuk kam gjetur tonin e duhur. Ai fërgëllon ngaqë po mbaron një libër të Tomas Bernardit, për një burrë që kishte një roman të tërë në kokë dhe që priste të gjente paqen dhe qetësinë e duhur për ta shkruar. A ia arriti? Jo, vitet kalonin dhe gruaja e tij pareshtur thurte dorashka prej leshi dhe sapo i mbaronte i shqephte. Vazhdoi kështu deri sa një ditë sa i shoqi e vrau.

Në këmbët e vullkanit Hekla Dita e shpërthimit

Si ra pak era, vendosëm të flemë në shtëpinë e verimit. Morëm dyshekët e fryra dhe i vumë mbi shtretërit ku gjendeshin edhe disa jastëkë të qëndisur me fjalët *gjumë të ëmbël*. Ai erdhi në shtratin tim dhe zuri të më ledhatonte. Vera e mollës e kishte ngrohur dhe turbulluar. Mandej u shtri sërish në shtratin e tij dhe nisi të vriste mendjen duke folur me zë të lartë se ku duhej ta ndërtonte në të ardhmen shtëpizën e tij, shtëpizën tonë. Tregoi me dorë në një drejtim që vetëm me një truall s'ngjante dhe më kërkoi të zgjidhja: me pamje nga vullkani Hekla, e mbrojtur nga erërat, diell nga jugu, panoramë, furnizimi me ujë rrjeti, paqe qetësi. Më pas dëgjuam një zhurmë të mbytur. Mori një elektrik dore doli jashtë me prapanicën zbuluar dhe kur u kthye më tha se kishte marrë era tryezën jashtë, por që tani gjithçka ishte në rregull. Unë e admirova guximin e tij të dilte lakuriq në terr. S'kaloi shumë dhe e zuri gjumi duke gërhitur fort.

Unë s'gjeja dot qetësi; nervat i kisha të acaruar, mendja më shkante gjithandej. Më dukej se në errësirë më shtohej frika. U përpoqa të gjeja një shpjegim shkencor: tani po frynte jug e jo më veri, siç më kishte thënë ai. Vrisja mendjen nëse gjurmët e erës së trupit, të përziera me aromën e parfumit nëpër jastëkë, mund të ishin të

mjaftueshme për të ngjallur fantazmat e vjetra. E merrja me mend se do të isha e mirëpritur në atë shtëpi, por nuk ndihesha ende si në timen. Qysh kur isha e vogël, malli për shtëpinë më merrte krejt papritmas, siç shkrep një rrufe në qiell të pastër. Qëndrova shtrirë e ngurtësuar deri sa çeli agimi. U veshja dhe dola te çadra duke u ndjerë më mirë. U mbështolla me një shall leshi dhe me një xhaketë me kuadrate si ato që vishnin gjyshet e mia.

Të bujtsh nëpër shtëpitë e njerëzve nuk është aspak e lehtë. Dikur, nëpër fshatra, mikpritja matej nga sa mysafirë gjendeshin në shtëpi, të ftuar e të paftuar- ndër këta të fundit futeshin edhe ata që nuk kishin plan se ku do të shkonin më pas, si edhe ata që thjesht ishin ndalur për të kërkuar bukë dhe shtroje.

Nëse ishe mysafir i ftuar duhet të ketë qenë e lehtë, por tepër e vështirë në rast se jo pasi duhet të fitoje besimin e të tjerëve. Herë pas here përfytyroja si do të ishte po të jetoja si cigane. A do të varesha shumë dhe gjithë kohën nga të tjerët, do të kisha besim te vetja e të kërceja lirshëm, ashtu siç i shihja në ëndrra.

Më kujtohet një herë kur u takova me një cigan zeshkan, kryetar i një fisi dhe i shkova pas në një çadër të madhe të bardhë buzë pyllit. Më paralajmëroi se duke qenë se u kishin ngacmuar familjen e stërmadhe ata vazhdimisht kishin refuzuar të jetonin në shtëpi. Ai vetë ishte bërë tepër mosbesues dhe më pak mikpritës nga sa do të donte. Me thënë të drejtën, gjërat që pashë brenda asaj çadre nuk më pëlqyen; dukej sikur solidariteti i tyre ishte i mbërthyer te dëshpërimi dhe ngjante si si në një mbledhje familjeje në ndonjë cep të humbur të ndonjë fjordi kur bënte kohë e keqe.

Instrumentet nuk nxirrnin zë.

Një grua me një fashë rreth kokës më tha se po të doja mund të më lexonte dorën. E pranova duke prekur xhepat edhe pse s'kisha kurr gjë. Më tha se për një kohë goxha të gjatë do të kisha trazime; kisha një si lloj mallkimi që s'më lejonte të gjeja një vend për t'u ngulitur. Pa m'i ndarë sytë e dhimbsur më tha se unë duhet të isha pas asnjë mëdyshje ndonjë lloj ciganeje, cigane kuqalashë, por që duhet ta kisha të qartë një gjë- me ta s'trazohesha dot. Më foli siç i flitet një qeni. Shpeshherë kështu u flasin ciganëve: *jashtë që këtu, qërohu, kris prapanicën, hajvan!*

Duhet të kisha dremitur paksa; kur u zgjova ai po përpiqej të hapte zinxhirët e dyshekëve, por mandej hoqi dorë. Era oshtinte nëpër male dhe stuhia frushkullonte çadrën. E pamundur të merrje dot një sy gjumë. E ç'dreq rrymash janë këto? Do të doje të ishe Egerti apo Bjarni? më pyeti ai duke qeshur, mu pak përpara se ta zinte gjumi. Mandej më tha se në fakt, zbuluesit Egert dhe Bjarni, mu këtu kishin ngritur çadrat një natë përpara se të niseshin drejt Heklas. Ata ishin të parët që zbuluan se ajo nuk ishte një derë për në ferr. Një herë më doli në ëndërr Bjarni në një lojë dashurie e pshore te muret e drunjta të farmacisë së tij me një zog që hante peshqit. Ndërsa për Egertin, ndonëse e kisha shfletuar librin me shënimet e tyre të udhëtimit, e vetmja gjë që dija ishte se kishte qenë bujk.

Përpiqem të më zërë gjumi duke menduar fjalë të tjera që mbarojnë me "s" - *Tüss, skass, hlass, krass, hass, hoss, fliss, flass, trass, kross, gloss*. Po *kross* dhe *fliss* a i kisha menduar më parë? Po *pluss*? E çfarë domethënë *pluss*,

në fund të fundit? A është fjalë e mirëfilltë islandeze? Do të kisha dashur të kisha marrë me vete fjalorin. Jo se është edhe aq i përsosur në shpjegimet e islandishtes, por sidoqoftë përbën një përpjekje dinjitoze në këtë drejtim. Ata që e kanë hartuar, me siguri duhet të kenë pasur nevojë për paqe dhe qetësi.

Pastaj vinë fjalët me *mm*: *gúmm*, *skamm*, *djamm*, *gjamm*, *vamm*, *skömm*... dhe *búmm*, sot në nder të Ditës së Shpërthimit

Qengj i kriposur dhe supë me bizele të thata. Jam e lumtur që s'më duhet ta bëj sërish fjalorin dhe as ta përditësoj. Do të më luante tepeleku i kokës . Tani dëgjoj blegërima. Sigurisht, është gjë e bukur që ka ende dhen që kullosin dhe çobanë që flenë për shtatë palë qejfe në shtëpitë e tyre në mes të shtëpive të verimit. Më pak frikë ka dhelpra plakë që rri syhapur në mes të llavës, e kuqërreme dhe e pavarur.

Rejkavik E mërkurë e përhime

A ty nga pasditja shkova për vizitë te gjyshja. Doja ta pyesja ç'mendonte për shtëpinë e verimit, nëse kishte ndërmend të shkonte e të kënaqej ndonjë çikë pas tërë atyre vitesh. Ajo ma preu shkurt fare: jo. Në të tilla shtëpi s'ishte ndjerë kurrë mirë; nuk bënin për të. Po njëlloj, siç nuk duronte dot periferitë. Le të ishin të përshtatshme sa të donin për fëmijët dhe qentë. Më mirë vriste veten se sa të nxirrte shëtitje një qen!

Një herë në javë, një burrë tepër i hijshëm u shpie n azil një qen gri. Futet dhomë më dhomë që banorët e atjeshëm ta lëmojnë. Më tregoi si i kishte thënë atij burrit se qeni ishte jashtëzakonisht i dashur, pse jo edhe i këndshëm, por kishte shtuar se asaj nuk i pëlqenin qentë dhe se nuk donte t'ia shpinte në dhomë.

Gjyshi sapo ishte kthyer nga një udhëtim në det. Për atë verë kishte rezervuar një shtëpi të vogël verimi. Parashikohej kohë e mirë. Duke qenë se qëndroi në qytet ca më tepër nga sa kishte vënë në plan, gjyshes i kishte takuar të mbetej vetëm me tri vajzat dhe një dado fare të re në moshë.

Në fund të verës vajzat ishin mërzitur duke luajtur me shtëpizën lodër në oborr të ndërtuar enkas për to dhe prisnin të atin që të shkonin e të mblidhnin manaferra.

Ia kishin plasur shpirtin të ëmës: ku janë manaferrat, kur do të vijë babi? Donin që ai të shkonte bashkë me to dhe siç bënte zakonisht t'u mësonte bimët: cilat mund të përdroreshin për të ngjyrosur, cilat për barna. I kërkonin të ëmës t'u recitonte vjersha dhe t'u mësonte poezi si babai. Kështu pritej të ndodhte, por kur u poqën manaferrat ai erdhi dhe u dha një lajm: do të shkonte të jetonte me një grua tjetër. Ajo paskësh pasur shumë nevojë për atë burrë dhe po njëlloj edhe ai për atë grua.

Pak vite më vonë u kthye te gjyshja dhe kurrë nuk morën më shtëpi verimi me qira. Shtëpia e tyre ishte e bukur, e hapur për farefisin dhe për miqtë; ishte si një shtëpi fshati e ngrohtë mikpritëse në mes të qytetit. Çdo ditë bashkë me ta uleshin e hanin mysafirë, të ftuar e të paftuar. Në tryezën e bukës, diskutoheshin çështje nga më të ndryshmet; njerëzit uleshin në karriget lëkundëse rrinin deri natën vonë. Jo si në ato klubet me vetëm burra apo si në ato rrethet e rrobaqepësisë për gra; aty dhe gjinitë përziheshin dhe të gjitha moshat ishin të përfaqësuara. Aty këndohej, thureshin vargje, piheshin me pipë kokteje frutash me krem me vezë e qumësht apo me manaferra të freskëta nga veriu. Fundjavave organizoheshin udhëtime me makinë në fshatrat rrotull qytetit, për të parë malet dhe kushdo që donte të shkonte me ta, shkonte.

Stykkishólmur
Dita e parë e verës

Jam ulur në tavolinën e punës dhe vështroj diellin. Këto ditë s'para bëhet natë, çka do të thotë se nuk jam e mbërthyer në vend nga frika e errësirës, megjithëse jam fare e vetme e në një godinë të çuditshme. Më kishin ftuar të vija dhe të rrija në një apartament në bregdet, i cili më parë përdorej si dyqan librash. Duket se lutjet e mia ishin dëgjuar, pasi doja vërtet shumë të rrija një copë herë larg qytetit.

Djali që erdhi të më lidhte internetin më tha se Kamila, bibliotekarja, e cila në ditët me diell pinte puro dhe luante në fizarmonikë, prej goxha kohe s'jetonte më. Por edhe sikur të ishte, nuk ke përse trembesh, ia bëri, pasi tregohej shumë e mirë me ne fëmijët; rrinim në librari sa të donim dhe lexonim sa të donim.

Tavolinën e kam përballë detit dhe ishujve. Pamja është e bukur, ndonëse jam poshtë. Është një ndjesi vërtet e këndshme. Më kujtohen fjalët e mjeshtrit të yjeve, i cili më thoshte se energjia ime e punës çlirohej më mirë në biruca apo në bunkerë të nëndheshëm. Dhe ja, tani ndihem mirë që shkruaj këtu; pamja e ishujve nga dritarja më lehtëson trurin.

Sipas *Sagës së Gisli Súrsson-it*, djali idiot i *Ingjaldur-it*, jetonte në një kasolle torfe në ishullin *Hergilsey*. *Gisli*

u fsheh atje dhe bënte si idiot. Mbrëmë më doli në ëndërr Auður-i, gruaja e Gisli-t, por s'më kujtohet si ishte në pamje; fytyrën s'ia shihja dot, por di që më zgjati një karficë argjendi me zbukurime prej diamanti e më kërkoi t'ia ruaja. Sipas folklorit, të ëndërrosh argjend do të thotë dëborë dhe mërzi, por kisha ndjesinë se ëndrra ime duhej të kishte tjetër kuptim. I telefonova vëllait tim të dashur, Bufit dhe i kërkova të më fliste për *Auður*-in. Mua më kishte dalë krejt nga mendja ç'kishte ndodhur me të. Im vëlla më tha se ajo kishte qenë grua zonjë, shoqe e mirë dhe tepër besnike ndaj *Gisli*-t. Pas vdekjes së këtij ishte larguar nga fshati dhe ishte nisur për një pelegrinazh në jug të vendit.

Zogu, ornitologu im i dashur, ka shkuar të gjejë fatin e vet dhe jeton në një shpellë në jug të Irlandës në përpjekjen për të shëruar pendët e sipërme. Celularin nuk e kishte marrë me vete dhe ishte shumë larg për t'u lidhur me radio marrëse-dhënëse. Me shumë gjasa është mënyra më e mirë për të prerë çdo lloj lidhjeje e kësisoj të arrihet hyjnizimi i brendshëm i gjithsekujt, nëse ka vërtet diçka të tillë brenda vetes.

E ftova të vinte me mua, por më tha se nuk i bëhej. Kishte frikë se mos pa e pasur mendjen do të futej në jetën a mbase edhe në mitrën time, duke thënë se ndiente dëshirë. Kësisoj vendosi të futet në tokën nënë dhe mandej të më takonte si tjetër njeri.

Më doli në ëndërr në agim; gjendeshim në një shpellë tepër të thellë nga brenda e në atë errësirë pus të zezë puthëm qepallat e njëri-tjetrit. Ai më lëmoi flokët e pastaj u fut brenda meje, çka ishte edhe kulmi i qejfit. Nuk e di nëse tingujt e valëve që po më pushtonin vinin nga ëndrra

apo nga diku këtu në plazh. U zgjova ditën e solsticit të verës dhe ndihesha shend e verë, e gatshme për të kryer gjëra të mëdha.

Nën shtyllat mbushur me ujë nga shkrija e akujve, ëndërrova për drejtësi në këtë vend, pse jo edhe në botë.

Më pëlqen vërtet shumë peshku i freskët, por s' di ku ta gjej. Gratë te salloni i bukurisë më thanë të shkoj poshtë te porti kur mbërrijnë barkat dhe t'ua kërkoj drejtpërdrejt peshkatarëve. U përpoqa, u vërtita andej rrotull portit, as vetë s'e di se ç'pata, por ja që s'arrita ta hapja dot gojën e të kërkoja. Në Rejkjavik sjellin vetëm peshk të ngrirë për supermarketet. Hëngra një hamburger me salcë *béarnaise* në një restorant të vogël pranë portit.

Kriza të tilla janë si çdo periudhë tjetër trazirash, kur ripërtëritja është më pranë se kurrë. Po lexoja një artikull të gjyshit, ku shtjellon disa mënyra se si islandezët duhet të ngrenë cilësinë e jetës nëpërmjet ekosistemeve brenda vendit dhe në zonat rrotull, si edhe në lidhje me kapjen dhe riprodhimin e peshkut. Duke vepruar kështu ne nuk i shpiem të gjitha speciet në zhdukje. Kam dëshiruar shpesh që ai të ishte gjallë, por asnjëherë më shumë se kaq; do të doja ta pyesja më tepër në lidhje me të ardhmen.

Stykkishólmur

Festa e kryqit në pranverë

Pjesa më e madhe e zogjve shtegtarë kanë mbërritur. Pikaloshët rreshtohen në fushat gati për t'u mbjellë të atyre që kalojnë kohen e lirë me bujqësi dhe qukapiku këndon preludet e Bahut. Nga qejfi i tërë kësaj, unë vizatoja. Përpiqesha të nxirrja një shtëpi. Gjithashtu, bëra përpjekje për të vizatuar një rend social, një lidhje organike të grupeve të pavarura. Nuk di se si t'ia shpjegoj skicën vetes, por, padyshim, është ambicioze. Në një krizë si puna e kësaj, megjithatë, kërkimi i vetvetes përzihet me kërkimin e një strukture sociale. Në të dyja rastet, pyetja shtrohet si të jetosh duke qenë i vetëmjaftueshëm, ndërsa në njëjtën kohë të kesh marrëdhënie kuptimplota me të tjerët.

M'u kujtua përsëri periudha që kalova në Rue D'Hermitage, kur bëja shumë përpjekje si të gjeja një vend qetie, si të merrja me qira një apartament dhe si të gjeja çelësat nga fundi i botës, vetëm e vetëm që të ulja temperaturën. Vendosa të përpiqesha të bëja gjithë ç'kisha në dorë dhe të përqendrohesha te përgjigjet, një herë e mirë, për mënyrat më të mira të mundshme të jetesës. E lashë mendjen të fluturonte dhe të përpiqej të gjente një bimë, e cila do të simbolizonte shtëpinë, stilin tim të jetës, si edhe botën time emocionale. M'u bë sikur

vjollcat do më ngrinin ndonjë kurth. Por tani kam zbuluar se ato rriten më mirë nën pemët e mëdha, në hije dhe në kopshtet e kishave, kështu që do të bëj mirë të gjej ndonjë lule tjetër. Vizatova, po ashtu edhe disa forma gjeometrike: drejtëza, trekëndësh, katrorë, pesëkëndësh, gjashtëkëndësh, shtatëkëndësh, tetëkëndësh, por hiç; nuk arrita në asnjë përfundim. Nga pena ime e qelbur stilografike dolën vetëm disa rrathë dhe hiçgjë tjetër.

Pastaj më telefonoi Ruperti, ai arushi vizatimor dhe më tha se do të vinte nga Amsterdami në Paris me disa vizatime, që donte të m'i tregonte. Erdhi dhe kishte hedhur një shall të verdhë. La një format të madh letre mbi tavolinën e kuzhinës, më përshkroi këndin e artë dhe me gjeste më tregonte se si vizatohet në tri përmasa. A është e mundur që kjo të shkojë në pafundësi? e pyeta. Ai pohoi me kokë, tundi kutinë e kokrrave dhe tha po, është plotësisht e mundshme; është atje ku jetoj unë. Doja të ikja bashkë me të. Mbase kisha mbetur paksa e shtangur nga pamja e tij si arush- pellush, por ai më ofroi manaferra e më tha se nuk e dinte adresën dhe veç të tjerave, i duhej të ikte me ngut; kishte një takim pune në lidhje me krijimin e formave.

Kishte harruar shallin. Vinte një erë djerse të ëmbël, kështu që e lidha me vizatimet e mia, mbledhur rrotullame si në anijet e vjetra.

I telefonova pasi kishte ikur; po përgatitesha për një provim me gojë. Të nesërmen i hodha një sy librit dhe u trondita kur pashë se me sa zell kisha nënvizuar me stilolaps frazën e mëposhtme: *Gjuha është shtëpia e qenies.*

Jam e sigurt se filozofia më ka bërë dëm, por kjo nuk

duhet të vazhdojë gjatë; unë duhet thjesht të ndjek boshtin dhe brazdat apo çfarëdo që mund të ndjekësh kur mbron veten! Një drapër dhe një çekan? Një kryq dhe një qysqi? Tehun dhe majën? Të paktën është mirë ta kesh të qartë se, duke shpëtuar vendin, po shpëton edhe veten. Mos është pak ekstravagante të përpiqesh të shpëtosh vendin e të lesh një terren të fortë nën këmbë? Më kujtohet mamaja kur fliste ndonjëherë për ekstravagancën; unë s'merrja gjë fare ves,h por kisha ndjesinë se ishte diçka tejet dykuptimëshe.

Si shkoi me atë burrin tënd? Vazhdon akoma të çapitet këmbadoras në shpellë apo është ngritur drejt?

Arkeologu mbërriti dje në mëngjes. Me pardesynë e zezë fringo të re dhe me krahët në fluturim, ngjante tepër luftarak. Duart i kishte të shtrira e në to mbante një çantë me *croissants*-e të ngrohta. Jo të gjithë kanë guximin t'i jepen vetmisë dhe të shikojnë veten në sy siç bën ai. E di që do të rilindë; i besoj plotësisht. Oh, vërtet? më pyeti, përpara se të zhytej në historinë e shtatë burrave që u mbyllën në një shpellë në Efes qysh gjatë perandorisë Bizantine dhe fjetën atje dyqind vjet të tërë deri sa i zbuloi një vajzë e re dhe menjëherë më pas i ndolli. Duhet ta mësoj këtë marifetin e saj. Por vras mendjen se ç'ëndrra duhet të kenë parë ata burra gjithë kohën? Duhet ta gjesh patjetër përpara se të hedhësh hapin tjetër, më tha ai me një ngërdheshje kaq ironike, sa më sollë në mendje *Skarpheðinn*-in, teksa unë përgatisja kafënë duke ngrohur njëkohësisht edhe qumështin. A mund t'i lidhësh këpucët? e pyeta, duke u bërë barabar.

U ulëm në lëndinë dhe pimë kafënë. Më ftoi të shkoja me të në Hergisley ku *Gísli Súrsson*-i fshihej gjatë ditës; ai dhe disa arkeologë të tjerë po shkonin të bënin kërkime

në atë zonë. Donte gjithashtu të më njihje me të dashurën e tij të re, e cila do të nisej për në ishull atë natë.

Lundruam duke kujtuar dashurinë tonë për *Gísl*-in dhe *Auður*-in, se si pandehnim se ishim ata; arkeologu ishte ai dhe unë ajo. Nëna na qepi edhe tunika, kurse babai na bëri shpata dhe mburoja, kështu që mund të mbroheshim më së miri gjatë mërgimit.

Ja ku jemi, secili në çadrën e vet. Është e pamundur të dalësh jashtë, shi pa fund; duket sikur çadra mezi e mban tendosjen. Ai më tha se do të dilte të mblidhte disa gurë për të forcuar shkopinjtë e tendës. S' rri një sekondë në vend; nuk di nëse të tjerët do ta bënin këtë në kushte të tilla, çka do të thotë gjithashtu, se kemi ngecur këtu. E ka merakun tek e dashura. Edhe unë jam pak në ankth, sepse më duhet të çoj disa mesazhe. Ndonëse 3G-ja në celularin tim funksionon.

Hegill bythësumbulla jeton këtu. I biri i tij, *Ingjaldur*-i ka bërë një djalë, që e quajnë “Idioti i *Ingjaldur*-it” në një zonë të mbyllur që quhet *Fíflsgerði* ose *Ingjaldsbyrgi* (Rrethimi i *Ingjaldur*-it). Gjatë atyre ditëve, banorët e ishullit peshkojnë dhe përpunojnë bujarinë e detit, merren me bujqësi dhe kultivojnë perime. Toka këtu nuk duhet të jetë ndër më të mirat për bujqësi, por ishulli ofron edhe mundësi të tjera të dobishme.

Ato që mbeten nga pesë ngastrat me perime të shkëlqyera, tashmë janë regjistruar bashkë edhe me kanalet kulluese. Dihet se në *Oddbjarnarskeri Reef*, që unë arrij ta shoh në mjegull, ka shumë barka peshkimi. Me gjasa, në pranverë duhet të ketë pasur shumë gjallëri që mandej ka rënë.

Im vëlla erdhi te çadra me një uiski që nxirrte avull në një enë argjendi; oh, duket se kjo quhet faqorja e brezit. Kishte arritur të fliste me të tjerët në telefon dhe t'i paralajmëronte për kohën. Ata do ta kalojnë natën në *Stykkishólmur*. Që të dyve na vjen keq që erdhëm këtu përpara tyre. Na duket sikur kot shpejtuam aq shumë, përndryshe do t'i kisha sistemuar në apartamentin tim.

Mezi arritëm të bisedonim pak. U përpoqa t'i jepja zemër që të mos ngutej sërish për të bashkëjetuar dhe ai më tha se tani për tani donte të kalonte ca kohë vetëm në një hapësirë boshe apo të zbrazur. E çon ende ndër mend se herët apo vonë do t'i duhet të jetojë me dikë. I duhet të transportojë pjesë-pjesë hapësirën boshe në një hapësirë të ndarë me dikë tjetër. I thashë se unë për vete, pas tërë asaj kohe që kisha jetuar me dikë, kisha hequr dorë nga kjo sepse gjithmonë përfundon me rrënoja. Jetë e mot më kishte krijuar ndjesinë se po më merrej fryma.

Së shpejti, dua të përpiqem të jetoj, edhe bashkë, edhe veç. Të jetoj në të njëjtin vend, në të njëjtin qytet, ndoshta edhe në të njëjtën ndërtesë si me këdo që jam në një lidhje, por në apartamente të ndryshëm. Kësisoj, e kam kollaj t'i shkoj për vizitë dhe të ftoj miqtë e mi të mirë në apartamentin tim. A e ke idenë se sa mund të më

duhet për ta sistemuar me mobilim francez? më pyeti ai. Epo, jo, them se jo...e pastaj, prapë...? Ndoshta do të ishte më mirë që në terma afatgjatë të kisha lidhje më të gjata dhe jo këtë nevojën për të lëvizur kaq shpesh.

Po ti, s'ke dëshirë të kesh një a më shumë fëmijë? më pyeti ai më pas. Sigurisht, iu përgjigja. Epo, merre seriozisht. Prej shumë vitesh më këshillonte të mos vonoja shumë, pasi ky është akti më i shënuar që mund të bësh në jetë. Po, po, shpresoj vërtet të kem fat të mirë.

Po vatra e kësaj marrëdhënieje “afër, por veç”, ku do të jetë konkretisht, në shtëpinë tënde apo të të dashurit? Po për fëmijën kush do të kujdeset? Mund të qëllojë që të të lerë pa gjumë për gjithë natën. Nuk do që një nga apartamentet të kthehet thjesht në një vend ndëshkimi? Vend ndëshkimi? Këtë pyetje nuk e kuptova. Po ja, qëllon kur njëri nga të dashurit shtron një temë.

Fillova të ndjeja se ideja e të jetuarit “afër dhe veç” sikur po më lëkundej në mendje. Apo mos më dukej mua kështu? A mundet një çift ta bëjë me turne përkujdesjen për beben? Është e thënë se të gjithë duhet të jenë në punë në të njëjtën kohë? Jo, mbase jo. Është zor të thuhet, ia bëri ai. Është mirë që punët të jenë në orare të ndryshme dhe kështu fëmija mbahet me radhë, por duhet që ti gjithmonë të jesh përpara partnerit. Për mua qenka tepër e koklavitur. Me sa zjarr mund ta marrësh çështjen për hapësirën tënde intime? Për fat të keq, më duket e pamundur, ai bëri ai me trishtim, duke kaluar një gllënjë të madhe.

A ka pasur njerëz mikpritës në këtë ishull? Unë mezi prisja të dëgjoja gjithçka për atë jetë, por përshkrimi i tij ishte kaq melodioz sa më zuri gjumi, siç bëja kur babai

na lexonte *Njal's Saga*-n. Në një mjegullim përgjumjeje përfytyrova jetën nëpër ishuj, kapa kuptimin e fjalëve: kasolle, stallë dimri, breg kodrine, pus dhe mulli. Cfurka për tjerrje.

Do të gjejmë cfurka për tjerrje? Po karfica zbukurimi? Po kryqe celtike? A ke gjetur ndonjëherë ndonjë karficë argjendi? Si e ka edhe një herë emrin ajo gruaja që voziste varkën mes ishullit të saj dhe *Stykkishólmur*-it me vite të tërë? Ishte apo nuk ishte heroinë? Apo thjesht trime. E ke fjalën për *Guðrún*-in e *Galtarey*-t?

Isha në një gjendje të topitjeje të këndshme dhe ai vazhdonte me historitë e veta, ndonëse mua më kishte zënë gjumi. E bënte sepse herë pas here përmendesha dhe i përgjëroheshja; aman, më trego akoma dhe pak, të lutem më fal që s'jam dëgjuese e denjë. Çfarë luksi të pish dhe të të duket sikur po të japin nga një shishe belesh.

Po po, edhe *Tove Jansson*-i jetonte në ishullin *Klovharu* në bregun e Finlandës dhe tërë verën e kalonte duke shkruar. Me partneren apo me një tjetër artiste. Po, dashnorë, ishuj dhe bojë shkrimi. Mos harroni shtypin e shkruar në *Hrappsey*, i cili i ka hapur sfidë për të patur monopolin e botimit të *Hólar*-it në gazeta...

Stykkishólmur

Fillimi i sezonit pranveror të peshkimit

Panairi i të brendshmeve të peshkut

Sot në mëngjes, në një kërkim të dëshpëruar për një lidhje interneti, mora varkën për t'u kthyer në *Stykkishólmur*. Të tjerët qëndruan në ishull për t'u përqendruar mobilimin e shtëpive në të kaluarën.

Sikur të jetoja në një ishull me pula, me shtyp të shkruar dhe ku në breg të kishte anije me vela plot me dorëshkrime dhe vezë, me shumë gjasa do të isha e lumtur. Apo do të vizatoja si Eggert-i.

Mendimet më sillen rrotull e rrotull. Si spiralet e një mushkonje të gjelbër të pjekur në zgarë gurkali dhe Efesi portokall, ku tempujt, kishat dhe xhamitë rrinë njëra bri tjetrës.

Dhe ja ku është ai, *Beberuhi*-u, tip i çuditshëm, rrengaxhi dhe xhuxh, ulok dhe mashtues. Hi, ho, a do më mësosh të luaj shah? I njoh fare pak lëvizjet e gurëve dhe jam e çalë, sa mezi kam mësuar notin. Një kalë i përhimë, thërret për këmbim. Thërret shokun e tij kukullat e teatrit me hije, i cili jeton në dritë dhe në hije. Por ai, ngaqë e ka munduar së tepërmi veten në mugëtirë, lehu menjëherë fort: ose unë nuk di lëvizjet dhe emri im nuk është *Beberuhi* dhe jeni ju e keni bërë lëmsh tërë këtë. Kështu duhet të jetë. Shoku im i ri kokëfortë dhe

tepër harbut është shpirti i skuadrës. Apo është thjesht një leproz gungaç, një fëmijë i birësuar i kënetës, një i shuar në magmë, i cili kërkon strehë në qytet pasi një tren është përplasur te fusha e shahut pranë banjës, një klerik shigjetar i kapardisur që i vuri zjarrin vetes, apo mos ka qenë ndonjë tërmet që e ka rrafshuar ndërtesën e zbukuruar me mozaik, duke bërë që karnavalet të binin poshtë e të bëheshin copë si një gotë e shpartalluar?

Vetëm sonte mora kaq shumë njohuri sa ndihem e dredhur, çka pjesërisht mund të jetë lodhje e bartur. Por unë di gjithçka për neokolonialistët, të cilët kanë në plan të pushtojnë botën pa e vënë re kush.

Qëndroj pranë muzeumit të Ujit dhe dërgoj mesazhe nëpër botë në mbrojtje të ujit. Kundër ndotjes dhe babëzisë.

Sipas treguesve ekologjikë, në ishull gjenden tetë puse. Kush i ka në pronësi këta tetë puse? Kush e ka në pronësi ujin që buron nga ta, atë ujë që mezi ç'pret të rendë drejt gojëve të zhuritura?

Paris

Ditët e thëngjijve, Hënë e plotë

Dje, Ejola im i dashur, duke u kapardisur hapi rrugën me krahë për tek unë, përmes territ të zbehtë të mendimeve të mia. U ulëm në kuzhinë dhe biseduam deri në mbrëmje. Paskëtaj morëm barkën dhe dolëm për peshkim. Zumë ca merluc. I fola për opinionet e gjyshit në lidhje me peshkimin e tepërt dhe për industrinë e shtëpive të verimit, të cilat përputheshin me shqetësimet kryesore të saj, njëkohësisht edhe tonat. S'para është edhe aq e zakonshme të futesh në të tilla dialogë kaq kohë pasi ke qenë vetëm; shikoj si zhvillohen idetë tona, së pari një rreth, një vijë e mandej diçka me forma më të ndërlikuara, sikur të kenë ekzistuar ngaherë, por sikur kanë pritur dikë që të vijë e t'i thërrasë. Tani ato dridhen në ajër dhe unë thujtse nuk di ç'të bëj me të. Pastruam peshqit që kishim zënë dhe pasi i vumë të marinoheshin luajtëm me katër duar në klaviçembalin e murrmë te aneksi. Luajtëm *Suitë për dy piano* dhe *Allegro diabolico* të Bela Bartokut, i cili në biografinë që ka shkruar thotë se kompozimet e tij kishin synimin e rimëkëmbjes së traditës muzikore nëpërmjet kombinimit të elementeve të kulturës së vjetër fshatare dhe tingëllimit të tij vetjak dhe risisjellës.

E çuditshme se sa shpejt ndodhi pas ardhjes së saj. Dhe më tepër akoma pas ikjes. Më kërkoi të shkoja drejt

saj dhe sapo fluturova drejt kontinentit.

Jam ulur në *La Strasbourgeoise*, *brasserie*-a me një mozaik të vjetër, duke parë perëndeshën e drejtësisë, e cila ka pushtuar pjesën e lartme të stacionit të trenit. Sytë i ka të lidhur dhe në një rën dorë mban një vetëtimë dhe ndërsa në tjetrën një peshore. Bleva një *demi* dhe një kopje të *Le Monde*-t dhe prita trenin për në Strasburg, kur po shkoj të takohem me shoqen time të të njëjtit hall dhe kam ndjesinë se ky takim do të më hapë sytë për një çështje kyçe, se sytë duhet të ishin të lidhur. Gjithnjë kam ëndërruar se diçka që të më hapë sytë dhe gjithçka tjetër brenda meje.

Basel

Dita e Republikës islandeze

Parlamenti i bufëve tanë ngjante si komplet korbash: një bufë kontinentale a veshgjatë, me syze që i binin te hunda dhe thonj të lëmuar, një buf tjetër islandez, bardhosh në fytyrë, me papijon dhe me një çelës te varësja, ndërsa i treti si gomar veshshkurtër, i vogël e me kapele në kokë. Në terrin e kolapsit ekonomik duket qartë syri i bufit i huaj; syri i mysafirit është i shndritshëm. A mund t’i numërosh tradhtitë e tua, more buf?

U takuam në një varkë të vogël me vela poshtë në një nga kanalet e Strasburgut. Bufja veshgjatë e autoritare, mori rremat dhe së pari na foli në lidhje me betejën për të drejtat e romëve pa tokë. Jetesa në një vend nuk ka qenë kurrë tipari dallues i tyre. E njëjta gjë mund të thuhet për gratë sipërmarrëse nëpër botë, të cilat, duke mos pasur një rezidencë të qëndrueshme pasi jetojnë në parajsë fiskale dhe zona pa taksa, s’merren parasysh nga atdhetarët. Për ne, pjesën tjetër, janë si një shi mbeturinash dhe ndotjesh...

Ajo i mëshoi shumë fort rremave duke rrëshqitur mes ujit, duke lënë pas varka shumë më të mëdha. Po ju nga vini ju? Dhe çfarë planesh keni? më pyeti duke lënë rremat mbi varkë për pak çaste.

Ne, rregulluam kapelet e jakat dhe i shpjeguam me

kujdes misionin tonë. Dielli shkëlqente fort mbi varkë dhe uji e spërkaste verbërisht. U përpoqëm t'i përshkruanim se sa energji çohet në Islandë. I folëm për idenë tonë për një rrugë të re të shfrytëzimit të energjisë së Islandës, duke e kanalizuar atë në ekosistemin dhe ekonominë e saj, duke respektuar ciklet e natyrës dhe duke mbështetur kauzën e drejtësisë. Ajo zuri të voziste përsëri dhe i ramë rrotull gjithë qytetit. Kthyem varkën dhe shkuam në një kafene të vogël që lidhej me një urë.

Lërmë t'u hedh një sy shënimeve të tua, më tha duke ngritur syzet nga hunda me majë. Hodhi sytë e lëvizshëm mbi numrat dhe emrat dhe tha se binte erë që atje tej që ishte rast korrupsioni. Na vizatoi një grafik dhe m'u bë sikur më doli përpara me qartësinë më të madhe gjendja e mjerë e infrastrukturës së vendit tim. Dhe sa e madhe ishte përgjegjësia e atyre arinjve që s'donin ta praninin këtë. Por në këtë fazë nuk mund të përmendim asnjë emër; historia e këtij korrupsioni duhet verifikuar në thelb.

Më në fund, i kërkuam këshillë për mbajtjen e një referendumi dhe diskutuam për struktura të reja demokratike, si edhe për ekonominë kombëtare. Kur i thamë mirupafshim, ajo na sugjeroi që t'i kërkonim ndihmë Fajkua symprehtit; ai kishte qenë arkitekt dhe tani ishte bërë ideatori i skemës së re.

Qëndruam te stacioni të lodhura e të etura, pa ditur cilit tren t'i hipnim. Do të shkoni drejt lindjes? Drejt perëndimit? Sërish drejt detit? Jo, vendosëm të shplodhemi pak, të përgatitemi për emigrim, të gjejmë koordinatat tona në këtë bigëzim.

Shkuam të ndërroheshim te banjot e stacionit. Kur hymë në sallën e pritjes ngjanim si hardhuca, ajo me

një fustan ngjyrë bakri, unë me një të kuq me katrorë. U nisëm për në Bazel me trenin e natës. E dinim se atje do të kishte plot hardhuca të tjera. Me ne s'kishin punë, por mblidheshin në një dhomë të madhe të zbukuruar me vizatime me stilolaps.

Basel,
Dita e varkave me vela të maskuara, batica e
pranverës, hëna e plotë

Është mirë të takohesh me artistë pasi ke lexuar ca si shumë mbi ligjet dhe ekonominë. Të freskon imagjinatën.

Të gjithë janë të shqetësuar për vendin tonë të lashtë. Diskutimi në lidhje me Islandën vazhdoi edhe gjatë natës. Merre me mend sikur fëmijët dhe nipat t'u vijë dita që t'u duhet ta blejnë ujin me çmim të lartë prej atyre, që kanë shtënë në dorë furnizimin me ujë. Dhe të bien nën skllavërinë e manjatëve të huaj. Vendi po shembet nën ne; na duhet të luftojmë tani në mënyrë që banorët e ardhshëm të jetojnë në një tokë të sigurt dhe t'i mbajnë kokat lart. Më mirë padronë se skllavër, thoshte dikush në Gjermani, por unë s'jam e bindur nëse kjo është mënyra më e duhur për ta shtruar. Si mund të quhemi të gjithë padronë kur nuk do të ketë më skllavër? Do të jemi të gjithë njëlloj. Të barabartë. Gëzuar, atëherë!

Luajtëm fantazinë për katër duar, e cila pastaj u bë me tetë e gjashtëmbëdhjetë dhe unë këndova *Pashë një zog aty poshtë në plazh* e bindur se të gjithë dëshironim që kënga të vazhdonte, se do të dilte patjetër dikush që do të këndonte *tun, tun, tun, erdhi koha të flesh gjumë... gjumë të*

qetë, gjumë të thellë, por shiko se çfarë kam unë...

Kur u zgjova sot në mëngjes, u ndjeva si një varkë me vela e maskuar, por vetë isha e fryrë si tullumbace. Idealet e mia mbështeten në jastëkë të rreckosur. Mendoza për Niçen, i cili ka qenë profesor këtu në Bazel dhe përpiqej t'u jepte hov strukturave të venitura, por gabimisht hovin ia dha mendjes së tij dhe aty nga fundi bënte biseda imagjinare me kafshët. Në atë periudhë hoqi dorë edhe nga shtetësia prusiane dhe vdiq pa atdhe.

Vërtitesha nëpër kuzhinën e rezidencës së artistëve, ku po rrinte Sila ime e dashur, që më tha se megjithatë, e kishte marrë malli për baticat dhe për njelmësirën e detit. U shërbente mysafirëve sallatë me rrepë të verdhë të grirë hollë dhe kafe me qumësht, ndërsa ata dilnin gjithnjë e më tepër nga ato qoshet e tyre të errëta; për atë ditë feste, ishin mbledhur gjithë sa mund mbante shtëpia. Qëndruam deri pasdite duke folur për hapësirën dhe shtëpitë. Mendova se do të më pëlqente të kisha një shtëpi në bregdet dhe një në brendësi. Ejola na foli për shtëpinë e *Anaïs Nin*-it në Kaliforni, e cila është në stil japonez e me një studio të madhe ku ka tërë qetësinë dhe komoditetin për të shkruar. Kur jetonte në Amerikë shkonte vazhdimisht atje, ishte martuar me dy burra dhe jetonte sa me njërin me tjetrin në dy shtëpi të ndryshme. Kjo, tani, sikur po më habit ca. Të arrijë të bëjë kaq rehat një jetë të dyfishtë.

Kasollja e Strindbergut është ende në ishull, në një pyll. Atje ndodhet ende edhe tryeza e tij e punës, siç i ka lënë ai, tha njëfarë Qeni, duke ndërhyrë disi vrazhdë në bisedë. Në një farë mënyre m'u duk sikur ambienti intim që kishte kërkuar Strindbergu ishte bosh ose negativ, një

intimitet si në ndonjë askund, pasi ai, fuqinë e tij krijuese e merrte nga vetmia dhe nga vetmëshirimi. Nga ana tjetër, mendoj se *Nin*- vërtet kërkonte një ambient intim, por e donte të mbushur me jetë dhe kujtime, pasi dukej se forcën e merrte nga ndërveprimi me të tjerët, ia bëri Qeni. Unë s'di të them nëse këto analiza janë të sakta, por ndoshta kam nevojë për të dyja: vetmi të plotë dhe ndërveprime të këndshme. Nga ana tjetër, besoj se frymëzimi im krijues ka nevojë vetëm për një bashkëshort. Ai duhet të jetë i barabartë me mua. Një burrë, nga i cili të mos kem varësi dhe, i cili të mos varet nga unë, por që zgjedh me dëshirë dhe me gëzim të rrijë vetëm me mua. Pastaj, sigurisht edhe unë do të doja të isha vetëm me të, edhe sikur të më duhej të shkoja në Kaliforni herë pas here.

Tani jam në tren, do të zbres në stacionin *Gare du Nord*.

Stykkishólmur, Solstici i dimrit

Në Paris mbërrita herët në mëngjes. Në *Café Time* piva një kafe dhe kullufita ca bukë të papara me një mjaltë të mrekullueshëm. Shikova me vëmendje hartën e metrosë dhe bëra planet. Më duhej të rendja që të kapja avionin për t'u kthyer në shtëpi, por më parë duhet të kryeja disa porosi. Së pari të merrja librat nga vendi i depozitimit e t'i nisja në shtëpi. Si i thonë një fjale: dorëshkrimet dhe kockat mbahen brenda në shtëpi!), të gjeja një parfumeri të veçantë, e cila shiste aroma të dredhkave dhe të takohesha me Musin, shokun tim të dashur të shkollës, i cili më tregoi edhe lajmet e fundit nga bashkësia e kërkuesve. Së bashku hëngrëm imitime të trurit të majmunit dhe gjuhë viçi të ziera në verë të kuqe.

Atë natë bisedova gjatë në telefon me Bufin. Ai më dha lajmin e habitshëm se pikërisht një ditë më parë, i kishte hipur një dëshirë tepër të madhe për gjuhë viçi, se kishte bërë gjithë atë rrugë me makinë për ta gjetur dhe mandej e kishte gatuar me pure patatesh. Kjo telepati- gjuhëpati- na la të dyve pa gojë. Megjithatë, është vërtet prekëse të dëshirosh këtë pjesë të ndjeshme të një kafshe ndërkohë që ke edhe dëshirën t'i mbrosh ato nga dhuna.

Sot zgjova Helgafellin pa vështruar pas dhe bëri si desha unë. Vizitoi varrin e Guðrún Ósvífursdóttir-it, ku ajo kërkonte qetësinë aty nga fundi i jetës. Mua nuk më kujtohet me saktësi se sa dëshira më lejohej të shprehja sipas traditës, por vendosa për tri: një për natyrën, një për drejtësinë dhe të tretën për dashurinë.

Mendoj për ornitologun. Si duhet të ndihet te ajo shpella e vet? A i merr mesazhet e mia telepatike? Sonte dola të ecja pak në Stykkishólmur, për shëtitjen e zakonshme. Përshëndeta perkujtuesit, të cilët ishin ulur me mençuri te shkëmbinjtë vullkanikë në plazh. Nuk kam më frikë nga zgalemat; del se ata nuk të hedhin vaj stomaku, veç në rast se i kërcënon. Janë të vjetër dhe kureshtarë, në jetën e tyre të gjatë kanë parë shumë dhe duan të shohin gjëra të reja, apo të paktën, kështu më tha Zogu, të cilit unë i besoj për të gjitha gjërat që më ka thënë deri tani.

I telefonova Haukut dhe folëm gjatë në lidhje me mundësinë e një referendumi për vendimet novatore në lidhje me të ardhmen e burimeve të Islandës. Do të takohemi të gjithë nesër.

Tani dielli doli përsëri duke u zhytur në det për një sekondë dhe duke u ngritur përsëri, më herët se kurrë. Ishulli Elliðaey llamburit. Thashë me vete se s'bëj aspak keq sikur të rri gjithë natën zgjuar dhe për mëngjes të ha gjethe radhiqesh, mbase edhe me sardele të konservuara. Nga ato të kuqet, bile. Po përfundoj së lexuari librin e Leonora Kerringtonit, për një grua surreale, që dëgjonte me ndihmën e një hinke dhe që, jetonte në një shtëpi të izoluar në formën e një torte dasme. E kisha dërguar këtu enkas që nga matanë detit.

Ne sajuam një lojë të re: sa kohë mund të turrja duke rrotulluar shtizën në një drejtim . Rekordi im ishte një minutë e dymbëdhjetë sekonda. Mandej ajo u rrotullua në drejtime të tjera.

Stykkishólmur, Solstici i verës, Dita e Eldríður-it

Është dita e solsticit të verës. Dola në mes të stuhisë për të marrë një lule të vogël e për ta vënë poshtë jastëkut me shpresën se do të shihja në ëndërr një burrë në ndonjë shpellë, i cili do të dilte nga dheu si një lule plot me lëng. Sipas kalendarit, atje ka gjithashtu edhe një Ditë të Eldríður-it, e cila duhet të ketë një lidhje me Æthelthryth-in, një murgeshë e shekullit të shtatë, e cila themeloi një abaci në Ely të Anglisë, që u shkatërrua nga vikingët në vitin 870. Por kush ka qenë ai që e ka hartuar këtë kalendar? Më kujtohen mëngjeset me gjyshen në fshat, me të cilën, pasi kjo kishte mbaruar së shërbyeri mëngjesin turistëve, uleshim në tavolinën e kuzhinës, gjerbnim kafe dhe njëra prej nesh do të vinte re se faqja e një dite më parë e kalendarit nuk ishte grisur. Ishte shumë e këndshme të grisje fletët dhe të zbuloje emrin e ditës tjetër. Kalendar i islandez, pjesërisht duket se është i lidhur me kullotjen e bagëtive, pavarësisht se nuk përmenden periudhat e çiftëzimit apo të pjelljes së qengjave. Në të gjenden disa festa katolike dhe ditë feste të krishtera dhe ndoshta një festival pagan apo dy, të lidhur me garat e kuajve. Duhet të ekzistojnë artikuj dijetarësh në lidhje me origjinën e festave fetare në gjithë botën. Mua më duhet të hartoj kalendarin tim dhe, natyrisht ta marr për bazë.

Puthja ime e parë, hera e parë që mu nda zemra në dysh,
brerja e parë e ndërgjegjes, deklarata e parë e pavarësisë,
mendimi i parë i plotë. Si mund të të shkojë jeta me një
kalendar të tillë?

**Stykkishólmur,
Festa e shfaqjes së Marisë, Hënë e re**

Kur bie shi është e këndshme të rrish brenda. Sipas kalendarit është kohë takimesh. Sot ne mbajmë takimin tonë të parë të zogjve, do të flasim për gjëra të ndryshme dhe do të fërkojmë sqepat me njëri-tjetrin. Ne s’jemi hajvanër, por zogj që fluturojmë në formën e një V-je të mrekullueshme. Duhet bërë një plan për ta nxitur kombin që ta dëgjojë këtë zë.

Tani po flas me vete, duke u qetësuar pas poteres; diskutuam shumë e me një pasion të tillë, sa paraqitem një pafundësi shtigjesh për të ndjekur, përveç njërit, që nuk mori miratim nga kombi. Është shumë rraskapitëse kur përpiqesh të gjesh ide të reja për të mirën e kombit. Vras mendjen se si do të ndihesha po ta kisha punën me orar të plotë. A vdesin të djegur të gjithë idealistët? Vështroj detin dhe dëgjoj shiun që godet valët, pikë pas pike.

Kur koha është e lagësht, dielli në një të kuqe gjak fshihet pas ishujve. Pashë filmin *Jeta e të tjerëve* dhe më dolën sytë vendit. Më kujtohet që një shoqja ime, më tha se pas rënies së perdes së hekurt ajo e kishte humbur besimin te miqtë. Miqësia ishte bërë fërtele. Në sistemin universal të besimit dhe të afërsisë johapsinore.

Po ai profesori hungarez, si e quajti veten kësaj radhe? Qen? Tha se gjatë periudhës së totalitarizmit në

vendin e tij, ku gjithçka dhe gjithkush përgjohej, ai kishte gjetur nga një emër kafshe për gjithkënd që njihte. Unë mezi prisja të më thoshte çfarë kishte gjetur mua. Më në fund, më erdhi radha që të thërritesha në mbretërinë e kafshëve: *Përshendetje arush- pellush dhe paç fat në rrugën tënde*. Më pas mora një letër poetike të gjatë, e cila fillonte me përshendetjet, *Ditë të bukur, mbretëresha e arush-pellushëve*.

Nuk më zë gjumi. Dëgjoj përplasjen e thundrave të një plaku të shthurur. Nga horizonti, ato turren e zgjaten gulçuese drejt meje.

U habite që je fare vetëm more arush pellush plak? A e mban mend kur doje të nxirrje jashtë e të shpërtheje brengën tënde dhe gabimisht hodhe gjithçka në erë? Bombat me sahat gabojnë gjithmonë në kohë. Edhe gënjeshttrat i ndotin liqenet e tua të brendshme; retë bëhen gri nga ankthi.

Ishte pushim dhe unë gjithçka e përgatita shumë mirë, doja t'i prisja mysafirët në mënyrë të përsosur, por duke qenë se dëgjova dikë të thoshte diçka të pavërtetë në mbrëmje dhe nuk doja ta filloja vitin e ri me gjëra të lëna pa mbaruar, u tensionova kaq shumë sa më dukej sikur drita më thante kokën. Shpërtheva mu pak përpara se të shpërthenin fishekzjarrët. E vërteta e jetës.

Rreth meje u formua një rreth i zi i djegur dhe askush nuk guxonte të futej. Përveç tim vëllai. Ai, si ekspert gërmadhash, kaloi vijën, më mbështolli me krahë dhe më tha se më kuptonte.

E kisha menduar atë hap. Sa madhështore, kur vjen dikush dhe të ve një dorë qetësuese te plaga.

Mamaja erdhi të shihte nëse ndihesha keq apo jo

dhe më kujtohet se e kuptova që mund të bëja njëlloj edhe pa të. Pas tërë përpjekjeve për të ngritur gjendjen shpirtërore të shtëpisë, shtrihej në divan e rraskapitur. Nuk dija as nëse donte të mbetej vetëm dhe as nëse i bëhej sikur e mbështillte një vello blu. Kisha frikë nga ajo vello. Mendoja se kurrë nuk do të kaloja përmes saj. Ja edhe do e bëja, po kur ama? Por vendosa të shkisja nëpër membranën e padukshme dhe ajo ndihej e lumtur që më kishte pranë.

Mendoj se në ndërtimin e shtëpive në të ardhmen, do të ketë nevojë për një cep të fshehtë të vogël e shërues, ku mund të rrih shtrirë sikur të ishte sipër barit apo poshtë në tokë dhe kjo të ripërtërin. Mandej ngrihesh lart. Krishterimi është ndoshta paralajmërimi i parë dhe kryesor për tu tokëzuar mirë e mirë, në mënyrë drita të mund të veprojë rrotull teje pa të djegur, është një paralajmërim për t'u lidhur me natyrën, për t'u kthyer çdo ditë në pluhur dhe për t'u ngritur po çdo ditë nga pluhuri, për të shkuar përtej ligjeve të natyrës po me ndihmën e ligjeve të natyrës. Ty s'të duhet të varrosësh veten të gjallë, të harros të ngjitesh apo të detyrosh veten të rrosh në pluhur e t'i nënshtrohesh hidhërimit.

**Vegamót,
Festa e Shën Albanit të Anglisë, e Shën
Sunevas dhe e shokëve të tyre**

Po bëhesha shumë merak. Prej një kohe të gjatë s’kisha marrë asnjë lajm nga shpella. Atë ditë e kontrollova pesë herë kutinë postare, por asgjë. Mandej, po atë mëngjes, erdhi postierja duke kaluar mes luleradhiqeve me një vështrim sarkastik në fytyrë, që më bëri të mendoja se duhet të kishte diçka për mua. Me goxha siguri, më zgjati një kartolinë, të cilën e kishte pasur ndoshta gati që më parë, çka është gjë e mirë; kartolinat nga vetë natyra e tyre janë publike. Askush nuk është aq i varfër sa të mos blejë dot një zarf. Në atë kartolinë ishte shkruar ky mesazh: *Jam rrugës për te ti, ke dëshirë të takohemi?*

Në fillim, bëra sikur s’kishte asgjë jashtë normales; poqa patëllxhanët dhe përpiva një libër; më vonë futa disa gjëra në një valixhe dhe renda të kapja autobusin. Hipa, u ula në fund fare dhe zura të vizatoja. Autobusi bëri një ndalesë të shkurtër në Vegamót, ku dje kisha blerë karamеле me jamball dhe ujë me sodë.

Fatmirësisht, shoferi është modë e vjetër, radion e ka vënë në Kanalin 1 dhe askush nuk flet në celular. Unë jam ulur pranë një burri, i cili më tregoi gjithçka për punishten e birrës ku punon, për përgatitjen e saj nga elbi

islandez, por edhe se si janë në prag të falimentimit. Më parë kishte punuar kujdestar në kopsht, por me atë rrogë nuk ia dilte dot; elektriciteti është më i lirë për industrinë e madhe se sa për serrat dhe sistemi i shpërndarjes është kaq joefikas, sa një pjesë e madhe e perimeve dhe frutave hidhen poshtë, në mënyrë që të mbahen të larta çmimet e tregut. Këtë mua s'ma kap truri. Kur do të vetëripërtërihet kjo ekonomia dhe kur do të dalë me teori të reja? A nuk u shënuar një pikë kthese një herë? A nuk mendohej se gjithçka do të ndryshonte? Unë jam tepër e paduruar dhe akullnajat po shkrihen me shpejtësi. Ata anëtarët e këshillit të mjerë të distriktit, të cilët ishin të bindur se po bënin punë të madhe kur i shitën një manjatit të drejtën e shfrytëzimit të ujit nga akullnaja për njëqind vjet dhe kishin besuar në premtimet e tij për zhvillimin e zonës, s'donin asgjë tjetër përveç se ta shihnin në burg për shmangie të detyrimeve fiskale dhe falsifikim. Ca si e vështirë, nëse toka do të shitej e ndarë në copa dhe furnizimi me ujë rrënohet përpara se faqezinjtë të vihen prapa hekurave. Ata janë akoma në gjendje të lirë, me falimentimet dhe – ç'mashtrues- me bishtalecat e tyre të gjatë. Nga ana tjetër, duhet të kesh një veprimtari të qartë kriminale që të marrësh licencën për të ngarë një biçikletë motor. Në atë çast, autobusi lëvizi. I thashë mirupafshim akullnajës, me keqardhje por jo me trishtim.

Rejkjavik

Festa e Shën Maria Magdalenës

Mora hua një makinë nga mami dhe babi dhe u nisna për tek ai, duke qenë se kishte vendosur të dilte nga shpella. E takova në Hveragerði dhe vura re se këmbët i kishte keq e mos më keq. Por ishte mirë me humor, kishte takuar shumë zogj gjatë rrugës, kishte udhëtuar me këmbë nëpër moçalishte ku mbaronte rëra. Kur i duhej të kalonte lumenjtë, Shën Kristofori e merrte mbi kurriz dhe e shpinte matanë në bregun tjetër. Isha tepër e lumtur që po e shihja dhe bëja si e turpshme dhe si e papërcaktuar. I bëra pyetje profesionale dhe tërësore në lidhje me ecjen, sikur të isha duke e intervistuar në radio dhe vetëm paskëtaj u përqaftuam.

Shkova në një farmaci, bleva fasho dhe antiseptikë. Në atë pranverë të nxehtë gurgulluese ai më la t'i mjekojta plagët. Fillimisht ishte ngurues, mandej u shtendos dhe u përkul pas. Jam tepër e lumtur të ndjej se sa me bazë është ai njeri. Si një burrë i një tipi të ri. Dhe ai më foli për Jóhann Sigurjónsson-in që shkroi në vargje një përgjigje ndaj mundimeve: *Kam mbathur çorape të reja, këpucë të reja. S'ia kam frikën askujt në këtë botë.*

Lamë të vendoste poezia, shkuam në dyqanin më të afërt dhe ai bleu këpucë mokasini të zeza. Mua m'u duk tepër e çuditshme; me shumë gjasa nuk ka për t'u mësuar

të ecë dot me asi këpucësh. Isha tejet e ndërdushur, por e mblodha veten dhe nuk lashë të më kapte frika. A janë këpucë tiranësh këto? Këpucë masonësh? Dola mënjanë, i telefonova gjyshes dhe e pyeta se ç'loj këpucësh vishte gjyshi, por ajo më tha se gjithnjë kishte veshur këpucë me lidhëse dhe se nuk kishte qenë mason.

Si rrjedhojë, morëm edhe një tjetër vendim të çastit, për të cilin na kishte shkuar mendja që më parë: të hanim akullore. Me kaushë.

Gruaja, e cila na e shërbeu ishte te të dyzetat, me tatuazhe me forma të bukura pas veshit dhe në sup, ndërsa sytë i kishte si fokë. S'linte sekondë bosh, na tregoi edhe se dyqani ishte plot me fëmijë, me të cilët ajo bisedonte sikur të ishin të rritur.

Duke lëpirë akulloret, ecëm përmes parkingut dhe vumë re se kati i sipërm i ndërtesës që dikur kishte qenë klinika dentare e qytetit, jepej me qira. Vështruam nga dritare dhe shquam një hapësirë të madhe të gjelbër me një shkallare në formë spiraleje, shumë të bukur, si edhe me një parmak druri. Vendosëm në vend ta merrnim së bashku, pa e këqyrur mirë vendin dhe pa pyetur për shumën.

Vendimet tona janë të veçanta: mezi kisha vendosur nëse akulloren e doja me kaush apo me tas, por nuk kisha pasur pikën e ngurrimit të vendosja për ta marrë me qira atë shtëpi sipër shqopishtës.

I telefonuam pronares, e cila na tha se shtëpia lirohej në janar, kur edhe mund të vendoseshim kur të donim.

Pas telefonatës, më erdhi një tjetër mendim- sikur të mbetesh shtatzënë dhe të kisha një dëshirë të papërmbytur për akullore, do të zbrisja drejt e poshtë

te dyqani, do të bëhesha gjithnjë e më e trashë, ai do të largohet nga shqopishtja për në Rejkjavik e nuk do të kthehet më dhe unë do të mbetesha e vetme me një fëmijë të vogël, i cili pjesërisht do të rritej poshtë te ai dyqan.

**Rejkjavik, Rruga Nýlendugata,
Fundi i ditës së qenit**

Deri për vit të ri nuk mund të hyjmë dot tek apartamenti te shqopishtja. Nuk besonim se deri në atë periudhë do të arrinim të gjenim një shtëpi tjetër, por mua dhe tim vëllai na u dha mundësia të merrnim me qira disa muaj së bashku një apartament. Është një masë e përkohshme dhe mjaft efikase. Herë pas here na vinë nipat.

Dje ishte ditëlindja e mamasë dhe bëmë pite në oborr; koha ishte e mirë dhe grenzat tepër të shkathëta. Erdhi edhe gjyshja dhe qeshëm aq shumë, sa për pak unë dhe mamaja nuk bëmë ujët. Zogu më dha zemër të luaja një melodi në organo dhe më tha gjëra të bukura, ndonëse ngaqë isha pa syze i ngatërrova të gjitha notat. Më ka marrë malli të kem një piano në kuzhinë. Ai më tha se në shtëpinë e ardhshme shpresonte që të kishim një hapësirë për instrumente. Vendosëm që një ditë do të jetojmë bashkë. Por deri atëherë, do të përpiqemi të jetojmë veçmas. Kemi radiot marrëse- dhënëse. Ai vazhdon të jetojë po atje, bashkë me peshkun e argjendtë, me të cilin është bërë shok, duke thënë se ata janë prehistorikë dhe tepër të bukur nën disa kushte të caktuara ndriçimi.

Bashkë me Bufin ftuam të gjithë që të shihnin shtëpinë tonë të re, që është ende me kartonë të pahapur

dhe u zbavita kur i shihja si e inspektonin. Gjyshja pyeti për ujin nëse i ftohti ishte i ftohtë dhe i ngrohti i ngrohtë, ndërkohë që mamaja vrojtonte mobilimin e hapësirës dhe nuhaste rreth e rrotull, duke i hedhur një vështrim dyshues banjës. Babai trokiti në mur dhe vriste mendjen se sa mund të dëgjoheshin zhurmat, në rast se do të luanim muzikë pa bezdisur fqinjët.

Na sollën një dhuratë për shtëpinë e re. Një botim shumë të bukur të sagave islandeze. Për t'ia lexuar nipave të vegjël, për të edukuar brezin e ri. Thanë se ishin të kënaqur që unë dhe im vëlla po e ndanim apartamentin bashkë; ne kemi shkuar gjithnjë mirë me njëri-tjetrin dhe tani pas divorcit të tij, është e rëndësishme që po rrimë bashkë dhe po krijojmë një vatër familjare të ngrohtë për djemtë.

Këta do të vinë nesër dhe do të rrinë disa ditë. Do të flenë në dhomën e gjumit. Im vëlla në sallon ndërsa unë te dhoma në qoshe me kutitë dhe librat dhe rrobat në dysheme. Duhet të blej një bufë ose një senduk. Edhe një llambë leximi gjithashtu.

Rejkjavik, rruga Nýlendugata
Festa e prerjes së kokës së Johan Pagëzorit.

Dy nipat e dashur vijnë herë pas here në dhomën time për t'u hedhur një sy gjërave dhe për të këmbyer ndonjë fjalë me mua. Pikërisht tani më pyetën përse ndahen çiftet. Më thanë se nuk e kuptojnë dot. Më duhet ta pranoj se nuk e kuptoj as unë, por me sa mundem përpiqem t'ua shpjegoj gjërat atyre qenushave të dashur. Të përpijnë çdo fjalë e kësisoj, duhet të jem tepër e kujdesshme në ato që them.

Paskëtaj më pyetën për dhunën. Janë të shqetësuar për dhunën që adoleshentët ushtrojnë ndaj njëri-tjetrit dhe ndihen tepër të emocionuar që pas pak edhe ata do të bëhen vetë adoleshentë. Unë doja t'ua thoja se e kishin drejt: një adoleshent është vërtet një qenie që të ngre nervat. Në vend të kësaj u fola për rëndësinë që kanë shokët e betuar, për shoqërinë që i bën të këndshme vitet e adoleshencës dhe për miqësinë e vërtetë që rritet dhe zhvillohet.

Të kesh shokë të vërtetë nuk është një e dhënë një herë e përgjithmonë. Miqësia duhet vaditur si një bimë delikate; këtë jua thotë gjithnjë babai juaj. Ata ishin të shqetësuar në lidhje me shokët e prindërve të tyre e sidomos se çfarë do t'u ndodhte pas divorcit. Do të shohim, u thashë. U treguan tepër të mençur e më treguan histori nga shkolla, për shokët që nuk i kanë më shokë,

për ca të tjerë që janë të pandarë e rrinë gjithnjë bashkë dhe për disa që duket se s'kanë asnjë shok. Unë u thashë se e vija në dyshim që të ekzistojnë njerëz që nuk duan të kenë shokë. Nëse është kështu, atëherë i bie të jetë thjesht një mekanizëm mbrojtës dhe ata dukej që kishin frikë se mos nuk ishin të mirë si shokë, apo se mos askush nuk do të donte të bëhej shok me ta.

Thanë se babain e kanë si shok dhe se i tregojnë gjithçka. Unë e miratova, ai vërtet është shok i mirë për djemtë. Më pas ranë në shtrat dhe unë u lexova një kapitull nga saga islandeze. E dinin përmendësh *Njal's Saga*-n, pasi e kishin dëgjuar shumë shpesh në makinë. Luanin me njëri tjetrin sikur ishin *Kári* apo *Gunnar*-i. Më pyetën kush më pëlqente më shumë. S'e dija mirë.

Dritarja e vetme që hapet në shtëpi është ajo e dhomës sime dhe unë e lejoj vëllanë e vogël, babain e nderuar të dy djemve, të vijë ndonjëherë dhe të pijë duhan. Erdhi para se djemtë t'i zinte gjumi. U ul mbi shtrat dhe folëm një çikë për gjëra të ndryshme.

Më pyeti për partnerin tim të fundit dhe dukej se vërtet i pëlqente të dëgjonte për të. Më tha se i bëhej sikur edhe vetë kishte rënë në dashuri me të pikërisht prej mirëkuptimit që kishte për mua dhe se ndiente një gëzim mirëkuptues. Ju të dy duhet të rrinin bashkë, shtoi, por unë i thashë unë ndjesia që më dukej sikur po e ndaja me të mund të ishte një zgjidhje e mirë. A je i sigurt se nuk mund të dashurosh kurrë një burrë? E pyeta disa herë dhe ai shtoi se nuk ishte e para që e pyesja.

Më tha se seksualisht i kishin pëlqyer gjithnjë gratë, por se nga ana tjetër, kishte dashur fort burra, por në një tjetër mënyrë. Më tha për shembull se për disa vite ai

kishte patur njëfarë ndjesie kundrejt të dashurit tim; i dukej i këndshëm dhe simpatik. Edhe im vëlla, njëlloj si unë mendon se ne të dy shkojmë njëri me tjetrin. Mbase na duket neve kështu ngaqë ai të ngjan një çikë ty, e pyeta. Jo, im vëlla s' ishte dakord. Atëherë mos është tepër i ngjashëm me mua? E pyeta.

A mund të ishte e vështirë të jetoje me një shkrimtar tjetër? A nuk shkruante edhe ai në kohën e lirë? më pyeti. Po, ashtu bën tani, por ka vënë në plan të fillojë të shkruajë me kohë të plotë. Kështu, do të garojë me ty si shkrimtare; në këtë rast kjo mund të jetë më e mira për ty që të shtosh shpejtësinë, ia bëri gjithë me mençuri.

Ramë dakord se garimi në dashuri dhe në miqësi është një gjë tepër e keqe. Ai me vështirësi përpiqet t'u ngulisë djemve në kokë se nuk është aspak gjë e mirë të vihesh gjithnjë në garë, por më kot: ata gjithë kohës bëjnë garë njëri me tjetrin. Përse jemi kaq kundër garimit? e pyeta. Mandej ra zilja e telefonit, ishte gruaja e tij e re dhe ai shkoi në sallon.

Unë gjithmonë e kam respektuar për faktin që nuk shfaq xhelozë, madje kështu bënte edhe kur unë, si motra më e madhe arrija të merrja më tepër vëmendje. Ai gjithmonë tregonte solidaritet dhe thoshte se nuk ishte gjë e lehtë të ishte kloun siç do të përfundoja unë.

Më kujtohet një film që kam për një fis të vogël në Mongoli, ku gratë jetonin në paqe dhe në harmoni me vëllezërit e tyre. Baballarët e fëmijëve ose të dashurit u shkonin për vizitë, duke u çuar fëmijëve xhupa- për shembull- dhe i shpinin në shkollë. Nuk më kujtohet pothuajse se ç'kishte të mirë në këtë sistem, përveç se dukej se shmangte dhunën. Burrat vëllezër ishin të paparë

dhe bënin sa mundeshin për punët e shtëpisë, ndërkohe që ata, të cilët ishin baballarë dukeshin më pa fat. Bashkëshortet nuk prisnin shumë prej tyre. Unë nuk kam patur kurrë frikë të jem e afërt me tim vëlla. Pa dyshim, si adoleshente isha e shqetësuar se mos ishte e panatyrshme që më merrte aq shumë malli për të dhe që kisha një frikë të vazhdueshme se mos i ndodhte gjë. Ai më tha se një herë ishte ndjerë paksa çuditshëm që donte të bëhej kaq i afërt me miqtë dhe familjen e tyre. Përse duam diçka të tillë? më pyeti. Ndoshta sepse ne jemi rritur për të qenë pranë, i thashë. Në një farë mënyre, a nuk është babëzi të duash gjithnjë këtë? e pyeta. Po, sigurisht, iu përgjigja dhe vendosëm të tregoheshim të kujdesshëm.

Sidoqoftë, kam nevojë të jem e kujdesshme të mos përdor afërsinë tonë si një armë kundër ndokujt, me të cilin jam e lidhur. Duket se intimiteti që zhvillohet nuk matet kurrë me dashurinë e pakushtëzuar që kam për tim vëlla. Nuk më kujtohet ta kem bërë me dëshirë, ndonëse mund të kem gjetur strehë në krahun e dashurisë vëllazërore kur kam pasur frikë se mos më tradhtonin apo se mos mbetesh vetëm. Po, ka shumë mundësi. Turp të më vijë.

Pardje më shkrepni në kokë ideja se të gjithë burrat, me të cilët kisha jetuar, bëheshin pak xhelozë për lidhjen time me tim vëlla. Dhe mbase gratë e jetës së tij, në një farë mase, duhet të kenë qenë po ashtu të sikletosura. Mundet, por s' di ta them me siguri.

Sigurisht, duhet të jesh i kujdesshëm dhe të mos lesh asnjë dashuri të pakushtëzuar të të përmbysë intimitetin me të tjerët, veçanërisht nëse janë të ndjeshëm apo të pasigurt. Mua më duket e çuditshme se si dashuria

e vërtetë mund të jetë një forcë shkatërrimtare. E hamendësoj, ndonëse vetëm herë pas here. Ndoshta po bëj një gabim tepër të madh që po jetoj me vëllain. Kjo është tipike kur mendon se po bën veprimin e duhur, se je i paqortueshëm! *Rruga për në ferr është e shtruar me qëllime të mira*, thoshte murgu i mesjetës, përpara se të rrëkëllente një vozë të tërë me verë të kuqe.

**Rejkjavik, rruga Nýlendugata,
Festa e Shën Egjdit
(heremit nga Provansa, me origjinë greke,
mbrojtësi hyjnor i ulokëve)**

Ai tha se e kishte vënë re, për mërzinë e tij të madhe, se e qeshura e djemve nuk ishte aq e shpenguar si më parë. Ndoshta duke dëgjuar aq shumë sagën e *Njál-it*; mos kisha qenë gjë unë budallaçka që u kisha thënë se personazhi im i preferuar ishte Skarphéðinn-i? më pyeti, duke rënë në mendime. Mandej m'ua kujtua koha kur vetë im vëlla kishte reshtur së qeshuri me atë gëzimin që ke kur përkundesh në valët e lehta dhe jam tepër e sigurt se nuk i duhej vënë faji sagës së *Njál-it*.

Pastaj, krejt papritur i erdhën disa kujtime të harruara prej kohësh. Ishte në klasë të parë në Rejkjavik dhe kishte vënë re se e qeshura me të madhe e tij nuk pëlqej; kur qeshte, disa vajza bënin fytyra, ia shkrepnin gazit me dashaligësi dhe përpiqeshin ta përqeshnin. Në atë çast, ai vendosi të mos qeshte si idiot. Ishte shtatë vjeç.

M'ua kujtua gjithashtu një pushim në fillim të vitit shkollor, kur veshur me një xhup blu rrinte pranë një muri gri prej betoni, ktheu fytyrën nga muri dhe nuk fliste asnjë fjalë. Unë iu afrova dhe i thashë diçka, por ai më bëri shenjë me një këmbë se nuk donte. E shihja nga larg dhe në zemër ndjeva një dhimbje të mprehtë. Kur u ktheje, pashë edhe se

të gjitha sistemet mbrojtëse i kishin rënë.

Në fakt, s'mbaj mend që ta kenë rrahur ndonjëherë në shkollë. Për vete merrja gjithmonë pjesë nëpër lojëra, ndonëse kisha syze të trasha dhe quka, pasi mësues Sveinbjörn-i, ishte shumë i mirë dhe u kushtonte vëmendje të gjithë nxënësve. Ndërhynte menjëherë qoftë edhe për rastet më të vogla të agresivitetit dhe i diskutonte me ne. Megjithatë, mbaj mend po ashtu, se nuk i kuptoja rregullat e lojërave dhe nuk doja të merrja pjesë, pasi më dukeshin të mërzitshme dhe të pakuptimta. Ndonjëherë bashkë me tim vëlla dilnim në oborrin e shkollës, bisedonim dhe shihnim mos kishte ndonjë gjë interesante në plehrat andej rrotull.

Ndoshta e bënim ngaqë nuk kuptonim se sa shpirt gare kishte ai. Kjo ndodhte kryesisht sepse në shkollat e fshatit nuk kishte mjaftueshëm nxënës sa të formoheshin skuadra. Nxënësit nuk ishin të një moshe; mbledheshim të gjithë në një klasë dhe mësuesit na mësonin të mos vrisnim mendjen për të tjerët, por të arrinim qëllimet që i kishim vënë vetes dhe të përpiqeshim ta bënim duke u mbështetur në aftësitë tona. Kjo ndodhte kur ekzistonte akoma shkolla fillore e bashkisë së distriktit të Fjöll-it, siç ekzistonte edhe vetë distrikti. Të gjitha mësimet përveç muzikës na i jepnin nëna dhe babai; për këtë shkonim te gjyshja, e cila luante në organo e na mësonte këngët dhe meloditë më të njohura popullore. Pas kësaj shkonim te hauri i bagëtive me gjyshin, ku ai na mësonte të ecnim mes dhenve pa u folur.

Mandej erdhi një mësues ende student, i cili padyshim kishte bërë mirë që jepte mësim në shkollat e vogla të Islandës. Ai na shpjegonte teoritë e fundit të psikologjisë

dhe diskutonim bashkë për ciklin e ngacmimit, i cili është i dëmshëm si për atë që e kryen, ashtu edhe për viktimën. Nëna dhe babai e kishin shqetësim të madh gjetjen e mënyrave për thyerjen e ciklit të dhunës. Ose ndoshta jo aq për të thyer ndonjë gjë, por më saktë për të dalë nga fushëbeteja.

S'kishim shumë që ishim vendosur në qytet, kur u gjendëm para një zënke tepër të dhunshme. Isha jashtë bibliotekës së qytetit, djemtë po vishnin atletet, kur si mua, si Bufin, na qëlluan në stomak dhe na plasën poshtë mbi dëborë. Mos na bënë gjë helaq e kishim gjë të shkruar në ballë që vinim nga fshati e që në qytet s'na honepsnin dot? Babai nuk na e tha kurrë dhe kur im vëlla, më në fund u fut në shkollën publike u përfshi në shumë zënka. Deri atëherë, mësimet i kishte marrë nga mësues që shkonin e vinin.

Unë dhe ai u futëm në kurse xhudoje për të mësuar si ta kthenim forcën e kundërshtarit në përparësi tonën. Ishte vërtet e këndshme të mësoje diçka fizike dhe sa herë mendoja që po na afroreshin adoleshentë të egër, vizatoja një *ippon*. Por aspekti garues kërkonte kohë dhe pikërisht për këtë arsye vendosëm ta linim. Nuk mjaftonte të mësoje lëvizjet: duhet të merrje pjesë në ndeshje. Por ne nuk donim ta kompletionim- donim thjesht të luanim. Mësuesit i erdhi tepër ligisht dhe na shpjegoi se si funksiononte sistemi për fat të keq. Kështu e ndërpremë; dolëm nga ringu i mësimit, që ishte menduar të na ndihmonte pikërisht për të dalë nga ringu i zënkave.

Rejkjavik Ekuinoksi i vjeshtës

Cobani dhe miqtë e zogjve u kthyen papritur
Çmbrëmë, trokitën në derë dhe u dhamë një mirëseardhje të ngrohtë. Pasi u puthëm me mysafirët, i zoti i shtëpisë hapi një shishe uiski nga më të mirët dhe na mbushi gotat. Diskutuam për vitet e shkollës fillore dhe e pyetëm për përvojën e tij, nëse e kishin rrahur ndonjëherë në Breiðholt. Ai na deklaroi se filloren e kujtonte vetëm e vetëm si ferr. Në shkollën e tij, disa djem kontrollonin gjithçka dhe gjithkënd sipas disa rregullave të pakuptueshme. Ditën e parë e kishin rrahur, po njëlloj edhe ditën e dytë dhe po ashtu edhe të tretën. E pyeta nëse kishte arritur të mësohej me këtë, se mos i pëlqente ta rrihnin, pasi përndryshe ishte e pamundur të ndodhte. Të nesërmen dikush e kishte sulmuar rastësisht në rrugë. Sigurisht, pyetja ime ishte e pavend dhe e papërshtatshme.

Sonte do të rrijë këtu. Do të flejë poshtë një feneri, por unë do të shkruaj pak gjatë, ulur në tavolinë e duke i dëgjuar frymëmarrjen.

U zhvesh me shumë mjeshtëri dhe pyeta për tokëzën e rripit të belit në formë kafke. Është një zog i rrallë grabitqar, më shpjegoi.

Bufi dhe Zogu, që të dy kanë rripa të tillë. Edhe djemtë e vegjël i duan me po atë tokëz me kafkë. Me figurën

e ndonjë koke ujku apo gjarpri, ky i fundit mundësisht helmatisës. Këto janë mburojat e pëllumbave, mbrojtësit e zogjve të vegjël dhe lejlekëve kakaritës.

Bashkë me nënën dolëm të bënim një shëtitje të gjatë si edhe të diskutonim për disa gjëra. Gjatë rrugës u hidhja nga një vështrim shtëpive. E pyeta nëse e kishte pasur të vështirë të ndërtonte shtëpinë tonë, e cila jetë e mot dukej në fazë ndërtimi. Sigurisht, për njëfarë kohe ka qenë vërtet e vështirë, por është vërtet këndshme të merresh me një shtëpi, e cila jeton e ndryshon vazhdimisht. Shtëpitë, janë si trupat: kërkojnë gjithmonë mirëmbajtje. Një shtëpi nuk mbaron kurrë së ndërtuari. Më e mira është ta shohësh si një projekt të pambarimtë. Mua më duket e çuditshme dhe ngushëlluese që të dëshmoj këtë trimëri të madhe të sajën. E mbaj shumë mirë mend se ç’kohë e pafundme u është dashur prindërve të mi për të ndërtuar atë shtëpinë, çka më bën të vështirë të mendoj se një ditë do të ndërtoj timen dhe prandaj nuk kam bërë kurrë asnjë përpjekje.

I thashë se jam e bindur që nuk do të jem një nënë që s’e vret mendjen. Jo, më tha, pak e nga pak do të mësohesh; e pabesueshme, por e vërtetë. Pastaj më pyeti nëse doja që shtëpinë time ta ndërtoja bashkë me të dashurin. Më tha se nuk kishte kuptim që të prisja sa të krijoja besim të plotë dhe pastaj të filloja të ndërtoje jetën dhe shtëpinë njëkohësisht; duhet të fillosh të jetosh me një njeri që e

do shumë dhe besimi vjen me kalimin e kohës.

Shkuam te gjyshja për kafe dhe i kërkuam të na shpjegonte vendet ku kishte jetuar gjatë jetës, hapësirat që kishte pasur për vete. Ajo aq donte dhe e filloi përshkrimin në mënyrë sistematike dhe gjithë entuziazëm, duke filluar nga salloni i vjetër ku kishte lindur dhe ku rrinte si një varkë me vela duke dëgjuar pulat në çati. Pastaj më përshkroi papafingon, e cila ishte territori privat i saj dhe i së motrës dhe ku dritaret binin nga deti. Më pas na foli për dhomën e gjumit në shtëpinë e prindërve në veri dhe dhomën e vogël që e kishte marrë me qira bashkë me një shoqen e saj. Mandej na përshkroi një më një dhomën e saj dhe të tjerave në konviktin e vajzave në Rejkjavik, aneksin e gatimit dhe dhomën e qepjes ku kalonte shumë kohë. Edhe dhomën e zogut në katin e njëzet në kullën e bakërt në Nju Jork. Ajo na tha se kudo kishte pasur panoramë të bukur. Si tani, që nga dritarja e saj duket mali Esja.

Duket se me tu rritur e deri sa mbeti e ve, se pati kurrë një dhomë të sajën Nga ana tjetër, gjyshja e saj, e cila kishte jetuar me ta në shtëpinë e fëmijërisë, e kishte pasur një dhomë më vete, dera e së cilës hapej në një orar të caktuar gjatë ditës. Madje, kushdo që donte, mund të futej brenda, të vështronte nga dritarja, të dëgjonte historitë e saj dhe të kalonte kohën këndshëm.

Rejkjavik
Festa e Shën Gall-it
(një murg irlandez, i cili ia dha kulaç
me xhinxher ariut

Si sot pesëdhjetë vjet më parë, mes rrënojave të shtëpisë gjeta majën e shtizës, më tha babai, përpara se të shtonte se një arkeolog nga Rejkjaviku kishte ardhur, e kishte këqyrur gjithë nderim dhe kishte thënë se bëhej fjalë për një shtizë vikinge. Kishim shpresuar gjithmonë se do të kishte fatin të vendosej në ndonjë eksponat të Muzeut Kombëtar, por me shumë gjasa duhet të jetë ende në ndonjë depo kushedi se ku. Babai luftoi me shkopinj me tërë pirgjet e dëborës që ngjanin si antikë. Më pas, arriti të gjente një armë të vërtetë dhe interesi i tij kaloi te shkencat. Mbante mend arkeologun, i cili kishte ardhur nga veriu, se si mbrëmjeve ulej në divan e tërë mençuri lexonte një libër.

Doja të kisha mundësinë të lexoja ditarët e vjetër të babait; gjendeshin në një arkë në qilarin e Þingeyjar-it Ai bënte shaka e thoshte se do të m'i jepte atëherë kur edhe unë do ta lejoja të lexonte ditarët e mi. Thoshte, gjithashtu se ato që kishte shkruar ishin thjesht konstatime vetjake mbi motin, si ato të punëtorëve të fermave, që rrinë në një dhomëzë e shkruajnë mbi stuhitë e mbi kukudhët, me pallton hedhur supeve e me libra mbi gjunjë. Jam e

sigurt se nga përshkrimet që njerëzit i bëjnë kohës mund të kuptosh edhe gjendjen e tyre emocionale.

Rrallëherë e kam parë babain të zemëruar, por dje e dëgjova që i bërtiste një burri i cili e kishte cilësuar kasollen e tij të vogël prej torfe si *bungalow* për turistët. Ai ngulte këmbë se kasollja ishte e hapur për të gjithë dhe se kushdo që i binte rruga andej ishte i mirëpritur e ta përdorte sipas dëshirës. Por ndonjë tregtar i pacipë ofrohej pa leje dhe pa kërkuar as të falur... M'u duk sikur edhe pak duhej që tim eti t'i binte ndonjë goditje në zemër

Rejkjavik
Dita e të vdekurve,
Festa e kokës qengjit të pjekur, Dita e të gjithë
shpirtrave

Sot është ditëlindja e të dashurit tim. Po shkoj në qendër të qytetit t'i blej ndonjë gjë të bukur, mbase një palë dylbi dhe librin mbi metrikën të Sveinbjörn Beinteinsson-it, ndonëse kam përshtypjen se duhet ta ketë. Sikur ia kam parë diku në një raft. Është vjershëtor më i zoti se unë, por e pranoj që kam shumë dëshirë të ushtrohem; kështu një ditë mund të thurim vargje së bashku. Gjithashtu, do t'i jap pllakën e vjetër të varrit që ma kishte dhënë gjyshi. Është e madhe dhe e zezë, me bordura të kuqe gjak, por nuk ka asnjë shënim, vetëm një hapësirë boshe për kufomat e ardhshme. Është më e përshtatshme që ta mbajë ai, duke qenë se ka lindur ditën e të vdekurve. Bufi dhe unë do të shkojmë të gatujmë qullin me gjak dhe të ftojmë për darkë djalin që ka ditëlindjen. Mbase, tek apartamenti poshtë, sonte do të dëgjojmë kasetat e vjetra me muzikë *death-metal*. Do të bisedojmë edhe për jetën dhe për të ardhmen. Apartamentin që kam bashkë me tim vëlla do ta lemë së shpejti. Çështje kohe, deri sa unë të hedh hapin gjigand dhe të blej një apartament timin. Apo ndonjë shtëpi në fshat. Nëse do të filloj ndonjë punë më të mirë, do të kem

të ardhura më të mëdha dhe kësisoj do të rresht së jetuari duke e shtyrë deri në fund të muajit si ndonjë balerinë cirku plakë me reumatizëm. Mund të marrim me qira apartamentin në Hveragerði, çka mund të ishte zgjidhje e mirë për mua. Dhe mandej, sigurisht do të fillojmë të mendojmë për dyshemenë dhe pajisjet hidraulike. Dhe paskëtaj, do t'ia kalojmë bukur.

Këto ditët e fundit, kam qenë e mbytur deri në fyt për çështje të shoqërisë dhe interesit kombëtar, çka do të më bëjë mirë. Por do të më kërkojë tepër këmbëngulje dhe saktësi për të vazhduar me çështje, të cilat janë lënë disi mënjanë nga debati publik. Fillon e ndihesh si një djall, të cilin njerëzit përpiqen ta dëbojnë nga trupi, por që çohet sërish e sërish duke kakaritur dhe duke rënkuar. Disa veshë janë të mbushur me korrupsion dhe me sallatë *rémoulade*. Fatmirësisht, janë pak djajtë, që bëjnë çmos për t'u dëgjuar.

**Rejkjavik, Rruga Nýlendugata,
Festa e Shën Nikollës**

Këtë mëngjes Bufi kishte një intervistë pune, ku do të shkonte drejt e nga gërmimet arkeologjike ku ndodhej, pis i tëri dhe me xhaketën e vjetër të lëkurës. I kujtova se mund të kishte njerëz, të cilët do të bezdiseshin nëse ai do t'u qelbte dyshe-menë në mes të ditës. Ekspertët e sjelljeve profesionale do të vinin një X anash zërit “Sjellja e konkurrentit” dhe do të shkruanin komentin e mëposhtëm: “I pisët, me një vëth, varëse dhe tatuazh”. Kështu, veshi një xhaketë të bukur dhe vuri një kravatë leshi me katrorë.

Shpesh kam thënë se im vëlla është kokëfortë. Këtë shprehje e përdor për ta mbrojtur; nuk e kam kuptuar se çfarë kanë parasysh njerëzit kur thonë kështu. As ai vetë nuk e pranon. Si manifestohet konkretisht? Është arrogant? Jo, nuk është. Më tepër mund të thuhet se s'para ia ka qejfi të lodhet. Çfarë e bën një njeri që të quhet kokëfortë?

Rejkjavik, Dita e thëngjive

Për mua, janë më kokëfortë ata burra, të cilët kanë shumë besim te mashkullëria e tyre, se sa ata që mund t'i lejojnë vetes të luajnë me këtë aspekt dhe të zhvillojnë anën e tyre femërore. Por nga vjen ky besim dhe kjo aftësi për të luajtur? Nga toka apo nga qielli? Nga hëna? A mund të jetë kokëfortësia një rrymë që rrjedh në kokat e atyre, të cilët janë të hapur ndaj një konteksti më të gjerë se sa egot vetjake, por që arrijnë ta mbajnë nën kontroll kur kjo u rrjedh brenda vetes, pikërisht si pjesë e një konteksti më të gjerë? Ndoshta burrat kanë nevojë të tokëzohen dhe të çtokëzohen, me këlyshët e qelbur që i nxjerrin me shkelma nga qelbësirllëku, por mendjet e tyre, kur bashkëveprojnë me ciklet e natyrës bëhen të mençura dhe të përrulur. Kjo lidhje është tepër e ndryshme nga rrënjët e ngulitura te disa burra e te disa gra, të cilët i lanë lidhur bishtat e tyre me sistemin ekzistues dhe vërtiten në vorbullën e përrjetshme të pushtetit, ndërkohë që pandehin se janë të pavarur dhe të spitulluar. Nga njëra anë bëjnë lajka gjithë kohën, nga tjetër kërcënojnë dhe japin ryshfete andej-këndej. Por ata bishtat e tyre, befas lagen. Sa më thellë të gërmosh, aq më i lartë bëhet pirlgu me dhé.

Pranova të jepja disa leksione mbi ripërtëritjen dhe alkiminë për një grup të vogël, por entuziast grash në një kurs edukimi të vazhdueshëm. Më kishin ofruar një shumë të mirë për këtë dhe m'u duk një fat i madh që më erdhi m'u përpara Krishtlindjes. U përgatita mirë, pasi doja t'u paraqisja një perspektivë të re atyre grave, për të cilat më kishin thënë se ishin të thekura pas demokracisë.

Takimi ishte lënë në një shtëpi të misterioze në Pond; zgjedhja e këtij vendi m'u duk paksa e pazakontë, por nuk e vrava shumë mendjen. Fillimisht, pashë një Shllafari tërë me kafe, me torta me çokollatë, por s'mora gjë dhe u hodha një sy pikave kryesore të leksionit që do të mbaja. Gratë filluan të mbërrinin me veshje të modës së fundit, me flokët të mbledhura topuz. Më shtrëngonin fort dorën duke më vështruar drejt e në sy dhe më pyetën nëse isha unë ajo që do t'u flisja për librin tim të çmendur. Mbase po bënin shaka, por unë nuk qesha, dhe nuk dija çfarë të thoja. Edhe unë isha e habitur që po i shihja në atë gjendje. Doli se ishin të hurit e të litarit, që kishin një mendjemprehtësi strategjike dhe luanin një rol aktiv në mbytjen e anijes kombëtare, në trupin e së cilës hapnin vrima pa pikën e turpit. Tani ato pretendojnë se punojnë për interesin publik dhe thonë se kështu kanë vepruar

gjithmonë, por që kriza ekonomike globale i ka penguar.

Më kap inati me veten që nuk ua përplas në fytyrë dhe nuk iki. Më kujtohet se nuk isha e sigurt, mbase ato ishin njerëzit më të mirë në anijen e duhur, dhe keqardhja e tyre mund të ishte kaq e thellë sa ishin të hapura për një rilindje mendore. Kësisoj e mbajta leksionin deri në fund, duke e vënë theksin tek demokracia e pjesëmarrjes dhe te prona publike, por njëra prej tyre ia bëri: “Më falni, por unë kam arritur në përfundimin se populli është idiot”. Po, mund ta thoni. Të paktën unë vetë jam idiote. Që besoj se ti, ti moj “zengjine e re dhe premtuese”, mund të kesh pak cipë në faqe; se mendoja që nëpërmjet pendesës, ti mund të kesh një qasje më të përulur.

Ti je njeri krijues, më tha aty nga fundi njëra prej tyre. A të funksionojnë të dyja hemisferat e trurit kur mendon? Nuk më kujtohet përgjigja; mendja më ishte bërë si një vrimë e zezë. U thashë mirupafshim me mirësjellje dhe dola nëpër llohë.

**Rejkjavik, rruga Nýlendugata,
Festa e Shën Þorlákur-it**

Nuk e kam shumë të qartë nëse vjen ngaqë jam te të tridhjetat apo për shkak të shpirtit të stinës dhe pushimeve që po afrojnë, por e kam kapur veten duke menduar miqësinë më shpesh se zakonisht. Më duket sikur gjithçka e shoh në një dritë të re. Linjat bëhen më të qarta: me disa njerëz kam gjëra të përbashkëta, me disa të tjerë jo. Nuk mendoj se të thuash gjëra të tilla kërkon një gjykim. Më së shumti ngjan me njëlloj realizmi, apo sido që ta quash. Por kjo nuk e ndryshon faktin se marrëdhënia jote me ata, të cilët gjenden në të njëjtin shteg, ka nevojë të rindërtohet në të gjitha kryqëzimet.

Sonte, bashkë me Bufin mbështollëm dhuratat dhe biseduam për gjëra të ndryshme nga vitet e adoleshencës sonë. Për një numër të caktuar vitesh, mbase dhjetë, s'kemi qenë të afërt njëri me tjetrin. Më dukej sikur kisha nevojë që të mos merresha me të. Dhe mendoj se edhe atij s'ia kishte qejfi të dëgjonte përfundimet e mia psikologjike, gjatë periudhës kur shkoja te terapisti dhe filloja të analizoja marrëdhënien tonë me babain dhe nënën e kështu me radhë. Ai s'ishte gati për këtë. Por mandej, një ditë ndodhi; më kujtohet se po ecnim në Bruklin dhe ai më pyeti në lidhje me psikikën time.

Sonte folëm për këtë, dhe unë i kujtova se sa e gëzuar

isha kur u ribashkuam. Sikur shpirti dhe trupi kishin gjetur paqe me njëri-tjetrin. Është e çuditshme të harrohet kjo, thuajse nëse marrëdhënien tonë e marrim si të mirëqenë që të jetë kaq e mirë.

Në të njëjtën kohë, rrugës duke u kthyer për në shtëpi i rikujtova se çfarë mendoja. Mendoja se duhet të isha e kujdesshme që të mos mbetesha tepër e kënaqur nga biseda dhe të respektoja tërë atë kohë që kishte kaluar, të shmangja iluzionet se mund të ktheheshim pas në kohë dhe se rolet tona nuk kishin ndryshuar. Unë nuk kam nevojë të shqetësohem, e të bëhem motër urdhëronjëse. Duhet të mësoj të luaj me të në një tjetër mënyrë. Kam një mundësi të shkëlqyer që të ushtrohem sa herë që ai vjen e pi cigare te dritarja e dhomës sime.

Kam ndjerë djersën e tij gjatë natës dhe kam dëgjuar si i këputej zëri kur fliste si patë. Mrekullohesha kur e shihja se ç'burrë i pashëm po bëhej. Po mbetesha e zhgënjyer kur e pashë që kishte ndezur një cigare *Gitanes* apo *Gauloises*, nga ato pa filtër. Nuk më kujtohet me saktësi marka; të paktën pinte cigaret, të cilat e dija se babai i mburrte dhe thoshte se ishin më të mirat. Kur erdhi në shtëpi, s'kishte njeri tjetër. E pyeta nëse mund të tregohej pak më origjinal suke parë se kishte vendosur të imitonte verbërisht babain. Ai më tha se s'kishte të bënte fare me këtë. Ti shkatërron trupin adoleshent, i cili edhe kështu ka filluar të kalbëzohet para kohe? Përse nuk do ta lesh të zhvillohet?

Mbaj mend se si u përpoq edhe një herë tjetër të linte duhanin, por unë e këshillova të priste, në mënyrë që të shmangte gabimin që bëri babai, i cili vendosi ta linte pak përpara se të nisej për një udhëtim dhe gjithë

kohën ishte me humor të prishur e mallkonte turistët idiotë. Natyrisht, nuk është kurrë mirë të shtysh njerëzit që të përpiqen të mos ndjekin gjurmët e baballarëve; kjo thjesht u rrit sistemet e ndryshme mbrojtëse, së pari nga baballarët, e së dyti nga vetvetja. Dhe më në fund, ai u zemërua kaq shumë me mua, sa ma mbylli në turi. Më telefonoi pas pak që të më njoftonte se kishte vendosur ta fillonte përsëri duhanin dhe pasi bëri një pushim për të thithur cigaren e parë, më tha se nuk kishte ndjerë kurrë më keq se sa kur debatonte me mua. Edhe në do të thoja të njëjtën gjë.

Akoma sot, kur është e nevojshme, bëjmë përpjekje për të debatuar; duhet të mësohesh arrish ta mbash pak nën frë karakterin tënd kur e sheh se merr frymë me siklet. Afërsia duke të jetë si uji që rrjedh; nuk duhet të rrijë ndenjor e të tharohet.

Rejkjavik Dita e fëmijëve

Në ishullin e vogël- edhe në të madhin, me thënë të drejtën, rrëshqita me patina mbi akull dhe bëra shumë xhiro. Kisha marrë me vete edhe fëmijët dhe së bashku sajuam lloj-lloj marifetesh për t'u ushtruar me patinimin së prapthi. Hëngrëm çokollatë të ngrohtë te bregu, shplodhëm këmbët e mandej u ngritëm të bënim edhe një xhiro tjetër duke i rënë gjithë ishullit rrotull e rrotull.

Bufi dhe Zogu dolën të gjuanin për thëllëza. U kthyen duarbosh, por të lumtur. Qeshnin shumë dhe ngacmonin njëri-tjetrin- Zogu tallej me frikën e Bufit nga skifterët antarktikë, ndërsa ky i fundit nga qëndrimi i dyzuar i tjetrit kundrejt armëve të zjarrit. Kësisoj, e pyeste se kur do të mblidhte mendjen në lidhje me vlerën e gjuetisë së skifterëve arktikë. Më pas ua vunë fajin syzeve; si njëri si tjetri i kishin xhamat aq të trashë, sa nuk arrinin të merrnin dot asgjë shënjestër, por qëllonin përgjet e dëborës njëri pas tjetri. Sado që ky lloj shpendi ka mishin më të shijshëm ndër gjithë të tjerët, me zemër e ndienim se duhej të deklarohesh specie e mbrojtur.

Ata drodhën cigare dhe pyetën nëse gjendej ndonjë pije, që të merrnin pak veten. Unë po zbrazja çantën e pik-nikut ku, sigurisht gjeta një faqore me *bitter*. Pak më

vonë ata pikasën pajisjet tona të patinazhit dhe qeshën me pamjen që kishim marrë ne. Mos u ngjanë gjë si kominoshe? Po fëmijëve, a u vinte për të qeshur që të visheshin në mënyrë aq teveqele?

Mua dhe Bufit, sa herë që vishesha në mënyrë të çuditshme, na kapte gazi. Është diçka gjenetike. Ai nuk e fuste kurrë trikon brenda, çka unë e bëja shpesh. Kur isha adoleshente dhe doja të lija përshtypje në ndonjë nga mbrëmjet e shkollës, rrëmoja mes gjithë rrobave të mia dhe të tija, madje edhe të mamasë, por gjithnjë përfundoja me ndonjë nga veshjet e babait, përveç se e lija shtëpinë në rrëmujë të madhe. Në atë kohë Bufi s'ishte adoleshent dhe i vinte shumë për të qeshur. Nuk mund të jetë zbatimës eliminimi në moshë të rritur i atyre lëvizjeve, të cilat i bën qysh nga fëmijëria. Sepse lëvizjet dalin kot dhe të duhet të zvarritesh si i marrë nëpër kanal, përveçse mund të të ndodhë që ta shohësh shpesh veten me mendjen e mëvonshme e të kuptosh se sa qesharake është kur e merr ca si tepër seriozisht duke u vënë në pozitën e tij kur e ke fundin të llangosur me baltë.

Në lidhjet romantike, në përgjithësi ekzistojnë kufi se deri në ç'pikë mund të bëhesh budalla. Unë, ndoshta, kam nevojë të krijoj më tepër besim, të flak disa çizme lëkure dhe të filloj një ditë të re. Apo çfarë? Ndoshta, në një lidhje romantike duhet të kesh goxha liri veprimi që të jesh i aftë të kalosh nga budallallëqet e fëmijërisë në seriozitetin e të rriturit dhe pastaj edhe të qeshësh me këtë. Mos të ta hajë qeni shkopin, por të jesh edhe idiot në një farë mase.

Nxorën paketat, ku në njërin shkruhej “*Dyqani i trikove*” e ku gjendeshin një palë doreza pa gishta të

holla për Zogun. Në tjetrën shkruhej “*Qendra tregtare ushqimore*” dhe kishte disa kilota vrapimi për Bufin. Kur isha adoleshente, ëndërroja të kisha një palë të tilla, por nuk s’isha e bindur se do më rrinin mirë, pasi i kisha ca si tepër të mëdha prapanicat. Këto kishin një bordurë *Ruskin* dhe më rrinin shkëlqyeshëm. Bëra tualet dhe gatova gjyveçin e ditëlindjes. Që të dy thanë se kilotat më rrinin mirë dhe s’kisha si të mos pranoja se më bënin të lumtur. Me veshjet e gjuetisë, që të dy m’u dukën tepër hamshorë.

**Hveragerði,
Mesi i dimri, fillimi i Þorri-t
Dita e burrrave të shtëpisë**

Është shumë më mirë të punosh në shtëpi dhe të shkruash përpara se të vishesh, përpara se të fillosh të diskutosh me njërin apo me tjetrin për tema të ndryshme. Jam e gëzuar që dola nga Rejkjaviku, pasi kur shkua në shqopishtë m'u bë sikur e lashë stresin pas. Këtu ka shumë më tepër qetësi dhe paqe.

M'u desh goxha kohë që të nxirrja gjërat nga depoja. Qysh kur kishim ndërruar shtëpi isha tepër e zënë me gjëra të tjera, kështu që nuk shkrova gjë në ditar. Gjithashtu, mendoja se kur kanë rënë në dashuri, njerëzit shkruajnë më pak nëpër ditarë dhe ëndërrimore. Por tani, qetësia e mirë e ditëve të shkurtra e të errëta të dikurshme të dimrit, më ka hyrë në kocka.

Sot gatova për burrin tim. Për burrin e shtëpisë. I çova kekun dhe kafënë në shtrat.

Tani jam ulur në sallonin e ndenjes, i cili është i lyster, i dekoruar dhe i mbushur me libra dhe instrumente muzikorë. Po përpiqem të ushtrohem e të zotëroj një *koncertina* që ma dhuruan për ditëlindje; është me shkallë pentatonike dhe më duket sikur mënyra e vetme për ta mësuar është të mbyll sytë dhe të nxjerr melodi në ajër. Shpresoj që kjo të mos e dëmtojë bashkëjetesën tonë.

Kemi bërë një marrëveshje që t'ia themi haptazi njëritjetrit nëse ndonjëri bën shumë zhurmë.

Herë pas here bëj kek me mollë; kur je në fshat, është me vend të përdorësh sa më shpesh që mundesh stufën. S'kisha bërë kurrë aq shumë kek me mollë brenda një kohe aq të shkurtër. Receta, sigurisht ishte e gjyshes. Përndryshe, këto ditë po përpiqem të shmang sheqerin dhe majanë, pasi daullja e veshit të majtë më vibronte me shushurimën më të vogël dhe dikush tha se kjo duhej të shkaktohej nga ndonjë çekuilibrim i florës sime bakteriale. Dolëm pak herë te një shesh i vogël në qoshe dhe porositëm birra dhe kulaç me fara susami sipër, por tani, ndoshta duhet të gjejmë ndonjë zbatimje tjetër për të shtyrë kohën dhe të sajojmë ndonjë gjë për t'u marrë fundjavave.

Një fqinj ndaloi për një kafe te ne dhe na paralajmëroi në lidhje me pishinën e vogël duke rrëfyer fije e për pé si ishte infektuar me myk e se si i ishte dashur kohë që ta hiqte nga gishtat e këmbëve këtë të fundit. Mund të ketë treguar edhe gjëra të tjera interesante nga jeta e vet, ashtu edhe nga shumimi i baktereve. Ftoi edhe burrin tim që të dilte ndonjë natë me të në ndonjë prej “shpellave të burrave”; kishte shumë pak në fshat dhe në fshatin fqinj. I tha se atje zotëronte një atmosferë e veçantë; tavolina bilardoje, kalendarë muri me pamje femrash, automate me monedha ku mund të merrje birrë, karrige të rehatshme dhe stereo të mirë. Mund të flasësh për gjithçka e për asgjë dhe të ndihesh i lirë e i lehtë; bëhu adoleshent, i lirë dhe i lehtë.

Zogu nuk e pranoi ftesën për të vizituar garazhin ku mblidheshin burrat e fshatit; sipas meje do e ketë harruar

ose nuk donte të bëhej sërish adoleshent. Pas asaj vizite u bë shumë i mendueshëm dhe iu kujtua një grua te të tetëdhjetat që e kishte takuar në sanatorium. Plaka kishte pasur ca thonj fantastikë të lyer me të kuq të ndezur, çizme me taka të larta e me lidhëse dhe sillej lart e poshtë nëpër korridoret e spitalit ku flirtonte me dok-o-torrët. Doli pastaj se në kohën e vet paskësh qenë prostitutë apo të paktën kishte mbajtur me gajret ushtarët gjatë pushtimit. Ishte treguar shumë e mençur që shtëpinë e kishte ruajtur të pandotur; nuk i kishte ftuar kurrë në sallonin e saj të hijshëm e me jastëkë me qëndisma elegante dhe atë punë kishte vënë në dispozicion garazhin- sipas mendimit të disa personave- si një realitet alternativ e tepër i turpshëm.

Hveragerði Dita e kontradiktave, Nën hënën e zbehtë

Aristoteli ka thënë se dikush që ka ndërmend të vrojtojë dijen dhe të shkruajë nuk mund të bëjë jetë familjare; ai duhet të rrojë larg qytetit. Imazhi i heremitit është një plak i gjymtë, i cili bredh me një shkop dhe një fener nëpër shkretëtirë. Atëherë shko e mendo në vetmi deri sa të gjesh përgjigjet për gjëegjëzat e jetës.

Aristoteli luhatej nga kontradiktat, por gjithnjë përpiquej t'i zgjidhte. Ishte i prirur nga zgjidhja. Prapëseprapë, unë mendoj se shtëpitë e filozofëve- ndoshta edhe të të tjerëve- duhet të jenë gjithmonë kontradiktore.

Aristoteli pohonte se mendimet kishin shtëpinë e tyre në qetësi të plotë, larg prej zhurmave të qytetit, por në të njëjtën kohë thoshte edhe se njeriu nuk mund të zhvillohet e të kthehet në një qenie morale duke qenë i përjashtuar nga dialogu me të tjerët. Kjo ndoshta është edhe arsyeja e lindjes së manastireve, kur ata që ia mbathnin nga zhurma për në shkretëtirë zbulonin se ndiheshin mirë kur ishin me të tjerë, por vetëm me ata që donin dijen dhe respektonin dëshirën e tyre për qetësi. Manastiri ofronte një drejtpeshim ndërmjet të qenit vetëm dhe mundësisë për t'u përfshirë në biseda me të tjerët duke pirë një gotë verë të bërë nga rrushi i kopshtit. Të qarat dhe ulërimat e

fëmijëve atje nuk kishin vend.

Ata që nuk e kishin me qejf shkretëtirën, por që donin t'ia mbathnin nga gjullurdia e kalamajve, herë pas here i linin familjet dhe përmes dyersh sekrete bëheshin kalorës urdhrash të vëllazërive të ndryshme, duke u mburrur dhe duke kapardisur kraharorin, të zbukuruar me Urdhrin e Skifterit dhe urdhra të tjerë me emra zogjsh grabitqarë.

Unë mendoj se shtëpia nuk duhet të jetë një vend ku të ndiesh nevojën të jetosh atëhere kur ti kërkon të eksperimentosh diçka në përputhje me qenien tënde të brendshme më të thellë. Shtëpia duhet të jetë një vend eksperimentimi dhe zbulimi, një vend i paqes dhe qetësisë ku më e natyrshmja e çdo individi duhet të zhvillohet përmes ndreqjes së dëshirave dhe kërkit të të tjerëve. Një vend prehjeje, gjithashtu. Por, po, me siguri që ka diçka në lidhje me shtëpinë si familje, e cila thuhet nuk funksionon. Dhe koncepti im për një jetë të caktuar familjare është i paqartë.

Unë dua realisht të gjej njëlloj zgjidhjeje femërore brenda shtjellës së kulturës sonë të qendëruar te mashkulli. Në histori nuk ka shumë gra, të cilave mund t'iu referohesh si model. Megjithatë, disa ekzistojnë. Si ju duket Persefoni, perëndesha e ishujve të Greqisë së lashtë? Tingulli i emrit tuaj a ju shpie në qetësinë dëfryese dhe në zbulimin e asaj se çfarë duam në ditët tona? A mund t'u besoj veshëve të mi; a është ky një tingëllim udhërrëfyes, një leitmotiv nga ishujt?

Mua më duket se në fund të fundi, Zogu është një burrë për shtëpi, ndonëse vetëkuptohet se ai rebelohet kundër jetës familjare, si shumica e të rinjve. A është tetëkëndësh ky? më pyet; ky format i ri familjar, a

s'është tetëkëndësh? Nuk e di, i them, mund të jetë nëntëkëndësh...Numri i çuditshëm po na shkakton probleme; ne duam që forma të jetë provokuese, por edhe mbrojtëse njëkohësisht. Ndoshta, është formati i familjes ai që ka nevojë të bëhet copa në intervale të rregullt, për të mundësuar ripërtëritjen e tij, si bari që rritet nga dheu i ripërtërirë.

Hveragerði
Ditë dimërore lutjesh,
Hëna në horizont

Këtu arrij të punoj shumë. Më duket se është gjëja më e mirë që mund të bëhet vonë natën. U zgjova nga trokitjet e tim vëllai, që erdhi nga qyteti ku kishte qenë për punë. Zbrita poshtë me rrobë dhome për të hapur derën, mandej u ngjita në kuzhinë për të bërë kafënë petulla me fara hikkre dhe për të zier kafënë.

Në kuzhinë kemi një divan, divanin e vjetër prej lëkure, të cilin e ka ideuar dhe realizuar gjyshi me duart e tij. Është fantastik për tu shtrirë pas kafesë e të diskutosh mbi premiset për ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe çështje të tjera thelbësore, Natyrisht, përpara se ai të largohet pasi nuk ka kohë për të humbur. Por shpesh ai e shfrytëzon mundësinë për shkuar në banjë e për të t’u liruar, çka përbën edhe votëbesimin më të madh për një shtëpi- nëse dikush ndien se ka mjaftueshëm intimitet me dikë sa ta kryejë këtë nevojë në një nga ambientet e shtëpisë së këtij të fundit, atëherë ai ambient është vërtet një “vend i veçuar” një “banjë”, një vend për t’u çlodhur.

Edhe partneri im gëzon nga kësi çastesh. Zakonisht, përfundon me punën e tij e pastaj është gati për t’u çlodhur. Besimi mes atyre të dyve rritet gjithnjë e më tepër. Bëjnë shaka me njëri-tjetrin, çka praktikisht ndodhte qysh në

fillim, por sa më shumë kalon koha aq më shumë po përshtaten me njëri-tjetrin duke lëvduar ndërsjelltazi veshjet dhe duke bërë komente mbi stofrat dhe endjen. Njëri thotë se leshi skocez është më i miri, tjetri ia bën se më të mirët janë italianët dhe mandej kujtojnë me mall leshrat e punuar në punishten e gjyshit.

Një ditë Zogu na tregoi mua dhe tim vëllai një ëndërr të veçantë që kishte parë; epo, fillimisht ma tha mua, por unë e shtyva që t'ia tregonte edhe Bufit. Që të dy u vunë shumë në siklet dhe qeshën me zë të lartë, por pa thënë asgjë. Punë dreqi.

Ja si ishte ëndrra: ornitologu rراسi gishtin e madh thellë në prapanicën e administratorit të trashëgimisë kulturore. Po, sikur kjo të ishte krejt normale, tha ai duke qeshur. E pastaj? S'më kujtohet ia bëri Zogu si me zor.

Bëra edhe ca kafe tjetër, ua shtiva nëpër filxhanë e mandej mbusha një termos për vëllain. Ai e mban gjithmonë një vete, beson te termusat, por unë gjithmonë harroj t'ia mbush. Por vetë bota më bën të lumtur siç më bën edhe një simite me stafidhe në ditët me dy përmasa.

Kishim edhe një tjetër vizitor, i cili ndalonte herë pas here te ne pas shëtitjes ditore dhe bisedonte me të dashurin tim për zogjtë. Çdo ditë shihnin zogj të rrallë dhe shumë të bukur dhe një herë m'i përshkruan me shumë entuziazëm: si hapnin veshët e fshehur drejt tokës për të dëgjuar krimbat.

Epo duket se unë s'dilkam në kohën e duhur për shëtitje ose nuk jam e qetë sa duhet dhe jam bërë sikur të kisha një zile në qafë; nuk kam parë kurrë zogj të rrallë, të paktën jo aq sa më kanë zënë sytë trumcakë. Mandej, unë eci nëpër rrugët e vjetra të shkrimtarëve, Bláskógar

e Frumskógar dhe shpeshherë më qëllon të shikoj ndonjë cinxami me pupla gri, që gjatë pushimeve niset për kokoshka dhe jamball. Pëllumbat në shesh, ndoshta nga parku i vjetër i dëfrimit, të lerosur dhe të zhubrosur, të gjorët, ushqehen nga dyqani i zemërmirësisë së mbretëreshës.

Është e çuditshme kur viziton shtëpitë e shkrimtarëve që kthehen në shtëpi pensioni. Kërkuam për fondacionin e shtëpisë që kishin vendosur të blinin poeti Hanes dhe e shoqja Suna. Ata nuk kishin shkuar më larg se aq. Gjithë jetën e tyre jetuan nëpër shtëpi të përkohshme dhe nuk kishin pasur fëmijë, por kishin birësuar një zog me një flatër të thyer, i cili krekosej nëpër shtëpi dhe bënte glasa në gjithë sallonin. Kjo ishte edhe një votë mirëbesimi. Mandej poeti e mësoi zogun që ta bënte te shkallarja matanë librave, në mënyrë që të ishte më e lehtë për ta larë me ujë.

**Hveragerði, Festa e Shën Brigidës
(Brigida ka qenë kryemurgeshë dhe është
shenjtorja, që mbron poetët, lundëtarët,
baxhoxhinjtë, të arratisurit, shtypin e shkruar,
bukurshkrimin dhe ujin)**

Gjeta tri shtigje të ndryshme dhe u sigurova mirë që nuk kalonin nëpër rrugë private, kur mund të më shqyente si pa të keq ndonjë qen. Qëllon që sillem mes serrave të shembura nga tërmeti dhe vështroj grumbullimin gati metodik të copave të xhamit mbi pluhur. Shtegu më shpie në Laugaskarð. Ngjyrat të mrekullojnë sytë: pishinë bojë gurkali me topa ngjyrë shegë e të verdhë, me halorë të gjelbër të errët.

Ndonjëherë takohemi te pishina ku ka vetëm dy vetë, që lahen në dëborë apo në shi dhe një përzierje të aromave të freskëta me kutërbimin e sqfurit të banjove prej avulli. Ai thotë se nga mbrapa ngjaj si fokë e vogël. S'kam ç'bëj, por ndihem e fyer, ndonëse e kuptoj se nuk e ka me të keq. Për mua, fokat janë të privuara nga joshja femërore dhe m'u duk vetja si ajo nxënësja e tij, të cilës ai i kishte sugjeruar që të zgjaste flokët e të hiqte ca dhjamë. M'u kujtua edhe foka Snorri dhe pikërisht këtu vazhdova të notoja e kënaqur nga krahasimi. Ti je si një rosak deti, i thashë dhe ai më përmendi për herë të parë emrin e vet të shtypur në letër në revistën Zogjtë, ku kishte dërguar një

shkrim mbi një specie të humbur zogjsh shtegtarë, që i kishte parë në periferi të qytetit. Në të vërtetë, më shumë se gjithçka tjetër, ai më kujton skifterin e bardhë që e kisha parë të vizatuar në Papal Palace në Avinjon. Oh, ndoshta s'është ndonjë kushedi ç'fat që ai është skifter e unë thëllëzë, siç më kishte thënë dikur e çka më kishte pëlqyer pa masë. Kështu ai është një thëllëzë mashkull e i pashëm, si me veshjet e dimrit, ashtu edhe me ato të verës. Përveç se, më së shumti, rrinë tufa-tufa si rosat, një i murrmë i vogël, më tha, është zhytës shumë i zoti.

Na pëlqen shoqëria e njëri-tjetrit dhe rrallëherë ndihem sikur nuk po zbavitem sa duhet; është një ndjesi sikur nuk ngopemi së qeni vetëm, ama në kuptimin vetëm të dy. Kurrë nuk kemi folur kaq shumë për jetën tonë- për gjithçka dhe për asgjë- por gjithashtu kalojmë edhe momente të gjata, tepër të gjata në heshtje, edhe duke qeshur, edhe duke kërcyer në kuzhinë. Ndonjëherë debatojmë për formalitete dhe bëjmë një potere vërtet të madhe. Në këtë qytet, ta mbyllësh ditën duke u grindur është keq; kjo ka ndodhur vetëm një herë dhe unë randa jashtë, por nuk gjeta asgjë të hapur, kështu që bëra ca xhiro në ajrin e ngrohtë të pranverës, përpara se të shkoja në shtëpi. Isha e merakosur se ai mund të kishte ikur dhe do të kisha frikë nga terri, por kur u ktheva, e gjeta në kuzhinë duke pritur qetësisht me qumështin në gotën e pathyer. Isha e gëzuar që kisha ardhur në shtëpi dhe u kthyem te foleja jonë me push, ku fërkuam sqepat njëri me tjetrin.

Rejkjavik Diell mesdimri

Po bëjmë një ekskursion në Rejkjavik. Pasi mbarova me orët e mësimëve që jepja diku, vizituam disa librari. Ia kaluam bukur; do të qëndrojmë te nëna e tij. Mendoja se do të shkonim më rrallë; është befasuese se sa shpesh jemi të detyruar të marrim nga përndimi drejt shqopishtes. Mundet që nuk jemi ende të vetëmjaftueshëm, por ndoshta është mirë që bëjmë shumë ekskursione.

Unë ndihem vërtet shumë mirë jashtë qendrës së qytetit dhe që më duhet të shkoj atje vetëm kur kam nevojë për ndonjë gjë të veçantë. Ne jemi përzgjedhës për sa u takon veprimtarive ku marrim pjesë. Nisemi me makinë tamam si ato çiftet të moshuarve me kapele gëzofi dhe frak për të ndjekur koncertet e orkestrës simfonike në qytet, ku biletat i kemi rezervuar qysh shumë më përpara. Brams dhe Brukner, shumë duartrokitje.

Me miqtë ia kalojmë hareshëm sepse në fshat, me ta ke mundësi të thellohesh më tepër me se sa në qytet. Të paktën ia kalojmë shumë bukur në kuzhinë. Kur ulemi dhe bisedojmë në lidhje me forcimin e kulturës dhe të shëndetit mendor, unë ndihem mirë; nuk është kurrë kohë e çuar dëm.

Ketri është tepër i thellë dhe mund të kthehet në ujë

dhe në zog pikalosh apo në të gjitha llojet e kafshëve. Përkëdhel macet, ka ndjeshmëri femërore dhe kur ecën bëhet njësh me tokën; mençuria i rrjedh në hulli të panumërueshme nëpër torfë, duke i lejuar mendjes së tij që të piqet në ciklet e përjetshme të natyrës. Po kështu i ndodh edhe me ndjenjat. Gjithashtu, është kënaqësi e madhe ta shohësh tek hidhet dhe tek lëviz me duar kutitë e librave për të na dhënë një dorë. Le pastaj ta dëgjosh kur rrëfen për pasionin e tij të adoleshencës, motoçikletat për rrugë të vështira.

Sot çova për të larë makinën në një lavazh automatik. M'u bë sikur po asfiksohesha dhe m'u desh të bëja frymëmarrje tibetiane për t'u qetësuar. Ama, ishte edhe njëfarë shërimi.

Të kesh në zotërim një makinë është një ndryshim shumë më rrënjësor se sa mund të më kishte shkuar në mendje. Gjyshet e mia thonin se pavarësinë më të madhe e kishin arritur kur kishin marrë lejen e drejtimit dhe kur kishin blerë makinat e para. Dhe çasti kur u ishte dukur më shumë sikur u kishin prerë krahët, kishte qenë atëherë kur nuk mund të ngisnin më makinën; thua të kishin vuajtur më tepër nga kjo se sa kur u kishin vdekur burrat?

Tani kam dëshirë për gjëra më tokësore: një makinë për të larë enët Jo të shtrenjtë. Kësisoj, do ta kem më të lehtë kur bëj darka. Shoqëria e konsumit të merr me vete edhe kur ti vendos ta mbash larg.

Hveragerði, Dita e qirinjve, Hënë e re

Është realisht e këndshme të jetosh në një vend, i cili nuk është menduar të ketë shumë hijeshi. Në Eden nuk ka më asnjë majmun dhe, ndonëse aktualisht janë pesë biblioteka dhe ndoshta pesë pishina, njerëzit zakonisht dalin dhe shkojnë ca më tutje Rejkjavikut. Janë kaq të shumtë në numër, sa s'të besohet e megjithatë, ndalojnë te një dyqan për të blerë akullore.

Tani po e kuptoj se sa e bezdisur ndihem në qytetet e mëdha. Kam dëshirë t'i ofroj me ç'do kusht një banesë kujt do që ka nevojë, ta bëj të ndihet si në shtëpinë e vet dhe të gëzoj çdo çast me të. Vetëm se njëkohësisht do të humbisja hapësirën time të punës dhe intimitetin.

Një herë po qahesha për këtë, por jo me të vërtetë, pasi unë nuk mund të qahem dot; praktikisht kam dashur vetë që gjërat të shkonin kështu. Një herë, kur pyeta mamanë nëse mund të gjeja një pension të lirë diku pranë saj ose të dërgoja ca njerëz te ajo, më tha: jo, s'besoj se mundem. Në fakt e di se kishte të drejtë. Ajo ka përvojë; shtëpia e tyre ka qenë si kafene për vite të tërë.

Askush nuk më ka kërkuar nëse mund të jetojë me mua këtu në Hveragerði dhe s'mund të qahem për asnjë bezdi të vërtetë. Puna është se nuk mund të kem ritmin tim. Vendosa të provoja që ta ktheja ditën në natë. Në përgjithësi

m'u duk më mirë të shkruaja natën apo në orarin e zjarrit indian, midis orës dhjetë dhe dy. Terapisti im alternativ tha se nëse vazhdoja kështu, do të digjia rezervat trupore sepse gjatë orëve të zjarrit njeriu duhet të pushojë.

Kur punoj gjatë ditës, kurdoherë përpiqem ta le jashtë botën; përpiqem të mos mendoj për bankat, për taksat, për frigoriferin ku mund të mos ketë asgjë për darkë e me keq akoma që mund të prishet e që duhet konsumuar menjëherë. Ama, kur dyqanet dhe bankat janë të mbyllura, kur edhe vetë drejtori i taksave është duke fjetur, mbi gjithçka bie një qetësi e mëndafshtë. Të vetmit tinguj që dëgjoj janë zukatja nga frigoriferët e vjetër dhe gërhimat nga goja e engjëllit tim mashkull.

Po, puna po ecën goxha mirë dhe në përgjithësi, përqendrimin e plotë dhe thellësinë më të madhe e arrij ndërmjet orës dhjetë dhe dy. Më pas, bie në një si pluskim të ngadaltë lart dhe vozis deri në mëngjes duke lexuar ndonjë libër deri në orën pesë. I vetmi problem është se ndonëse nuk i detyrohem askujt asgjë, kur zgjohem dhe bëj punë, vazhdoj të ndihem si një varfanjake që ngrihem në një orë të tillë të mallkuar.

Nëse kur zgjohem, ornitologët dhe ata që bëjnë ekskursione me këmbë rrinë ulur në kuzhinë duke gjerbur çaj, duke krakëllitur, duke qeshur, duke qeruar arra dhe duke shtrydhur trurin për të sajuar ndonjë gjë interesante pasi e kanë mbaruar ditën e punës, unë ndihem si e kllaposur në një habi të pezmatuar, në një piring heptagonal për shkak të orareve të mia. Të gjithë më ngajnë si zogjtë shtegtarë që janë mbledhur për t'u larguar. Bën përjashtim njëri, i cili ende vazhdon të mbetet axhami. Thuajse të gjithë njerëzit që janë në depresion, të dhënë pas pijes, apo

me mangësi në krijimin e marrëdhënieve shoqërore, prirjen të jenë aktivë gjatë natës. Sigurisht, edhe Bufi, me të cilin ndihem mirë.

Kam filluar të shkruaj me dorë në fletë të mëdha dorëshkrimesh si ato të Torahut, në mënyrë që të më duket sikur puna që kryej e mbush dhomën.

Përndryshe, kurrë nuk do të marrim as mundimin të vlerësojmë se kush është më produktiv; në fakt është tepër e qartë se në këtë kontekst do të fitonte ketri. Po përpiqem të mësoj metodën e tij të punës. Për shembull, duket se kur ka dëshirë që të bëjë një pushim nga të shkruarit, i kthehet përpkthimit. Kjo është një mënyrë e mençur për të kaluar kohën me të dhe këtë dimër kemi bërë shumë gjëra- vjen ai te ne ose shkojmë ne tek ai, zakonisht flasim për letërsi dhe art, ndonëse pardje pamë së bashku një ndeshje hendbolli dhe, kur po na pushtonte dëshpërimi i dimrit, kaluam nga mbrojtja në sulm dhe ndoqëm një komedi të vjetër, e cila na bëri të qeshnim me lot për dy orë me radhë.

I përshkruanim njëri-tjetrit librat që kishim lexuar apo që kishim blerë kohët e fundit; të gjithë kemi zakonet të blejmë gjithnjë e më tepër libra si për të shtuar përgun e mbeturinave dhe është gjë e bukur t'i ndajmë bashkë pretë. Ndonjëherë grindemi; nuk jemi gjithmonë në një mendje në lidhje me nivelin e lartë të ndonjë autori, vrasim mendjen përse disa prej tyre si njerëz janë të këqij, përbuzës dhe të lodhshëm, por si shkrimtarë janë me vlera.

Këtë pasdite do të shkojmë të vizitojmë tregun e fermerëve në Selfoss dhe ndoshta ndalojmë tek kafeneja *Books and Coffee*. Do të hamë ushqim indian në një rulotë të vogël të parkuar tek ura sipër lumit Olfus.

Hveragerði
Fillimi i sezonit dimëror të peshkimit,
Dimri fillon,
Në zemrat tona më shumë shpresë se pesimizëm

Këtu, në avullin e pranverës së ngrohtë, ditët e mia shpesh janë të mbushura me një absurditet të këndshëm, por që s'arrij dot ta hedh në fjalë. Ndonjëherë vështroj jashtë nga dritarja jetën njerëzore në këtë fshat të vogël. Ecjen e grave, të cilat rregullisht vinë e ikin nëpër dëborë dhe futen gjithë siklet nëpër dyqane. Ja, tamam kështu ndihem unë në këto ditë të shkurtra dimri. Herën e fundit e pashë atë grua, thërrita Zogun dhe i kërkova të vinte dhe të kontrollonte. Ai u duk gati i zemëruar, sikur të kisha ulur vlerat e asaj gruas apo të miat. Krejt e kundërta. Shkova të bisedoja me të, por puna ishte se të dyqani zbrisja rrallë, le që as nuk dija si të shkoja e të mos e bezdisja. Ajo, ndjek një rutinë, e cila duket se nuk mund të priset: si e bën të njëjtën rrugë në kthim me çantën të mbushur me kokoshka? Vras mendjen nëse i blen për vete, apo për gjithë të tjerët kur kthehet në shtëpinë e saj të veçimit?

Kur bëj ecjen e përditshme përpiqem të sillem në mënyrë më dinjitoze, ta mbaj shpinën drejt, ta ngre kokën lart.

A marrim ca kokoshka? i sugjerova. Jo, nuk donte,

por më pyeti përse nuk i ha me qenë se më pëlqejnë; kokoshkat zor se quhen gjellë. Ai e kishte fjalën për biseda të ndryshme.

Për këtë u ankova pardje a mbase edhe s'u ankova, por të paktën i tregova se ndonjëherë ai e braktis vatrën e bashkuar familjare. Sapo ia thashë, e kuptova se ishte më e mira dhe se duhet të mësoja të përshtatesha me mënyrat e tij në vend që ta ndryshoja. Ndonjëherë ai blen për vete një sandviç për darkë, pastaj ulet dhe e mbllaçit, çka mua më lë pa gojë. Po planet që kishim patur për darkë bashkë? Oh, pse kishim ndonjë plan? më pyet i befasuar.

Si kompensim, ankohet se si unë ndërlikoj gjithçka, nuk mendoj për darkën vetëm për vete apo për të dy, se gjithmonë dal me ndonjë ide për të ftuar këtë apo atë, mbase edhe dymbëdhjetë njerëz në minutën e fundit dhe si përfundim stresohem ngaqë mund të mos ketë ushqim mjaftueshëm për të gjithë.

U mendova përsëri për të gjitha dhe pashë se në ato që më tha kishte goxha të vërteta. Të paktën, unë kurrë nuk mendoj për darkë vetëm për vete veç në mos jam e zemëruar me të. As kjo. Mandej, drekën dhe darkën i përdor për të sheshuar gjërat dhe gjithnjë e pyes nëse ka uri. Ai ka po ashtu të drejtë: kur vendosim të ftojmë dikë për darkë, unë shpesh përftoj nga rasti që të ftoj edhe të tjerë, mbase tërë familjen. Më duket se kështu bëhet më interesante. Por mandej, pasi më shtohen aktivitetet me planet e mia të mëdha, kur uji është duke zier dhe vaji është përcëlluar, prirem që të futem në syrin e ciklonit, pasi vetëm kur jam atje mund të më vinë ide në kokë. Ndërkohë gjithçka digjet...

Ti flet gjithmonë për paqe dhe qetësi, por sapo i gjen,

bën lëmsh gjithçka, më tha. Për dreq, ai është tepër i zgjuar dhe futet shumë më tepër në brendësi të gjërave nga sa unë guxoj edhe të shpresoj. Ne përpiqemi t'u flasim mendjeve tona, ndonëse kjo është e vështirë. Më së shumti këtë e bëj unë, si një mi i zellshëm. Duhet të jem e kujdesshme që të mos ia gërric sytë. Ndonjëherë jam kaq e shpejtë në hartimin e grafikut të situatës dhe identifikimit të problemit, sa atij i mbyllen sytë dhe më thotë se i vërtitet koka. Më pas ai përpiqet të ngadalësojë ritmin dhe më thotë se unë grumbulloj shumë gjëra bashkë. Jam bindur plotësisht se ky është një ndër ata probleme, që duhen diskutuar ndonjëherë: një problem nuk është kurrë diçka e izoluar- ai shkon dorë për dorë me të tjerët. Mbase lidhet me shtresa apo shtresëzime dhe, që të dalësh në krye të problemit tënd duhet të kalosh nëpërmjet tyre.

Hveragerði

Dita e Shën Valentinit, hënë e plotë

Thjesht po mendoja se si nuk kombinohe mi dot më kurrë në shtrat; kur ai fle unë punoj dhe kuptohet që ngrihet përpara meje. Ndonjëherë, kur bie në shtrat, ndonëse përpiqem të jem e kujdesshme, e zgjoj pa dashje duke e kapur në befasi, por ai më thotë se unë lëviz si mace. Kur sapo kam rënë në shtrat e më vjen ndonjë gjë në mendje që më duhet ta hedh në letër, atij i del përnjëherë gjumi. Kjo po e dërmon dhe po ia nxin jetën, por përpiqet të mos ta japë veten, thjesht zgjohet e brof pa fjalë si ujk a si dhelçër. Unë mundohem të fle qetësisht dhe në heshtje nën mbulesa, ndonjëherë bëj edhe joga përpara gjumit, por është po njëlloj e vështirë të zvjerdhësh veten nga reagimet instiktive dhe të lëvizësh më ngadalë, veçanërisht kur idetë të vinë shumë shpejt dhe rendin si valë që vinë nga thellësitë.

Nga një këndvështrim seksual, për mua është më mirë të më krahasojnë me macen se sa me fokën. Por kjo është një mospërputhje, e cila lidhet me orët që jemi të dy të zgjuar dhe, e cila mund të kthehet e të bëhet një pengesë për seksin.

E pyeta nëse mund të takoheshin rregullisht në dhomën e gjumit në mesditë. Po, sigurisht mundemi, më tha. U shfaq kur ora ra tre me veshët e ngrehur, vetëm se

unë e kisha humbur ndjesinë e kohës dhe rrija ulur me flokët si fole zogu të mbështjella me një peshqir të shpifur e me gjumë në sy duke u përpjekur të krijoja një fjalëkryq. Vendosëm të luanim shah; ai më mëson lëvizjet e gurëve. Është mësues i duruar dhe ndonjëherë më lejon të fitoj. Por unë ende nuk e kam bërë timen mjeshtërinë e shahut. Dobësia ime është paniku. Dhe kur më zë paniku, nuk përqendrohem dot në lojë; filloj të mendoj për shahun si dukuri, çka është ndoshta njëlloj mekanizmi mbrojtjeje. Sikur sorra të quhet Shkop hokeji, apo sikur ai emër të ishte më i përshtatshëm për atë peshkopin, i cili na e ka çarë kokën, si një karagjoz.

Po ndjek disa masa të dëshpëruara. Kur mund të jetë ide e mirë për të vënë në plan ndonjë “kohë zgjimi” për të marrë me qira filma pornografikë- jo të rëndë- poshtë te dyqani dhe të blej llastikë çorapësh te dyqani i veshjeve dhe pëlhurave? Turp që nuk mund të bëj dot kurrë numra erotikë lakuriq për të; jam e sigurt se do të më kapte gazi. A mos është bërë marrëdhënia jonë si ajo mes një motre e një vëllai? Mos të qeshurat dhe ngrohtësia e afërsisë kanë marrë shumë hapësirë dhe nuk i lënë vend dëshirës seksuale.

Mundet që të na hapet një derë për karnavalet, kur epshi bëhet qesharak dhe e qeshura epsh. A do të jetë komik eksperimenti tjetër yni? Apo mos është si te pornot: një qëllim final, një parodi e parashikueshme e dëshirave për ata që nuk u është dashur të përballen me poshtërimin e epshit për pushtetin apo të mungesës së pushtetit? Pornografia lidhet me turpin, por asnjëherë me përunjësinë; ajo mbërthen dëshirat, nuk i le të shndërrohen. Përbushja e përsëritur pengon zhvillimin.

Ka ende njerëz që duken sikur e ushqejnë veten me shumë kërshtëri, qoftë edhe estetikisht, apo me pornografi, por unë kurrë nuk kam takuar ndokënd, i cili të jetë zhvilluar emocionalisht prej saj.

Më kujtohet se sa tmerrësisht e zhgënjyer mbeta nga pornot si një zbulim i madh i sjelljeve seksuale të perëndimit. Atëherë, ky na qenka i tërë trasgresioni? A do të bëhet ndonjëherë më origjinal se kaq? Jo, nuk e kam fjalën më i shëmtuar, më i ekzagjeruar, por më saktë, më introspektiv, më provokues psikologjikisht, pa u bërë i dhunshëm? A nuk është më frymëzuese të vesh në provë kufijtë e bashkëjetesës pa rënë në qarqet e shkurtra të dhunës?

Në pornografi askush nuk dëgjon, as veten, as të tjerët. U përpoqa, për shembull, t'i shpjegoja një qeni të vjetër se do të ishte këndshëm që të kafshonte në pjesën e pasme të qafës, njëlloj si një bushtër kafshon këlyshët e vet- dashuri me shumë dëngla. Pastaj, ai shkoi dhe mori një fustan të zi, që tha se ishte i bërë me të njëjtin material me hundën e qenit dhe më kërkoi që ta vishja. Mu duk zbavitëse ideja që të kthehesha në një hundë gome. Por fantazitë tona ishin krejt të çuditshme. Ai shkoi e mori një litar, duke shpresuar të lidhte këlyshin dhe ta rrihte.

Sa naive tregohem ndonjëherë; një gjigand i tillë gjysmë i zgjuar. Jo more! Nuk më bëhet të tregoj pjesën tjetër. Për fat, m'u kujtua se qentë kanë kthetrat dhe dola nga kjo estradë e vrazhdë.

E lashë atje te skena, me objektet skenike të fantazisë së tij. Vetmi prekëse. Ai ishte shumë i lumtur që më në fund kishte gjetur të barabartin në perversitet. Çelësi, i cili hapi botën e dëshirave ishte hunda e lagur e një

qeni. Me gjasa, kjo mund të ishte e padobishme për të shpjeguar se si edhe në rast se botët tona janë paralele, ato nuk kanë asgjë të përbashkët përveç hundës. Ai duhet të ketë dëgjuar.

Unë prirem të besoj se gratë rriten nga të tjera lloje zbulimesh. Fantazitë e burrave janë të kufizuara nga sistemi; në botën e tyre, karnavali shihet përmes syve të mbretit- kur njerëzit kanë mundësinë që të bëhen mbretër për një ditë; ku gjithkush ndryshon rolet, por mandej e gjitha kthehet sërish në normalitet. Pasi kanë qenë në teatër, njerëzit kthehen në shtëpi. Me bishtër ndër shalë. Sekretarja që u bë seks bombë, kthehet e bëhet përsëri sekretare, mjeku i cili ishte bërë repist, kthehet sërish e bëhet mjek. Është ca si shumë e parashikueshme. Dhe ca si shumë pranë për t'u standardizuar me një dhunë të patregueshme.

Është e rëndësishme të shmanget çdo lloj standardizimi në seks. E mira është që ekspeditat kërkimore në xhunglën e dëshirave personale e shtazarake, të përcaktohen individualisht dhe të arrihet të gjendet një grykëderdhje për një dashuri të zhvilluar në shkallë të lartë. Nëse thjesht ndjek dëshirat e tua, menjëherë do të përfundosh në standarde frojdiane, të cilat i ka përvetësuar kapitalizmi dhe, të cilin letërsia e përdor për t'u shitur. Por nëse ndjek dëshirat e tua në përmasat e panjohura të dashurisë, diçka fërgëlluese dhe e bukur do të ndodhë pashmangshmërisht.

Epo boll me teorira. Jam shtrirë në shtrat dhe pingu i librave mbi dysHEME pranë meje është bërë kopicë sa mund të dal nga dritarja pa prekur përtokë.

Hveragerði
Dita e shtëpiakeve,
Fillimi i Góa-s apo mos është gjë Skerpla?

Shtëpia është rrëmujë. Fletë dorëshkrimesh - secila me nga një kapitull të librit tim- si shtroje mbi dyshemenë e dhomës së gjumit, kuzhinës dhe sallonit. Shkoj me këmbë mes kapitujve për të gjetur një element për të lidhur strukturën. Normalisht nuk duhet ta lejoja një pushtim të tillë të hapësirës sime, veç nëse nuk jam vetëm dhe shumë e detyruar. Zogu është tolerant, por nga dita e katërt i është shtuar ankthi. Pa thënë asnjë fjalë, rrëshqita për te qetësia dhe paqja e bibliotekës, duke gjetur një sistem krejt timin e tejet të saktë për ndarjen e kapitujve, të gjithë mbi dysheme e në një kaos të jashtëzakonshëm. Po përpiqem të jem energjike, e shkujdesur. T’i bëj një premtim me mendje atij dhe vetes për të vënë në rregull sërish gjithçka sapo t’ia kem marrë dorën.

Edhe pse afati ka mbaruar, jam mësuar të shtirem sikur kam akoma plot kohë, të ha të gjitha bukët e thekura me patë, madje edhe të lexoj gazeta të vjetra. Për fat ai s’është këtu që të më bezdisë duke më kujtuar afatin e dorëzimit. Nuk mund të mbarosh dot asgjë nëse ke dikë rrotull që të ha shpirtin.

Pardje ai duhej të përfundonte një raport për fondet e kërkimit, për të bindur këshillin e lartë se libri i tij për

zogjtë ishte i nevojshëm për kontributin e faunës letrare të Islandës. Mua më dukej sikur ndërkohë s'mund të punoja dot, sikur kjo do të ndërhynte te hartimi i raportit të tij. Kur flija mendoja dhe kjo ndodhte kryesisht nëse në ëndërr më dilnin zogj. Po bëhesha gati të punoja qetësisht e në paqe dhe e bëra gjithë shtëpinë të këndshme, në mënyrë që puna t'i shkonte mbarë. I çova çaj dhe e putha te qafa, pa folur dhe mandej, nga dreka biseduam për aspekte të ndryshme të raportit; kisha kapur diçka të thjeshtë, pa asnjë trazirë. Por sapo u ula në tavolinën time dhe fillova të punoja me sa më hante dora, ai u ngrit dhe tha se po shkonte në bibliotekë; nuk përqendrohej dot më.

A mund të përqendrohemi dot të dy plotësisht në punë e në të njëjtën kohë? A duhet që njëri nga ne të merret me shtëpinë, për të ruajtur ekuilibrin? Ashtu si kur je fëmijë- nuk mund të përqendrohesh dot me të vërtetë te kompjuteri apo te librat, edhe sikur të bësh ndonjë lojë. Të duket, o sikur po luan, o sikur thjesht je atje. Një prani e mirë, e kudogjendur. Përqendrimi yt nuk duhet të jetë i jashtëzakonshëm.

Kur e mendoj tani, e kuptoj se deri më sot, kur kam jetuar me ndonjë burrë, nuk kam arritur kurrë të përqendrohem plotësisht në punë. Merre me mend kur më duhet të përfundoj ndonjë projekt. Po njëlloj edhe kur jetoj me mamanë. Që të dy ne përqendrohemi fort te puna dhe në të njëjtën kohë të këndojmë e të bëjmë edhe analiza. Unë i kam përjetuar çaste të tillë me miqtë, por për drej shumë rrallë me burrat me të cilët kam jetuar. Dhe tani pyetja e madhe që shtrohet është nëse mund të gjej qetësi për vete dhe për burrin me të cilin kam zgjedhur të jetoj.

Ditët e fundit ai ka qenë tepër i mirë me mua, ka gatuar dhe ka larë enët me nurin e një amvise të vërtetë. Ka folur në telefon- detyrë sociale kjo- ka mbajtur kontaktet me familjen dhe me miqtë, në mënyrë që të mos këputeshin fijet për të tjerë leshin. Zakonisht këtë e bëj unë dhe ai ndihet mirë që shkon kështu. Pajë e pyeta thjesht për të qenë e sigurt, nëse kishte folur me të motrën për festën e ditëlindjes së tij fundjavën e ardhshme. Më kërkoi të mos mendoja për ditëlindjen për deri sa ka ende kohë dhe të mos e vras fare mendjen për dhuratën.

Pranova dhe shkova e kapardisur te jorganët dhe jastëkët, vasha një fustan me katrore dhe bëra ca tualet. Pastaj hodha një mbulesë mbi tavolinë, gatova një çomlek të zhytur në kërpudha që të lije thonjtë e mandej hapa një shishe me liker manaferrash. Mbase e nxjerr bashkë me akullore me bombone që është edhe tepër e preferuar nga klientët në dyqan. Bluarësja bën shumë zhurmë; më dridhet timpani i veshit.

Hveragerði
Ekunoski i pranverës,
Hëna në perigje

Lexuam një njoftim për një shtëpi në Eyrarbakki dhe shkuam me makinë ta shihnim që atë mëngjes. Mos po arratisemi gjë nga vetvetja? e pyeta. Mos do gjejmë gjithnjë ndonjë mangësi në banesat tona për shkak të trazimeve të zemrave? Ai e ngiste karakterin në kulm të shpejtësisë. Duke mbajtur levën e marshit me dorën e hollë me damarët e dalë më kërkoi që të mos i ndërroja aq shpesh këngët: unë kisha detyrën e muzikës dhe gjithë kohës përpiquesha të gjeja këngën e duhur gjatë asaj rruge që po bënim dhe kështu kaloja nga njëra te tjetra; po, sigurisht, një gjë e tillë të lodh. Familja e tij është nga kjo zonë moçalore.

Më në fund gjeta një këngë që i përshtatet mënyrës si e nget ai makinën, duke marrë parasysh panoramën, kohën, orarin, gjendjen tonë shpirtërore: *Rey a quien reyes adoran*. Mbreti të cilin adhuron mbreti- apo të cilin adhurojnë gratë? Një dajre e çmendur argëtohet që nga shekulli i gjashtëmbëdhjetë.

Nxituam drejt përmes maleve të mbuluara me myshk, deri sa dunat me rërë dhe valët e kripura na uruan mirëseardhjen. Ai më tregoi shtëpinë, të cilën e kishte ndërtuar katragjyshi i tij. Dhe shtëpinë me çati Samuel-

hajde krahasoji me kriporet e tavolinës Gröndal. A kanë qenë të lumtur gjyshi me gjyshen këtu? e pyeta. Po, nga sa di unë, më tha, dhe kohët e fundit një grua e mençur më ka dhënë disa dokumente në lidhje me ta, ku përfshihen edhe poezi të recituara gjatë funeralit të gjyshit, të shkruara nga gjyshja vetë. Vargje të përdëllyer, të qashtër dhe të thjeshta. Kur tha këtë unë doja menjëherë të shkonim të dy bashkë në Eyrarbakki, aq më tepër nga që atje gjithnjë më kishte pëlqyer.

Shtëpia që jepej me qira s'donte t'ia dinte për motin, por ishte e pambaruar. Në kopsht pamë një tricikël të përmbysur, lopata plastike dhe buqeta të shpërndara aty-këtu. Një zymti që ç'të them. Mos është gjë ëndrra jonë të përmbysim? Më duket sikur ndiej depresionin e atyre që lenë qytetin për hir të natyrës, por si përfundim mbyllen në guaskën e tyre dhe nuk dalin as për të bërë një shëtitje në det, më tha ai. Mbase ne gjithnjë do të jemi në ecje. Po sikur të shkonim diku papritur?

Pamë katër korba të ngordhur në plazh dhe rrugës në kthim vura në kasetofonin e makinë një këngë të brengosur: Mbreti vdiq, me po të njëjtën bandë muzikore qesharake. Deti, me gjasa do na çojë atje më pas.

Lexojmë me shumë vëmendje website-t e agjencive të pronave të patundshme. Është e lodhshme të përfytyrosh me mendje kaq shumë shtëpi, të rregullosh librat në kaq e kaq mure të ndryshëm, të përpiqesh të gjesh vend për të gjitha orenditë. Të përfytyrosh atmosferën, se si do ta doja kur do të dëgjoj muzikë duke luajtur me gishtat e këmbës.

Ai ra të flinte i lumtur dhe i bukur ndërsa unë u përvodha nga shtrati sapo munda dhe shkova e ndeza

kompjuterin. Dëshirat e thella të zotave. Një film shumë i bukur mbi jetën në një ishull të Japonisë, ku nënat dhe bijat janë pranë dhe motra dhe vëllai kanë bërë fëmijë. Aktorja protagoniste më kujton Puck-un, që lëshon batutat e vjetra me humor. Një e qeshur që vjen nga zorrët e tokës. Në fund të filmit, të gjithë bëjnë plan t'ua shesin ishullin kinezëve, por i vëllai, për të cilin të gjithë mendojnë se është i marrë pasi dashuron të motrën, është i vetmi që nuk pranon.

Skógar
Festa e Kryqit të pranverës
(Dita e bujqve me mëditje),
Hënë vere

Kur i thashë mirupafshim Hveragerði -së dhe lëviza për në Kambar, duke vështuar pas serrën që ndriçon, duhet ta pranoj se u habita që nuk isha në gjendej të blija perime të freskëta te fidanishtja. Edeni ishte djegur e bërë hi. Adami dhe Eva, të gdhendur në lis, ia mbathnin të paprekur. Me zor të madh ama. Mandej u bë një ndotje e madhe nga bima e fuqishme që varej në fshat.

Daja im Harei, erdhi për vizitë dhe papritur e pakujtuar na tha se apartamenti ishte i infektuar me të ashtuquajturin myk shtëpie; ai kishte luftuar për një kohë të gjatë me këtë dhe ia dallonte përnjëherë erën dhe pamjen. Hodhi një vështrim rrotull dhe tha se duke qenë se rryma elektrike ishte tejet e paqëndrueshme, gjërat e dëmshme merrnin hov. Na këshilloi të dilnim prej aty përpara se të na binin flokët, të na ikte mendja apo të na shkatërrohej sistemi imunitar. Zogjtë kur ulen poshtë sjellin gjithmonë grip.

I vumë të gjitha plaçkat në depo. S' dinim ku të shkonim më. Burri im po qëndron për një farë kohe me gjyshen dhe gjyshin në shtëpinë e tyre në fshat. Më telefonoi dhe më tha se më në fund e kishte sqaruar atë historinë e depos së vjetër në Rejkjavik, kishte nxjerrë jashtë një mal me

rrangullina dhe kishte vënë rregull. Dukej i lehtësuar; zërin e kishte më të shndritshëm se zakonisht. Kur mori frymë sërish më tha se kishte shkuar për drekë nga i ati dhe se kishin bërë një bisedë shumë pozitive dhe të çiltër për çështje, të cilat zakonisht nuk diskutohen duke ngrënë. Më tha, po ashtu, se kur gjatë pastrimit kishte hedhur poshtë ca nallane, ishte ndjerë tepër i lehtësuar. Po lexon Sagën e Þórður Geirmundarson-it të Benedikt Gröndal -it. Më kishte marrë malli të dëgjoja të qeshurën e tij dhe më kujtohet se kur filloi të lexonte atë histori komike, rrinte shtrirë në shtratin tonë otoman të gjelbër e të kaltër dhe qeshte me zë të lartë e me gjithë zemër.

Kisha dy kuti me libra, tesha, këpucë dhe produkte kozmetike dhe vendosa që për ca kohë të rrija te im vëlla. Me shpresën se nuk do të më përndiqte myku, fillova sërish të shpresoja për antikitete. Është pa diskutim ndikimi i tim vëllai dhe i relikteve që koleksionon. Kur kthehet nga udhëtimet ditore në shtëpi, ai del nga Land Rover-i me çizmet prej kaubojsi dhe mendon se e ka kapur pasioni për një grumbull gurësh varri. Çështja është nëse është i njëjti grumbull gurësh si ai që Kristjan Eldjárn-i rrëmoi gjatë ditës; do ta shohim, më tha mendueshëm. Në Islandë rrallë gjen rrasa pagane. Lumi i akullt ka marrë një rrjedhë të re, duke mundësuar gjetjen e tyre. Im vëlla ka bërë kërkesa për tërë morinë e autorizimeve të nevojshme dhe shpreson të ketë mundësinë të fillojë sa më shpejt nga gërmimet. Unë mund të shkoj me të si amatore e fushës dhe të sillem rrotull vjedhurazi për relikte. Ai do të marrë një specialist për eshtrat njerëzore, si edhe ekspertë të tjerë. Po, edhe një lopatë të mirë!

Pas darke, nxori një kuti të vogël nga frigoriferi e hapi

dhe më tregoi një zilkë të vogël bronzi të gjetur në një gjermim në veri, të cilën tani i duhej ta studionte.

Shkova rastësisht në muze, kur ka gjithmonë ndonjë gjë interesante për të parë. Dje këqyra ngjyrat e shtëpisë së vjetër ngjitur, e cila është ndërtuar një pjesë me torfë dhe një pjesë me trungje druri. Dhoma e miqve është në një blu të lehtë mbretërore, si shtëpitë në Meksikë, korridori në gurrkali, tavolina e punës në të gjelbër të errët, organoja e vogël në një të murrme të kuqërreme, kuzhina në një krem si në të verdhë dhe dhoma anash në një rozë të fortë e të ndezur si troftë ylber. Sot u hodha një sy fotografive dhe kornizave prej argjendi. Nuk e dija sa më kishte marrë malli. Një mori me pamje, emra të zbukuruar në hapësira të ndryshme në shtëpinë e fshatit: dhoma dhe kuzhina familjare, qilari, dhoma e ndenjes, dhoma e sipërme e familjes, dhoma e bukës, depoja, hangari, streha për tharje, vendkalimi, kovaçhana, hauri, bajgat e kafshëve, koçeku, vendkalim, dera e kryesore, peshorja, papafingoja, shtesat... mandej gjeta planimetrinë e shtëpisë në fshat dhe përshkrimin e mjedisit, fermës dhe banorëve nga një grua, e cila e do shumë atë zonë, Helga Skúladóttir quhet. Ajo shkruan për Keldur-in në zonën e Rangarvellir-it, si edhe për godina fermash të tjera me shpresën se do arrijë t'i fusë në kontekstin global historik e kulturor. Në parathënien e librit pohon: *fermat e Islandës, tani do të mund të ndërveprojnë me njëra tjetrën nëpërmjet lidhjeve shpirtërore, njëlloj si edhe qendra kulturore e vendit, Rejkjaviku ynë, mund të lidhet me institucionet më të mëdha kulturore të botës...*

Gröf-i në Öräfi Dita e trashëgimisë së madhe, argëtim me krem

Jam ulur e po lexoj një raport mbi gërmimet. E pranoj se ndihem si fillestare, si një dishepulle e përdëllyer dhe e palodhur, e cila ushqehet me lugë nga kultura si një i sëmurë me kokrra rrushi. Jam e lumtur që vëllai im i vogël i di fije e për pé të gjitha. Në fakt ai është shefi, por unë kënaqem me poezinë në raport dhe mësoj fjalë të reja. Albarello është një qyp për të mbajtur kremin.

Në këtë raport të vëllimshëm, lexoj mes të tjerash se gjatë gërmimeve u gjetën shtatë copa bronzi; nuk dihet cili ka qenë funksioni i tyre apo nëse janë pjesë të diçkaje, por nuk ma do mendja të kenë qenë pjesë e ndonjë instrumenti me perkusion. Do të vras mendjen. Po ashtu në ato gërmime u gjetën disa xhama prej opali, gurë ngjyrë gurrkali dhe fragmente kuarci të kuq, të cilat mund të kenë qenë përdorur për të ndezur zjarrin. Po ashtu u gjetën edhe gurë smerili dhe dybek. Hangari ishte plot më mbetje bari të thatë.

Bufi është ende jashtë duke kontrolluar, por unë kisha aq ftohtë sa u plasa në makinë. Gjendemi në një shqopishtë pranë rrugës dhe fillimisht s'kishte ndonjë gjë të madhe për të parë, përveç një gunge të vogël mbi terren, por që dëshmonte për një qytetërim bujqësor në lashtësi. Vendbanimi u mbulua i tëri me hi në vitin 1362,

kur shpërtheu akullnaja Öräfajökull dhe vendi u shkretua. Disa dekada më parë, u kryen gërmime dhe u zbulua një ndërtesë, e cila nuk kishte qenë, as vendbanim viking dhe, as shtëpi fshati, por diçka tjetër. Ishte një kombinim i të dyjave dhe tani konsiderohet si tregues i një periudhe të tërë kohore të panjohur. Unë u ngazëlleva përnjëherë, pasi ajo periudhë e mistershme e historisë së arkitekturës islandeze mund të përbëjë mister për zona të tjera dhe nga ana tjetër, nëpërmjet shtimit të gërmimeve mund të zbulohet diçka e re në lidhje me shpirtin kombëtar islandez, diçka mbi bazën e së cilës mund të ndërtohet diçka. Por cili është dallimi ndërmjet një vendbanimi viking dhe një shtëpie fshati me kalime të brendshme? Nga sa di unë, të dyja stilet përfaqësojnë një zhvillim të individit, pikërisht për shkak të ndërtimit të hapësirave në një numër të ndryshëm “ndarjesh”, të cilat lidhen nga një korridor i vetëm. Meskorridorit, a mos rresht së qeni një lidhje modeste dhe shtrihet edhe në pjesën qendrore? Ballinat mandej u zhvilluan nga kalimet e brendshme në korridore qendrore të errët dhe të ngushtë. Disa njerëz të mençur skicuan një ndërtesë me konfigurim rrethor dhe sot ne mund t’i biem rreth e qark. Puna është se nuk dimë përmasat reale të ndërtesave në Gröf ; po ashtu nuk dimë as se si lidheshin hapësirat. E vetmja gjë që dimë është se ndërtesa paraqet një kombinim të dy stileve arkitekturore, ati të së të kaluarës dhe atij të së ardhmes, të veriut dhe të jugut. Për më tepër, ka dy gjëra, të cilat, duke gjykuar nga raporti që po lexoj, më duken si të veçanta në këtë vendbanim: nga njëra anë “banja” dhe nga ana tjetër furra.

Është disi e çuditshme të shëtisësh me makinë nëpër Álftafjörður dhe të shohësh tërë mjellmat. Është

zbavitëse të dëgjosh se në banjën e kësaj shtëpie njerëzit faktikisht laheshin. Sipas këtij raporti, ajo ngjan më tepër me një hapësirë qendrore të shtëpisë, ku kishte një sauna, siç ka qenë zakon në Groenlandë. Po ashtu edhe thuprat e djegura mbi shkëmbinj, që mund të ketë qenë ndonjë formë terapie dhe mjekimi. Unë e ndjeva të vërtetën e këtij koncepti ndërtues: bëhet fjalë për qendër dhe për hapësirë kryesore, për një vend çlodhjeje dhe ripërtëritjeje, për një dhomë pastrimi dhe kurimi. Me gjasa, atje diskutoheshin problemet siç bëhet sot në kanalet publike, po aq haptazi sa ç'dilte edhe djersa nga poret.

Mundet që në ato epoka, fuqia e bisedës mes pjesëtarëve të shtëpisë të ketë qenë më e madhe se sot. Mua më duket sikur më vonë, në dhomat dhe në sallonet e shtëpive, një njeri i veçantë ishte përgjegjës për të përçuar dijen, ndërkohë që të tjerët vetëm rrinin dhe e dëgjonin. Puna dhe gjuha nuk qenë më të lidhura me njëra-tjetrën. Leximet e Biblës dhe radioja nuk të nxisin edhe aq për biseda dhe për pyetje.

E kam të vështirë të përfytyroj se si dukej e tëra, pavarësisht përshkrimeve realiste të furrës dhe depos, të depozitave tetëkëndëshe të hirit, të banjës dhe të qilarëve, të stallave të lopëve ngjitur njëra me tjetrën. Arkeologët janë të stërvitur që t'i bëjnë këto lidhje me mend.

Çfarë shtëpie do ketë qenë këtu? Mundet që njerëzit këtu të kenë qenë fund e krye të vetëmjaftueshëm dhe njëkohësisht në marrëdhënie të ndryshme dhe të ndërlikuara me mjedisin dhe njerëzit në zona të tjera të botës. Deti dhe porti janë shumë pranë.

I dhamë vetes liri përfytyrimi për të mbushur boshllëqet ekzistuese. Mandej i telefonuam mamit dhe

i përshkruam gërmadhat, pasi ajo është tepër e zonja për të vizualizuar gjëra nëpërmjet përshkrimeve. I kërkuaam të përfytyronte se si do të kishte qenë shtëpia. Pastaj u sollëm nëpër shkurre dhe ai gjeti vendin ku ndoshta gjendej furra. Ka pasur formën e furrave të popullatave orkadiane, tha. Megjithëse nuk kuptova se si kishte arritur në këtë përfundim, mendova se ishte lajmi më i mirë që kisha dëgjuar në tërë ato vite. Si ishte kjo? Model popullatash orkadiane? E mirë, po ç’drejtin të jenë? Epo, historianët janë më të vëmendshëm! Një furrë shtëpie me përbërje të pazakontë, e panjohur më parë në Islandë. Mbase si një kullë për drithë, ku thahej gruri për bluarje. Edhe elbi, dhe hithrat përcëlluese. Po bimët aromatike? Po ato mjekësore? E ç’botë është kjo praktikisht; “shpëto të ardhmen tonë tani”? Oh, me origjinë irlandeze, sigurisht. Si gratë islandeze?

Duke ndenjurr në zhavorr u ndjeva keq. Tani që gjendemi në një kryqëzim të Islandës mendoj se duhet të ketë ndonjë traditë irlandeze, e cila të kujton arinjtë. Jo një, por të gjitha llojet e traditave t’i kujton.

A mund të jenë ata njerëz, të cilët nuk kanë idenë e trashëgimisë së tyre irlandeze duke qenë se ajo lidhej me gratë dhe me sklleverit?

Por, nëse ne duam të ndërtojmë njëlloj kulture aristokratike, “udhërrëfyese” ku njerëzit të jenë të palëkundur në respektin ndaj vetes dhe të tjerëve, a nuk duhet të pranojmë skllavin që është brenda nesh? Kësisoj, me përunjësi ne mund të arrijmë të kuptojmë përgjegjësitë tona për t’i shërbyer natyrës dhe njëri-tjetrit. A mund të jetë trashëgimia irlandeze një prej gjërave, e cila dremit në shtresën më të fundme të ndërgjegjes sonë, madje

edhe poshtë ujërave të nënndërgjegjes?

Po, po, eksperti i trashëgimisë kulturore është i përgatitur edhe për këtë debat. Por ai më paralajmëron që të mos verbohëm nga kryqi celtik. Më foli për paragjykimet e dijetarëve kundër entuziazmit amator, të cilët kanë interes të zjarrtë për gjithçka, por që studiuesit nuk flasin dot mjaftueshëm. Një prej këtyre gjërave janë edhe vendbanimet e Islandës përpara dhe gjatë ndikimit celtik, që nga koha e kolonive të papar-ve, murgjërve irlandezë. Duke qenë se burimet janë shpesh të kufizuara, nganjëherë është e nevojshme t'u referohesh provave origjinale, si gurët e varreve dhe astronomia. Dhe, ndonëse shpesh ekzistojnë lidhje interesante, disa prej tyre, me siguri janë nënçmuar dhe ka raste që duken sikur janë bërë përmes një qarku të shkurtër me ndonjë lloj bindjeje fetare. Mandej, duket se njerëzit e braktisin dialogun dhe janë të bindur në vetminë e tyre për njëfarë strukture të unifikuar, e cila rezulton se është tepër e vështirë për t'ua shprehur të tjerëve. Përhapja e pamasë e studiuesve dhe e dialogut, lipset të nxitet në periferi. Për fat të keq, këto teori dhe këto vizione të unifikuara dhe të fshehura kanë qenë të dënuara të mbeten nëpër sirtarët e akademive, ndoshta prej arrogancës apo frikës plotësisht të kuptueshme për shkak të sharlatanizmit, papërgjegjshmërisë dhe masivizimit.

Përpara se të kthehemi në shtëpi, ai shkon të bëjë një skicë të shpejtë të rrënojave pasi thotë se me një vend lidhesh kur i bën një skicë me dorën tënde dhe reflektimet mbi domethënien e vendit i lidh më mirë kur shikon skicat e tua.

E kujtova se si disa njerëz, kur ai kishte dorëzuar

raportin e parë, kishin vënë paksa buzën në gaz sepse ishin të mbushur nga koka deri në këmbë me përshkrime romantike të bimësisë së lulëzuar për shkak të skicave të bukura të bëra rreth e rrotull gërmadhave.

Skógar poshtë Eyjafjöll-it, Festa e Shën Hallvarð-it, Hënë e plotë

Po bëja bollgur dhe po përfytyroja me mend se si duhet të ishte sikur të fusja dorën në tokë dhe të arrija poshtë nëpërmjet epokave, kur eksperti i trashëgimisë kulturore i kthyer nga ekspeditat e tij kërkimore më tha se kishte futur dorën në një vrimë në një varr në një kodrinë dhe kishte nxjerrë prej andej një zog të vdekur. Ç'zog të kishte qenë? Ai nuk e dinte; ishte krejt i dekompozuar. Më tha se nga kjo vazhdonte t'i vinin mornica. Ke frikë nga zogjtë e pyeta? Jo, jo. Por dy arkeologë vdiqën menjëherë pas zbulimit të atij varri, përpara se të mundnin të arrinin ta ekzaminonin në detaje. Paskëtaj edhe mua m'u ngjeth mishtë dhe u lemerisa; kam pasur gjithnjë frikë se mos njerëzit që dua vdesin para kohe, e veçanërisht ai.

Më ftoi për një shëtitje me makinë pas dreke. I duhej të kontrollonte mos kishte ndonjë rrënojë në ndonjë nga ngastrat e tokave, që banorët e ndonjë shtëpie verimi kishin ndërmend ta kthenin në rezidencë. Çfarë murtaje këto shtëpitë e verimit, që janë përhapur anekënd vendit. Të gjitha feramat e blera janë kthyer në rezidenca shtëpish verimi. Në këto lloj shtëpish- shtëpi u thënçin- mungon krejtësisht vetëdija për vlerat e zonës. Ato nuk kanë asnjë lidhje me tokën. Të paktën kështu duken kur u kalon

pranë me fuoristradë me cilindratë të madhe.

Ti mund të thuash se unë dërdëllitkam ca si shumë me veten, se ky vendbanim në bazë të dashurisë për natyrën, mrekulli në vetmi dhe shpesh, mall për ditët e dikurshme në fshat- rrjeti telefonik rural... mbush boshllëqet dhe është pozitiv. Jo, jo, s'ka problem. Është thjesht gjë e keqe që pronësia ndaj tokës reduktohet në gjithnjë e më pak duar se më parë, te ata që merakun e vetëm kanë vetëm të shesin apo të japin me qira sa më shumë parcela që munden.

Njerëzit nga qyteti, terrenin poshtë shtëpive të verimit e shikojnë si truall, jo si tokë. Ka humbur vizioni i integruar i tokës. Marrëdhënia jonë me natyrën ka nevojë të ripërtërihet. Ajo është lidhja jonë me të ardhmen. Në këtë limonti dhe pasiguri të zgjatur ne po humbasin vizionin e së ardhmes. Dhe e kam fjalën për tërë Islandën. Edhe për veten time si pjesë të së tërës.

**Skógar,
Festa e Shën Kolumbës**

Dhoma ime është ngjitur me atë të dhomës së gjumit të mjeshtrit dhe gjendet përballë me shtëpinë ku s'ka jetuar kurrkush tjetër veç kuratorit, motrës së tij dhe burrit të saj. Ajo është inteligjente dhe simpatike si një zog i rrallë. Rrit trëndafila dhe thur pëlhura me vizatime islandeze.

Pak muaj më parë pashë në ëndërr sikur jetoja në të njëjtën shtëpi me kuratorin dhe sikur blija në të njëjtin dyqan peshku, ku kishte ende peshk të freskët një piring me fileto të djegura dhe sikur shitësi më pyeti nëse isha si fqinja ime, e cila hante vetëm fileto të djegura dhe unë i thashë se po, ashtu ishte. Nuk e di ç'kuptim mund të ketë kjo ëndërr; mbase e kuptoj më vonë. Kapica me filetot e shkruмбуara ishte tepër e madhe, masive dhe dilte sipër arkave të ekspozuara.

Dje dola për shëtitje në pyll dhe pashë një buf. Ecte së prapthi sikur të ishte në ekstazë, duke shikuar mes pemëve. Ndjeva një gëzim të brishtë, fëminor në gjithë qenien. Isha e lumtur se nuk u frikësova. Nuk ishte aspak mizor, thjesht fluturoi në heshtje sipër meje dhe më lejoi ta vështroja.

Këtë kam ndërmend t'ia tregoj Bufit, pasi edhe ai, njëlloj si unë i ka tmerr bufat. U kujtuam kur pamë një

mjellmë që fluturonte drejt një banese eskimeze, që kishim ndërtuar dhe u ul përpara saj. Thamë mos ishte ndonjë zog prehistorik, pasi nuk kishim parë kurrë mjellmë nga aq afër. I telefonuam gjyshes me rrjetin e telefonit rural për t'i thënë se kishim parë një si biçim struci te lumi, por dëgjuam si qeshte nën hundë; kushdo që mund përgjonte do të përmbahej. Por tani ai më tha se ndoshta unë s' duhet të kisha parë buf dëbore, pasi ata janë gjigandë, kështu që hamendësonte mos do të kishte qenë ndonjë buf me veshë të shkurtër. Me sa duket poshtë mjekrës dhe poshtë krahëve ata janë të bardhë.

I telefonova Zogut dhe i dhashë lajmin. Më duket sikur më ka prekur diçka hyjnore, thelbi i natyrës, tingulli i saj më i thellë. Të arrish ta shohësh prej vërteti, nga aq pranë, pasi të ka dalë kaq e kaq herë në ëndrra. Është si të shohësh kufijtë mes ëndrrave dhe të ecësh me këmbët e tua. Ende s'jam e bindur se ai nuk ishte buf dëbore. Ai më tha se ata janë si mjellma pa kokë. Jo, atëherë ka qenë buf veshshkurtër, i thashë dhe ai ia bëri se është gjë shumë e mirë të shohësh bufë veshshkurtër. Kemi vënë në plan të takohemi në gjysmë të rrugës për solstic. Të gjejmë një shpellë vetëm për ne të dy. Mbase Shpellën e parajsës; kur mendoj për romanin e Jon Traustit unë ndihem si e therur.

Bashkë me tim vëlla gatuam gjuhë viçi me *tarragon* duke u kredhur në një nga ato bisedat që duket sikur s'kanë të mbaruar, si një zbulim i madh, që sjell një kuptim dhe një gëzim më të madh dhe të bën të ndihesh gjithë besim. Pasi folëm ca në lidhje me modelin e bashkëjetesës, ramë në një mendje se familjet e zgjeruara të dikurshme janë e ardhmja, nëse arrijmë të gjejmë ndonjë formë të re.

Sidoqoftë, unë kam ca rezerva në lidhje me dukurinë e familjes së zgjeruar. Më është kujtuar përkufizimi i Hana Arendit mbi hapësirën publike dhe zhdukjen e saj, mbi origjinat e totalitarizmit dhe fundin e demokracisë. Shpesh jam gjendur duke menduar për idetë e saj kur vizitoja shtëpitë e njerëzve. Duket sikur mjediset që ndajnë, në një farë mënyre janë pasivë, janë hapësira ku është e mundur të çlodhesh dhe të mendosh në afërsi intime për të afërmit dhe të dashurit e tu, të krijosh shoqëri e të kapërcesh vështirësitë. Por, ka raste që përpjekjet bëhen për të krijuar hapësira të përbashkëta, të cilave adoleshentët u kthejnë kurrizin e turren drejt e për te dhomat e tyre ku mund të gjenden të gjitha llojet e afisheve e çikërrimash të tjera.

Kur e thua, mund të tingëllojë si klishe, por sot, me shumë gjasa televizioni ka zënë vendin e hapësirave tona të përbashkëta. Mund të jetë edhe nga ankthi se në hapësirat e përbashkëta nuk bëhet qejf sa duhet. Nga stresi që infekton pushimet tona, kur udhëtimi me makinë bëhet i padurueshëm për shkak të energjisë që nevojitet dhe adoleshentët duan më mirë t'ia mbathin nga shtëpia pasi janë mësuar të rrinë nëpër dhomat e tyre dhe nuk ndiejnë nevojën të kontribuojnë për bashkësinë. Disa vazhdojnë të mbeten adoleshentë dhe nuk e kuptojnë kurrë se kanë po aq përgjegjësi për atmosferën sa edhe gjithë të tjerët. Kësisoj, të tjerëve u duket se kanë më tepër përgjegjësi se kushdo qoftë. Në një makinë ku udhëton e gjithë familja, nuk është e thjeshtë të gjesh një të mesme të artë!

Kur pyeta gjyshen nga veriu për hapësirën e gruas, ajo m'u përgjigj se mundet që më e mira të jetë stalla e lopëve. Atje duhet kërkuar paqja dhe qetësia më e madhe.

Të mendosh kur je pranë kafshëve është krejt ndryshe nga sa të mendosh vetëm.

Hana Arendi thoshte se gjithkush ka nevojë të ketë një hapësirë tije, ku ai ose ajo të bëjë ç'të dojë, por nga ana tjetër, njerëzit kanë nevojë të kenë mundësinë të përdorin edhe hapësirat e tjera, ato të përbashkëta, të cilat nuk i kontrollojnë kush. Kjo ndodh kur ka mjaftueshëm hapësirë për të diskutuar seriozisht dhe me shaka për gjithçka, ku mund të ndajnë përvojat, historitë dhe gjithashtu edhe vizionet e tyre për të ardhmen.

Njerëzit e kanë kritikuar Arendin si romantike të marrë, e cila nuk e shikon që njerëzit nuk futen kurrë në këtë hapësirë publike përveç se për t'u përpjekur që të fitojnë kontrollin ndaj saj dhe për të bindur të tjerët për opinionet dhe interesat e tyre. Praktikisht, të tillë janë politikanët në pjesën më të madhe të rasteve. Arendi hodhi vështrimin pas dhe konstatoi intolerancën e forumeve publike, të cilat nuk kanë një plan të parapërcaktuar. Edhe intolerancën ndaj hapësirës, e cila nuk është nën kontrollin e diçkaje specifike.

Arendi, e përshkruan totalitarizmin si një prirje shekullore për të shtrirë hapësirën private në një forum të përbashkët gjithëdepërtues, e cila, në fakt, nuk është një hapësirë lirie, por një iluzion, një ekspansion për t'i lënë njerëzit pa qetësi private, por edhe pa një hapësirë publike, realisht të lirë e për vendime të paimponuara. Por duke qenë se toka thërret për biolarmi, demokracia kërkon respektimin e zërave të ndryshëm brenda komunitetit, çka kërkon sërish një hapësirë publike, e cila përbëhet nga çfarë ka më tepër rëndësi: interesat e vërtetë ndërmjet individëve të ndryshëm në kohë të ndryshme.

Skógar,
Mesverë dhe Festa e Martinës,
guida gjermano-islandeze, e cila jetonte në këtë
shtëpi dhe na tregoi historinë e saj.

Ai po fluturon me flatrat e holla me një pishtar të salduar, çka e shtyn të bëjë figura të çrregullta. Ëmbëlsirat në formë hëne shkojnë mirë me gjalpë edhe kur janë të djegura. Është mesnatë dhe ne po dembelosemi duke kënduar secili këngë më vete. E kam vënë re. Njëlloj si dikur në shtëpi, ku gjithsekush këndonte këngën e vet, shpesh të njëjtën e, që e përsërit një e dy. Po ashtu na kujtohen disa sende që lidhen me hapësirën shtëpiake. Ata të ashtuquajturit, “intervale”, praktikisht ishin një zgjidhje e shkëlqyer për të varur qengjat e tymosur dhe thëllëzat. Babai vendoste radio në të gjitha dhomat në mënyrë që kur t’i ndizte, çfarëdo programi që të ishte duke u transmetuar të dëgjohej në të gjithë shtëpinë. Mamaja bënte takime në banjë; asaj i pëlqente shumë Stöng-u kur jetonte ende Gaukur-i plak dhe kjo ishte thelbësore për çështjet që diskutonim, në një gjendje të shkëlqyer argumentimi e njohjeje me themel.

Folëm për udhëtimin në Stamboll ku kishim shkuar dimrin e kaluar e ku kishim qëndruar dy javë, ndonëse kjo do të kishte qenë më mirë se të kishim shkuar së bashku. Atij i vinte keq që nuk kishte parë mbishkrime

me alfabet runik te Shën Sofia: *unë isha këtu*. Edhe Gaukur-i nga Stöng duhet të jetë menduar mirë përpara se të gdhendte emrin e vet në një mesazh të ngjashëm te ai shkëmbi në Orkad. Por ndërtesat e bukura atje në Bizantin e vjetër kanë një kujtesë disi të mugëlluar. Më kujtohet se u kënaqa te Xhamia Blu, pasi me erdhi në mendje diçka tepër e rëndësishme, ndonëse tani nuk më kujtohet tamam se çfarë; di që e mbajta shënim, por hajde gjeje se në cilin bllok duhet të jetë. Ndërkohë që kisha pasion trëndafilat dhe ngjyrën blu, isha krejt e magjepsur nga Xhamia e trëndafilave blu. Dola bashkë me një shkrimtar indian dhe blemë qumësht të ngrohtë e lotus me aromë kanelle. Pastaj soditëm atë burrin e shenjtë që ngjante me shumë me një arush pellush dhe diskutuam për temën e disertacionit, e cila po zgjerohej e thellohej, sa mund të bëhej roman. Diskutuam gjithashtu edhe për shumëllojshmërinë letrare në frymën e biolarmisë. Si mund të ushqejmë format jo parësore të letërsisë? Mandej pashë një mur të mbuluar me lule dredhka, çka bëri që pasioni për këtë të dilte mbi pasionin për trëndafilat. Vrisja mendjen se si kapërdridhen në gjithë kontinentin, nëpër kufi, mbi plagët e plumbave nëpër ndërtesa dhe në rrëpirat e boshteve nëpër pemë.

Zogu më telefonoi dhe më pyeti nëse isha ende duke bërë muhabet me tim vëlla. Ju të dy me siguri që llototitni, ia bëri miqësisht. Njoftoi se ishte rrugës për në Stamboll, i ftuar në një konferencë zogjsh. E po hë, çfarë coincidence! Tamam Stambollin kisha në gojë! Arrita t'i thoja mirupafshim pak përpara se të largohej. Pas qëndrimit tonë në shpellë, trupi i tij ishte ende tek unë; shkua më persëri në një shpellë të fiseve *papar* në zonën e

Landsveit-it dhe kur ndezëm qiriun pamë shtatë kryqe. Ngadalë, shkuaam tutje e më tutje me një shishe verë porto, vajra aromatikë dhe një shilte. Pa asnjë autorizim. Administratorët vendorë të trashëgimisë kulturore s' do ta marrin kurrë vesh.

Bufi është jashtë duke bërë një mbajtëse për bidonin e kompostos, duke punuar tokën e kopshtit të primeve dhe duke ëndërruar një kopsht frutor. Këtu është libri *Varret pagane dhe varret e zotave*, të cilin unë e vështroj sa herë që më jepet mundësia. Duhet të konkurroj për ndonjë punë në muzeum dhe këtë ide ia thashë Bufit.

Kësisoj mund të marr një apartament në fshat, diku këtu afër, ku është plot me zogj dhe me pyje. Bufi im megjithatë, thotë se mendon që ky është disi jo realist si plan; duke pasur natyrë endacakeje, unë zor se mund të marr përsipër punë të tilla. Epo, dua të rresht së bredhuri, i thashë dhe i kërkova të telefononte dhe të pyeste nëse te muzeumi kanë nevojë për personel. Më vështroi dhe me dy sy të zgjuar më pyeti nëse kjo ishte vërtet ajo çka doja.

Kambria,
Festa e Shën Suidhënit të Mançesterit, Hënë e plotë

*Luledredhkat rrotull lisave, harbojnë
si gjarpërushe të vogla
Dita e ftohtë- një vatër e ngrohtë
te kaçubet me manaferra gjithë teka....*

Doroti Uordsuorth
Grasmere Journal

Nga autobusi zbrita në stacionin e gabuar dhe
Eca gjatë pa ditur ku ndodhesha, duke dëgjuar
mrekullinë e blegërimave të bagëtisë. Më erdhi mendimi
se “blegërima”, në gjuhën islandeze duhet të jetë në
gjininë asnjëse, por pardje dëgjova dikë që e përdorte
në mashkullore dhe ky ndryshim më zbaviti; mbase i gjej
unë një trajtë femërore. Sidoqoftë, bagëtia këtu është e
çuditshme- leshin e ka të prerë shkurtër dhe mishin të
fortë; qengjat duken si peshq buçko e me lesh.

Në mes të erës që frynte me të madhe u futa në kishën
e mbushur plot me bar të thatë; aroma ishte fantastike, por
s’kishte këmbë njeriu. Pashë Shën Osvaldin, për të cilin
thuhej se ishte stërvitur të lutej dhe kësisoj ishte ngritur
sipër dobësive të mishit. Duke parë kishën, vura re se
ishte e zbukuruar me shilte me imazhe të të gjitha llojeve
të dukurive natyrore: akull dhe dëborë, dritë, kërthiza të

sapolindurish dhe kafshë. Një shenjë e vogël tregonte se Uilliami, me ndihmën e të motrës, Dorotisë, kishte mbjellë pemë bërsheni dhe narcis të verdhë në kujtim të fëmijëve të vdekur dhe atyre që nuk kishin lindur ende.

Dola në oborrin e kishës dhe pashë varret e vëllait dhe motrës, si edhe pemët në të gjelbër të errët. Mendoj se ishin pemët më të bukura që kam parë ndonjëherë. Nuk kam laps me vete të marr shënime, kështu që përsëris emrin për mos ta harruar bërshen, bërshen, bërshen. Më tej shkova në fshatin Grasmere, ku më pritën ca gala krenare, që po bridhnin aty rrotull. U thashë tuj- tuj, por e kisha të qartë se duhet të mblidhja mendjen e të merresha me punën, për të cilën kisha shkuar. Po, tamam, gjendesha në fshatin e vëllait dhe motrës.

Po, isha në qiellin e shtatë, pasi kisha ardhur te rrënjët e romanticizmit. Ishte vërtet tronditëse të silleshe rrotull nëpër fshat, të vështroje nga dritaret e dyqaneve dhe të shihje gjithë ata jastëkë të zbukuruar me narcisë të verdhë të kalbur dhe me gjëra të tjera që lidheshin me historinë e Poetëve të Zonës së Liqenit. Një gjë është të kujtosh diçka, tjetër është të mbetesh i kapur pas saj. Përse njerëzit nuk blejnë tableta elektronike për të marrë shënime dhe të shkruajnë poema, në vend që të mbërthehen fort pas jastëkëve poetikë e shohin TV? Përse nuk ripërtërijnë romanticizmin, përse nuk rikthjellojnë marrëdhënien ndërmjet krijimit dhe kujtesës?

Epo, unë për vete, erdha këtu tamam si një qen që nuhat monumentet. E ngazëllyer nga reliktet: nga tufat e flokëve që poeti fuste nëpër letrat që dërgonte, qirinjtë që i bënte nga dhjami i bagëtive dhe i përdorte për të shkruar. Ai nuk donte të shkruante në një tavolinë

normale, po përdorte një dërrasë, të cilën e mbante mbi gjunjë e, të cilën unë e sodita gjatë, mes shumë objekteve të tjera. Mbase është vetëm çështje estetike. Nëse ne, në rindërtimin dhe lartësimin e së kaluarës kalojmë përmes të papërcaktueshmes dhe vijave të holla, ndihemi sikur estetika dhe bukuria qëndrojnë në amulli, çka duhet të jetë një kundërshti në vetvete- bukuri e amullt, bukuri e standardizuar. Padyshim, që bukuria duhet të jetë në lëvizje. Apo të jetë lëvizje.

Në këtë ekskursion, për ciceron kam ditarin e Doroti Uordsuorthit, motra e poetit të famshëm romantik Uilliam Uordsuorth. Një libër i tij më elektrizoi dhe rashë brenda. Është tejet frymëzues, ndonëse praktikisht nuk flet për asgjë. Megjithatë, m'u duk ishte ca i tepruar. Për shembull, mund të mësohesh nëse vëllai i saj në këtë ose në atë ditë kishte bërë gjumë të mirë apo të keq, nëse kishte shkruar deri vonë natën apo jo. Pasi e lexova e ndjeva se duhet të vija këtu, të zbuloja më shumë për jetën e tyre të përbashkët, të shihja me sytë e mi nëse nga banesa ku kishin jetuar mund të mësoja ndonjë gjë për afërsinë e marrëdhënies mes tyre. Gjithnjë në rast se do arrij të zbuloj dot gjë.

Po shkoj të kërkoj shtëpinë Davëve. Dorotia rrëfen se si pjesën më të madhe të kohës e kalonte me të vëllanë në pemishte. Kishin qenë jetimë e të ndarë prej shumë vitesh e, më në fund po jetonin së bashku. Në atë pemishte, Uilliami kishte rishkruar poemat e tij dhe ajo i kishte lexuar e ndrequr dhe mandej i kishte hedhur në ditarin e vet. Nuk përjashtohet të ketë shkruar edhe vetë ndonjë poezi, e cila nuk ka mbijetuar. Ndonjëherë, teksa ajo lexonte ai vinte dorën mbi sup. Nga mënyra si ajo e

përshkruan këtë dhe nga gjykimet që jep mbi poemat e tij, rezulton se besimi mes tyre duhet të ketë qenë i përsosur.

Mbrëmjeve shëtisnin nëpër shtigje që i dinin vetëm ata; shtigjet që të shpinin në një shpellë të vogël me myshk apo në një tendë prej qeramike në kodrën sipër shtëpisë së Davëve. Atje uleshin, bisedonin dhe vështronin liqenet. Unë jam në Lakeland, vendin e liqeneve.

Grasmer Plashmës

Nuk kisha zënë dhomë në hotel. Nga harta s'arrija të kuptoja se ku ndodhej. Eca më tutje për te liqenet, drejtim të maleve, teksa më mbërrinin fort në veshë blegërimat. Dhoma të lira s'kishte. Vonë natën zura të ndihesha disi e dëshpëruar dhe pranova një ofertë të minutës së fundit në një hotel më të shtrenjtë ku nuk kisha qenë ndonjë herë. Tani jam ulur te hollu luksoz dhe rreth e rrotull shoh vetëm persona të moshuar.

Vendosa ta gëzoja plotësisht dhomën. Renda në banjë, shtiva uiski në një gotë dhe shkrova disa letra me në ato fletët e mira që gjendeshin në dhomën e hotelit.

Në mur sipër shtratit është varur një riprodhim i dobët i luleve të diellit të Van Gogut, çka më bën të mendoj për vardisjen pas fantazmave të piktorit, kur shikonim filmat për të. Mbjaj mend se si hidhëroheshin nga ai maskarai Gogeni, të cilin Van Gogu e kishte ftuar të shkonin bashkë dhe të pikturonin në paqe e në qetësinë e jugut, madje kishte bërë edhe përgatitjet për ardhjen e mikut të tij duke pikturuar luledielli në të gjitha dhomat e shtëpisë. Fërgëllonte i tëri që do të shihte mikun, i cili doli një idiot.

Duke qenë se shumica e klientelës së hotelit ishin pronarë tokash, menyja e mëngjesit ishte tepër

aristokratike dhe rustike; salla e mëngjesit më kujtonte hotelet e vjetra në fshatrat e liqenit Mývatn, ku zogjtë britanikë vrojtues mund të uleshin vetëm nëpër tavolina, duke shfletuar artikuj mbi sjelljet e rosave karagjoze.

Diku kisha lexuar se Uordsuorthi dhe motra e tij kishin ngrënë gjithmonë të ashtuquajturin qull për mëngjes që e pashë edhe në meny. E porosita dhe pyeta kamerierin se çfarë ishte. Më tha se bëhej fjalë për diçka që praktikisht nuk e përshkruante dot me fjalë dhe kjo më nxiti fuqishëm dëshirën për ta ngrënë. A dëshironin ndonjë gjë tjetër? më pyeti kamerieri dhe për të qenë e sigurt, i porosita një suxhuk. Mandej, me shumë ceremoni sollën një tas me bollgur mbi një tabaka. Duhet ta pranoj se bollguri, i shërbyer me krem ishte vërtet shumë i mirë. Dukej vërtet mirë për ta nisur ditën. Pasi e thava të gjithë tasin, më erdhi sollën suxhukun në një pjatë argjendi.

Grasmere

Ditë në shpellë, Festival i librit ndërkombëtar dhe i myshkut

Pasi rrëmovja ca në librarinë e vogël të fshatit dhe pasi postova letrat, shkova te shtëpia e Davëve. Së pari, te muzeumi ngjitur vizitova një ekspozitë të veçantë në lidhje me Shelleys-in që shkruante gjithë kohën dhe një grumbulli të vogël e të ndotur librash që qenkëshin “Ditari i brengës”, të cilin Meri Shelli, nëna përbindësh e kishte shkruar pas vdekjes së të shoqit; më vonë libri kishte rënë në ujë. Pashë gjithashtu, edhe disa gjëra shumë të bukura që i përkisnin Kollrixhit, mikeshë e afërt e Dorotisë dhe Uilliam-it.

Në një kuti të veshur brenda një eksponati qelqi gjendej unaza e martesës së Uilliam-it, por pa raporte psikologjike mbi sjelljet e fantaksura të së motrës. Kishte vetëm disa radhë marrë nga ditari i saj mbi dasmën e të vëllait. Ajo shkruante se si ai i kishte kërkuar të flinte me atë unazë qysh në prag të dasmës, se si ajo ia kishte dhënë dhe si e kishin puthur sikur të ishin duke dhënë lamtumirën.

Natyrisht, ajo ndihej e lumtur që i vëllai po martohej me një grua të mirë; fëmijët e tij i donte sikur të ishin të vetët dhe u kishte bërë një dhomë të vogël e shumë të bukur lojërash, ku muret e veshur me gazeta krijonin një atmosferë jo reale. Në atë çast aq kremtues ishte e

natyrshme të lotoje nga dhimbsuria dhe gëzimi. Veç kësaj, Dorotia nuk kishte askënd tjetër. Ajo dhe Kolrixhi ishin shoqe dhe kishin varësi nga opiumi, por kurrë nuk arriti të krijonte familjen e saj. Ai, nga ana tjetër, e krijoi një familje, por kurrë nuk arriti të dilte mbi adoleshentin që kishte brenda vetes. Familja e tij ishte e ndarë dhe e lënduar dhe i dha fund asaj jetese me një shoqe, me llullën, bojën e shkrimit dhe vaj të helmatisur.

Kur hyra në shtëpinë e Davëve isha në një gjendje festive, por pasi e vizitova dhe pasi dola nga dera në kopshtin me dru frutorë, u bëra e respektueshme; për një çast, koha për mua ndali.

Ishte kaq bukur sa m'u mbajt fryma. Gjëja e parë që më përshëndeti ishte një lule dredhkë e uruar e kacavjerrë nëpër shtëpi dhe nëpër pemë, mure dhe ura që të thyenin besimin dhe të plagosnin zemrën.

Jam ulur në shpellën me myshk atje ku motër e vëlla kalonin orë të tëra, duke shikuar fshatin dhe duke shkruar poezi. Shpesh u vinte edhe mikësja e tyre, Kolrixhi. Ja si e përshkruan Dorotia atë qëndrim në shpellë: *E pamë atë duke u ngjitur nëpër shkëmb. Ai na thërriti dhe e gjetëm në një tendë- më i ëmbli që kishim parë ndonjëherë. Shkëmbi në një rën anë ishte tepër i lartë dhe e mbuluam me lule dredhka, të cilat u varën, vumë edhe tufa me manaferra të murrme.*

Dhe kishte edhe një drurë rruke dhe zilka rozë, të cilave në islandisht u thonë lule gishtëza. Ato zbukurojnë edhe kopshtin në Skógar.

U largova nga pemishtja pasdite; dielli ndriçonte fort dhe bletët zukatnin. Doja të rrija më gjatë; pema e

vadhës formonte një figurë, që më bënte të ndihesha sikur isha kthyer pas në shtëpinë ku jetonim me ekspertin e trashëgimisë kulturore. Të nesërmen u ulëm në një stol druri te korija dhe folëm për fshatin; ai më çoi te stallat e vjetra të djegura të dhenve - ishte ndjerë gjithnjë mirë atje, kur e bënim me turne në periudhën kur ato pillnin. Ishin kohët më të bukura që kishim kaluar bashkë, kur ndienim një sëmbim të lehtë për mallin për nënë dhe babain; na duhej të mbaheshim fort, të ishim bashkë dhe zbuluam se mund të kishim besim te njëri-tjetri.

Ecëm nëpër pyll, duke ndjekur të njëjtin shteg si edhe vëllai me motrën, duke biseduar për arsyetime të thella. Blegërima me zë të lartë e vëllezërve dhe motrave të ndarë nga nënat ende në gji. Eca edhe ca më tutje, deri sa dola në një tjetër shteg që të shpinte pranë shtëpisë tjetër, ku ishte vendosur e tërë familja pasi kishin jetuar për tetë vjet në shtëpinë e Davëve. Ca ketra të mëdhenj, të shëndoshë e të kuq, përplasin bishtat mes pemëve. Unë bëra shurrën në pyll dhe hëngra mjedër. Ndihesha e frymëzuar dhe poetike; vështroja liqenet duke ecur së prapthi. Çanta e shpinës ishte e rëndë, pasi kisha veprat e plota të Uordsuorthit dhe Baladat lirike.

Te muzeumi tjetër, ai i shtëpisë së Uodrsorthëve, atje ku për shumë vite ai kishte jetuar me të shoqen dhe të motrën, m'u zhduk i tërë romantizmi. U përpoqa të tregoja interes për shtëpinë duke këqyrur mobilimin e hapësirës me saktësi shkencore; këtu, më në fund, poeti kishte pasur dhomën e tij të punës, sipër dhomës së gjumit të së motrës. Me pamje nga liqenet. Kishte edhe një goxha bibliotekë. Por s'kishte më shpirt. Nuk ishte më në shtëpi ose nuk ishte më tek unë. Njëlloj si një gjitari kur i ikën

qumështi e s'i mbetet as edhe një pikë e vetme, sikur t'i vesh edhe fizarmonicistin më të mirë për t'ia nxjerrë me tinguj.

Atje nuk u ndjeva edhe aq mirë dhe dola në kopsht. Pyeta kuratorin japonez në lidhje me lule dredhkat se mos kishte pasur edhe orkide. Ai m'u përgjigj se nuk e dinte nëse në këtë shtëpi të ishin rritur ndonjëherë orkide. Më rezultonte një mospërputhje, së cilës nuk i gjeta dot shpjegim. Bleva disa kartolina dhe një libër me receta, ku futej edhe ajo e qullit, e biskotave të mrekullueshme me gjalpë, një libër me emrat e luleve që kishin kultivuar vëlla e motër, si edhe disa fara për t'ia dhënë Bufit, në mënyrë që të rrisë lule britanike, që u ngjajnë shumë sanëzave, por që nuk janë aq të vogla, pasi rriten vetëm në veri. Çelin vetëm kur ka diell të butë.

**Kambria,
Fesat e verës e Shën Porlákur-it,
Dëshirë për më tepër netë të bardha**

Karriget janë bërë pis nga çamçakëzë të ngjitur prej shumë kohësh prej adoleshentëve, por është një ndjesi e mirë të sillesh me gjithë shpejtësinë e të çash përpara. Jam në një tren për në Mançester. Do të kalojmë natën dhe do të vizitojmë shtëpinë e Xhon Raskinit, Brenvudit, të cilën ai e rinovoi sipas ideve të tij në një arkitekturë organike, duke i vizatuar vetë letrat e mureve në bazë të ëndrrave dhe fantazive të veta. Më pas do të vizitojmë shtëpinë e Beatriks Poterit, e cila për Xhonin kishte shkruar se ishte mi qyteti, që nuk e duronte dot qetësinë e fshatit, ndërsa Timi Uillin e quante mi fshati, pasi nuk e duronte dot poteren e qytetit. Një vend i përshtatet një njeriu, një tjetër vend i përshtatet një tjetër njeriu. Për vete, unë preferoj të jetoj në fshat, si Timi Uilli.

Për momentin, po kënaqem duke blerë librat e tyre. Duhet të vi sërish këtu dhe pa vonuar. Mandej të shkoj më në veri dhe të vizitoj ishujt. T'u hedh një sy rrathëve të gurtë, të cilët mendohen se janë orë diellore apo kalendarë, që lidheshin me adhurimin pagan të solsticit. Qëndrimi në këtë vend do të na shërbejë si stazh për demokracinë e re, e do të hartojmë një tekst paraprak për ndonjë forum publik.

Demokracia e solsticit; si tingëllon kjo?

Duhet të kem qenë tepër e zonja që preka gurët, pasi ndihem si në një udhëkryq, si në një solstic. Mbase duhet të kisha qenë më e shpejtë për të hyrë në epokën e re nëse do ta kisha bërë me gurët, të cilët janë tepër pranë. Pa keqardhje, po shkoj sa më shpejt që mundem apo sa kam dëshirë. Apo, siç shkruante Uilliami:

*Kalendarin e jetë sonë
s' do ta hartojmë sipas formash të zymta:
Qysh sot, o miku im
Fillimin e vitit do të caktoj më*

*Një lindje universale tani po fillon
Zemrat nxjerrin avull
Nga toka te njeriu, nga njeriu te toka shkon
Është ora e ndjenjave*

*Një çast i vetëm tani, mund të na japë më tepër
se sa viti i arsyes rraskapitëse:
Shpirtin e kësaj stine në çdo meditim
Mendjet tona do të pinë*

*Atëherë eja o mitra ime! Eja, të lutem
Vish me ngut fustanin e pyjeve;
E mos sill libra: të paktën për një ditë
Eja t' i jepemi plogështisë*

E motra shkruan në ditar se ajo dhe i vëllai shtriheshin të dy në tokë, dëgjonin frymëmarrjet e njëri tjetrit dhe ato të ujit në ajër. Mandej ai i thotë se përfytyronte sikur

ndodhej në varr e në një heshtje të plotë dëgjonte tingujt e paqtë të tokës duke e ditur se miqtë e dashur ishin pranë.

Nën pemën e bërshenit. Doja të shtrihesha dhe të merrja frymë gjatë. Mandej doja të ngrihesha dhe të haja biskota me xhinxher në shtëpinë e kekut me xhinxher, t'i zhysja në musht molle, siç shpresonte gjithë gëzim ta bëja, ketri mbi supet e mi, por që gabimisht më ngjeshi një arrë në hundë. Apo diçka tjetër. Më kujtohen fjalët e Ejolës, motrës sime të idealit. Kur merrte shumë zjarr, duke parë dallimin mes betejës sonë dhe një të vjetre ia bënte: Jo, nuk ka kthim pas te natyra, por ecje përpara! Përpara drejt natyrës!

Sodita gjelat që fluturonin, duke ndjekur njëri-tjetrin me shpejtësi. Kështu, rrugës nëpër shtegun tim, rroka një boçe dhe u rashë pas, duke i dhënë lamtumirën zonës së liqeneve. Duke çaluar nga njëra këmbë arrita autobusin, të cilit i kishin hequr tavani. Kërceja drejt qiellit dhe fshikja kurorat e pemëve me kurorën e kokës sime dhe kurorën që më krakëllinte në kokë e më fliste për shakatë e së ardhmes duke më thënë se sa zbavitëse mund të ishte të kisha një shtëpi timen. Të paktën, sendet e mia do t'i vija nëpër rafte.

Përse Dorotia nuk jetonte me Kolrixhin, për shembull? Përse nuk krijonin një shtëpi platonike së bashku? Kësisoj mund të arrinin në një lidhje më dinamike me shtëpinë e Uilliams-it. Në vend të kësaj, ajo u përqendrua tërësisht tek ai dhe përfundoi në depresion për shkak të intimitetit, të cilin, në fund të fundit, nuk e thelluan kurrë.

Pak më vonë pashë një shenjë të vogël: Zona e Bufit. Reflektova për depresionin dhe për intimitetin, çfarë

lidhje mund të ketë mes tyre. Po për Bufin? Ai i le vezët e veta në foletë e zogjve të tjerë, shpesh fole skifterësh, por nuk varet nga asnjë. A ishte Dorotia e varur nga i vëllai? A ishte ky problemi? Mbase, varësia nga intimiteti, afria, është vetëm një hap larg nga depresioni.

Mandej ra telefoni. Ishte ornitologu im, i cili më telefononte për të më kujtuar se unë jam thëllëzë dhe se duhet të kem kujdes nga fajkonjtë! Jo, paskëtaj s'folëm më për zogjtë. Fliste nga një rrjet telefonik me tarifa ekstra dhe arriti të më thoshte se me qënë se do t'i binte rruga nga Ujdhesat britanike, po të kisha dëshirë të shkoja ta takoja. Po tallej gjë kështu? Brofa në këmbë dhe renda për te stacioni i trenit si e marrë e u bëra e tëra me myshk të bardhë. Mendja më vërtitej, teptisej andej- këndeje dhe e qortova veten apo u përpoqa të ndreqja mendimet dhe pështjellimin tim të trashëguar ditë-natë apo çfarëdolloj pështjellimi tjetër që të ishte.

Oh, sa e papërshtatshme është të rrosh me masturbime mendore, të luash me idenë se jeton me vëllain dhe gruan e tij në një pjesë të shtëpisë së tyre, praktikisht në një dhomëzë dhe aty të shkruash e të mjelësh dhitë. Tani unë s'kam kohë për të humbur! Vazhdo, more zog i akullt, që je zier më shumë se ç'duhet, o i marri i mjegullës, zilkat do të rreshtin dhe vijat do të zbardhulen në atë skuffjen tënde të çarë prej karagjozi, veç në mos zë e rend qysh tani! Bam, bam dhe bum, bretkosa në kuti- krimbi në lumë.

Me këmbët e lagura takoj të dashurin tim në një tokë jo të njomur me shurrë, por thjesht në një shqopishtë të lagur britanike. Kthehem ta shoh në sy, drejt; pa u përvjedhur.

E lamë të takoheshim në një bibliotekë me famë, që mbante emrin e njëfarë Rilandsi, një pionier i prodhimit të stofrave dhe koleksioner librash. Ai tha se ishte neogotike. E ç'na qenka kjo? Neogotike! Mendova të mos ia thoja në telefon, duke qenë se e kisha bërë këtë ndryshim, por unë në fakt kam filluar të lexoj për shpirtin gotik në librat e Ruskinit; është një libër i kuq, me lulka e i zbukuruar me gjethe. Në të, Ruskini përzien shpirtin gotik me disa elemente të pandashëm:

Egërsia

Ndryshueshmëria (larmia, dëshira për ndryshim)

Natyralizmi (lidhja e afërt me natyrën)

Grotesku (përfytyrimi pa fre)

Ngurtësia

Bollëku

Zbukurimet ishullore. Tiparet islandeze? Shiko, këtu kam shkruar “mynstur” (tipare) me “Y”, pasi periudha, gjatë së cilës unë nuk e duroja dot “y-në” dhe doja ta shihja të shkruar me “u”, “eyjamunstur” (tipare ishullore), tanimë ka mbaruar. Mund të jetë e këndshme të rrish me një pedagog të gramatikës e të diskutosh pak me të; duhet të shkoj të blej kafe dhe *crepes* me krem dhe të flas për ishujt, për mikpritjen, për jastëkët me vizatime poshtë kokave të lodhura, si edhe për zbukurimet me gjethe dhe bukë në muajt e urisë. Sa e zë me gojë këtë më merr uria.

Ulur përbri meje është një çift në moshë të mesme. Gruaja nis të bisedojë me mua...

Na ecën muhabeti; ata, para se të zbrisnin nga treni më dhanë adresën dhe më ftuan t'u shkoja për vizitë e

të rrija sa të doja. Unë mbllaçis biskota me pak kalori. Kam vënë në plan që kur të kthehem në shtëpi të ndërroj dietë, pasi më ka pushtuar një dëshirë të zjarrtë që për një shëndet më të mirë të ndjek metodat e vjetra.

Vura re se në qafë gruaja mbante një varëse, për të cilën më tha se ishte me vizatime celtike. E kishte blerë në Orkni. Orkni? brita unë . Ajo më pyeti: pse, si është puna? I tregova për shtëpinë me furrë në Islandë, e cila ishte me forma orkadike dhe i shpjegova se nuk ishin bërë ende kërkime për ndikimin orkadian. Nuk më kujtohej tamam si ishte puna konkretisht e se përse duhet të ishte kaq frymëzuese të kërkohet ndikimi orkadian. Më kishte dalë krejt nga mendja, por i thashë se më vonë do të shkruaja një libër për këtë. Ajo m'u përgjigj duke më siguruar se, pa dyshim, shumë njerëz do ta gjenin vërtet interesant një libër të tillë.

Praktikisht bisedës sonë i erdhi fundi. Për t'i sqaruar ca gjërat, unë shtova se përpara se vikingët të lundronin me vela bashkë me gratë në Islandë, atje ndoshta kishin jetuar të tjerë banorë: të ashtuquajturit, *papar-ë*, murgjër irlandezë, të cilët kërkonin paqen dhe qetësinë në ishull, por më pas u dëbuan me gjithë zilkat nga ata minjtë harbutë, vikingët. Në tren ra një heshtje për ca çaste. Unë shpresoja të mos fillonin të më pyesnin për çështjen e referendumit *Icesave*.

Ajo më pyeti nëse doja të dija se si e kishte blerë varësen, për çka në fakt unë po e vrisja mendjen, por nuk kisha guxuar të pyesja. I shoqi ia bëri se ishte një histori e bukur, e cila mund të më interesonte. Dhe isha që ç'ke me të, si gjithçka që lidhej me ishujt Orkni.

Ajo më tha se ish burri i saj e kishte çuar në një port

në Orkni. Punonte si palombar në një rafineri vaji dhe duhej të riparonte një pompë poshtë në det. Pajisjet e oksigjenit ishin prishur dhe ai ishte mbytur. Ajo rrinte në breg dhe e priste të dilte më sipërfaqe. Priste e priste. Kapte varësen prej floriri. Në të ishte një lule dredhë celtike, e cila simbolizonte dashurinë e përjetshme, për shkak të ngjitjes në qiell dhe mesazheve mes tokës dhe parajsës. Po, me fletë pesëkëndëshe si zarfet.

Burri i saj i dytë punon në të njëjtën rafineri naftë dhe thotë se ishujt Orkni, në fakt, janë një vend i zhveshur. Nuk ka asgjë. Mbase do të shkruaj një libër për diçka tjetër. Doja të përmendja debatin mbi konservimin natyror dhe mbi pavarësinë e kombeve ishullorë për respektin që kanë ndaj vetes dhe se si e kanë katandisur veten që shfrytëzohen nga sahanlëpirës të paskrupullt. Por, natyrisht, unë nuk do të merrem me historinë e tyre tragjike. Kur thamë lamtumirë na dolën lot nga sytë.

Treni rendte drejt qytetit, oxhaku i uzinës kollitej me gëzim të vjetruar dhe biblioteka mbyllej për gjysmë ore. Duhet të rendja nëse doja ta bëja atje.

Manchester Festa e Shën Maria Madgalenës

Ndërtesa është groteske dhe kaba, por tepër e bukur. Një kështjellë me një lodër të kuqe, ambicioze me një milion dritare e me xhama gjigandë, me një sallë leximi nëntëkëndëshe dhe një burrë të ditur, i cili shikon nga librat. I them tungjatjeta Sokratit, Shekspirit dhe Njutonit. Kërkoj me sy mos ka ndonjë grua, por në katin e dytë ku ishin dy, s' shoh asnjë; njëra ishte vetë teologjia me flokët e gjatë ndërsa tjetra ishte e veja e njeriut që kishte ndërtuar bibliotekën dhe që i kishte dhuruar tërë librat e vet.

Më vinte zor nga Zogu, i cili ia bënte se për shkak të natyrës sime, unë i kushtoja tepër vëmendje tërë detajeve të vogla atje brenda; për shembull formave të gjetheve të lisit të letra e printuar dhe e ngjitur në mur. Përpara se të mbyllej dera më kishte blerë një unazë plastike të hollit. Dukej shumë mirë me këpucët e reja angleze e me bluzën e bardhë dhe tha që ishte i gëzuar që kishte ndryshuar plan. Gjendej në gjysmë të rrugës për në kontinentin tjetër, kur papritmas vendosi të bënte një kthesë në formë U-je e ta kalonte verën me mua.

Kur më tha se kishte qenë në avion me grupin *Iron Maiden* unë nxora librin nga çanta dhe lexova *Vargje të marinarit të vjetër* të Kolrixhit dhe po, është e vërtetë,

Iron Maiden kanë një këngë me këtë emër. Duhet t'ia tregoj se gjatë udhëtimit tim, e kisha përfytyruar sikur vepronte si Kolrixhi, e cila, nga sa di unë, mund të ketë qenë dashnore e të dyve; mirë, mbase edhe mikeshë, shoqe e mirë, nëse atij i hynte ndonjë çikë në sy.

Mundet që ai ta ketë parë shtëpinë e Davëve dhe shpellën e tyre të vogël e të këndshme. Natyrisht, ne mund të marrim me qira një makinë dhe të shkojmë te gurët kalendar, që janë një rreth gurësh të gjetur pranë Zonës së Liqeneve. Por do ta bëjmë më vonë. Tani po lundrojmë me një varkë me vela për t'u kthyer në fshatin tonë. Na kanë ftuar të rrimë për ca kohë, në periferi të qytetit. Mbase është Hveragerði-ja e Anglisë, përzierja jonë nuk është tepër larg.

Uërsli Mesverë, afrimi i kometës

Para syve nuk na u shfaq asgjë e sajuar, por vetëm gjelbërim i pafund. Dhe miq. Kishin vënë lulet në vazo në një kuti kartoni vetëm për një natë dhe kishin përgatitur shtratin për ne. Përpara darke çaj me biskota dhe rrëfime nga udhëtimet tona. Shtëpia ishte e madhe dhe thuajse me strukturat e vjetra: shumë dhoma e korridore të fshehtë që i lidhnin. Çdo dhomë kishte mobilimin e saj të veçantë; një tryezë e cila hapej në mes kur shtypje një buton, një këmbalkë për librat me dyzet sirtarë të fshehtë dhe një tavolinë e cila mund të kthehej në një shtëpi verimi për të luajtur fëmijët. Shtëpia gjendet në kufi të qytetit dhe fshatit, ndërsa kopshti rrethohet nga pylli. Te lumi që kalon nëpër kopsht është vënë një digë për elektricitet; plehrat riciklohen.

Në kuzhinë ka një stufë me gaz dhe qymyr; unë thuajse nuk e kuptoj këtë dukuri, por sidoqoftë atje bëhet shumë nxehtë, si në një banjë avulli. Djersis i tëri dhe flet për bretkosat në kopsht, të cilat janë më tolerante se ato që ke njohur deri tani dhe për gratë, të cilat dëgjojnë këngët e ditëlindjes së tyre me një intensitet më të lartë nga sa bëjnë zakonisht.

Është gjë shumë e bukur, të provosh këtë lloj bashkekzistence. Këtu jemi shumë pak vetë, por asnjëherë

s'jemi përplasur me njëri-tjetrin. Secili merret me gjërat e veta, sheh punën e tij. Secili dhe të gjithë kanë ritmin e tyre. Asnjëri nuk flet për një organizim të përgjithshëm. Asnjëri nuk vendos norma, por nuk ka mosmarrëveshje.

Në fillim, vrisja mendjen se mos do të na duhej shumë kohë për t'u mësuar me praninë e njëri-tjetrit, pa pasur shumë gjëra për t'u marrë. Nuk ndodhi. Këtu, secili respekton nevojat e tjetrit për intimitet, pa mundim, por me vetëdije. Unë mendoj se shumica jonë janë duke shikuar mundësinë për të gjetur forma të reja komunikimi e secili e bën sipas mënyrë së tij. Të gjithë kemi krijuar një klimë pune në hapësirën përkatëse dhe asnjëri nuk do të parapëlqente të shponte membranat mbrojtëse e të padukshme të të tjerëve. Praktikisht ne takohemi herë pas here dhe në një farë mënyre gjithnjë mbaron me biseda të mira në kuzhinë. Më së shpeshti, bëhet fjalë për një diskutim në lidhje me të ardhmen e bashkëpunimit, mbi besimin dhe dashurinë.

Unë mendoj që sekush, nga ata që jetojnë këtu, duhet të ketë kaluar shumë vite duke u stërvitur në respektimin e hapësirës së të tjerëve; po, mendoj se ne mund të përbëjmë një skuadër kombëtare bashkëjetese. Ejola është veçanërisht e aftë për të dëgjuar ritmin e ditës dhe të akordojë telat. Ajo bëhet njësh me shndërrimet e ditës dhe duket se ndien mirë rrjedhjen e baticave dhe zbaticave, korrentet e nëndheshme dhe bashkërrjedhjen. Respekton natyrën në çdo çast të saj. Unë hap veshët dhe mësoj si të bëhem më e ndjeshme ndaj nuancave të ditës.

Ne jemi të gjithë të interesuar në metodat e punës, në ndërtimin e një hapësire, një bote, një dite.

Këtu vinë edhe shumë mysafirë dhe janë gjithnjë të

mirëseardhur, të ftuar e të paftuar. Dje gatuam të gjithë bashkë dhe bëmë një festë të shkëlqyer. Zogu dhe unë dolëm me fëmijët të blinim tullumbace dhe zbukurime nga më të ndryshmet.

Në darkë, bashkë me Ludvigun që ngjan si mace, bëmë një bisedë të këndshme, për një model të ri ferme: atë të fermës vertikale. Ai e përshkruan si një sistem të gjelbër dritëlëshues, të bazuar në transferimin e fshatit në banesat e qytetit. Nuk jam e sigurt në këtë zgjidhje, e cila më duket si e përkohshme. Mandej, dikush me emrin Mejvant më tha se për të mësuar më tepër mbi arkitekturën, studimet duhet të bazohesh te zgjojet e bletëve. Unë i tregova për fermën në Gröf në Öräfi, për germimet që janë burimet e pakta që flasin për një periudhë të gjatë arkitektonike në Islandë dhe se im vëlla dhe unë mund të jemi një shembull i një sistemi ndërtimor, i cili ia vlen të analizohet. I fola gjithashtu për shtëpinë- furrë në Gröf dhe doli se Mejvanti ishte eksperte për shtëpi të tilla në ishujt Orkni. Më e veçanta në ato shtëpi është se nxehtësia e tepruar nga tharja e furrës kthehet pas dhe qarkullon, në mënyrë që të mos shkojë dëm; energjia riciklohet nëpër tërë nyjet e banimit dhe të fermës duke sjellë më pak shpenzime. Ngrohja ruhet në tërë banesën dhe shkon në tërë mjediset e fermës, duke u përdorur për tharjen e grurit, për ngrohjen e saunës dhe për stallën e lopëve. Ja, i tillë duhet të jetë sistemi i brendshëm i një lidhjeje romantike! brita unë ngadhnjyese. Ky është, tamam ky! Të ndërtosh një intimitet si ngrohtësia në një shtëpi furrë! Ajo e miratoi dhe vizatoi disa piktura të ndërlikuara në një copë letër, të cilën unë e futa në zarf për t'ia dërguar menjëherë Bufit.

Zogu ishte futur në biseda të thella. Së pari me Termin, i cili i shpjegonte modelin më të fundit të gropave septike dhe të kërkimeve të prodhimit të gazit, pastaj me shumë interes dëgjonte Uimbrëllin, i cili kishte një sqep tepër të gjatë dhe nxirrte tinguj të hollë. Ejola më tregoi se si disa miq të saj, kishin shkuar nga Londra në një ishull në Indonezi, ku kishin ndërtuar një shtëpi me materiale të përdorura; bëhej fjalë për një grumbull kasollesh të vogla në një terren të madh, kështu që shtëpia e tyre është edhe jashtë edhe brenda. Shtëpitë janë të hapura dhe madje, me ta rrojnë edhe majmunët. Po, dhe duke vazhduar me materialet e përdorura, më tha se njeh një burrë, të cilin e quan Koshi, pasi jeton në askund dhe udhëton nëpër botë bashkë me familjen e tij, me varka, të cilat i ndërton me duart e tij nga mbeturinat. Fëmijëve ua jep vetë mësimet dhe për familjen përdor hedhjet e shoqërisë së konsumit. Sigurisht, ka edhe nga ata që quhen njerëz të anijeve, të cilët jetojnë gjithë kohës në to. Edhe kjo është një mundësi joshëse.

Më kishte marrë malli për Bufin dhe i nisa një mesazh të gjatë, ku i përmendja tërë këto teorizimet. Edhe që gjendem në një si punë akademie -shtëpi. Se si jetojmë edhe jashtë edhe brenda dhe gjejmë një drejtpeshim në ekzistencë. Ai më ktheu përgjigje dhe më tha se e kishte marrë malli për motrën e dashur dhe më pyeti kur do të kthehesha. Do të nisej me familjen e tij për një udhëtim nëpër gjithë vendin kur do të rrinin në çadra. Shpresoj që të takohemi të gjithë dhe të krijojmë një fermë të re me familjen dhe miqtë dhe të jetojmë të gjithë së bashku. Në një ngrohtësi të hareshme dhe të kujdesshme, ashtu si e përjetova këtu.

Uërsli,
Krasitja dimërore, dita e pemëve të blirit

Këtu fle mirë dhe kam mbledhur disa poezi të vjetra të miat në një libër të ri, duke shkruar gjithë kohën dhe duke kërkuar materiale origjinale duke u dhënë mundësinë që të shkatërrohen matanë detit dhe të shndërrohen në diçka tjetër. Zogu po ashtu ka qenë duke punuar fort, duke përpiluar me saktësinë më të madhe hartat e zogjve në fshat dhe ka shtuar disa tinguj të ri në alfabetin e tij; tani është në gjendje të dallojë aty te pesëdhjetë a njëqind tinguj. Duhet kohë të mësosh gjuhën e zogjve dhe kjo merret me mend. Unë përpiqem t'i dëgjoj me vëmendje tingujt, por shpesh ngatërroj llojet.

Këtë mëngjes dëgjuam lindjen e një tingulli të ri. Një lidhje e re me përmasat.

Ne gëzohemi që ndonjëherë mëngjeseve na vinë për vizitë dy kërrica, të cilët hingëllinjë, qeshin si fëmijë, hanë kokrra dhe na detyrojnë të dalim në oborr për të mbledhur fletë nga dy trungje bliresh, që rriten në një rrënjë. Mandej rendin në pyll, fshihen, zhduken dhe na lenë si bosh e me frikën se do t'u ndodhë gjësend. Nëse do të kishim pasur vetë fëmijë do t'i kishim lejuar të iknin: s'ka kuptim të jesh kaq i stresuar. Nga diku në pyll dëgjuam një harmoni të çuditshme, e cila për një grimë ndalej te secili prej nesh. M'u bë sikur së bashku do të bënim gjithçka që dëshironim të bënim. Ndjeva se si

shpërthente gëzimi.

Vras mendjen e them me vete se kjo shtëpi duhet të jetë ndërtuar vërtet mirë, përderisa unë ndihem kaq rehat me këdo. Pasi gjithnjë mund të gjesh paqe dhe qetësi në kopsht. Por jo, thuajse që të dyja kanë rëndësi: mbarëvajtja e shtëpisë dhe shoqëria, por edhe hapësira intime dhe të ndenjurit më vete. Nuk kërkoj shumë...

Kohët e fundi me dy prej banorëve kemi shkuar mbrëmjeve në një *pub* të vogël fshati, ku kemi ngrënë qull, salsiçe, mëlçi dhe pure patatesh. Kemi folur për jetën dhe për ekzistencën. Por sonte do të jetë një zdërrhallje e vërtetë. E tërë skuadra e shtëpisë së fshatit do të shkojë në një koncert në qytetin e madh. Zoti Derri, dhe vetëm ai merr përsipër të na prishë qetësinë. U kujtova si nëpër të për diçka dhe, sa për siguri, vura syzet e diellit.

Uërsli
Dita e të vobektëve dhe e qenve

Karriget i kishim në vendin më të mirë, nga ku skena dukej për bukuri. Mbeta e stepur nga atmosfera. Ishte kremtimi i përvjetorit të njëzetë të daljes së një albumi të veçantë dhe m'u duk sikur isha njëqind vjeçe. Në të njëjtën kohë, m'u bë sikur ndihesha përjetësisht e re, e pandryshueshme në marrëzinë time, e hapur ndaj jetës dhe haresë. Mos ishte bërë ndonjë gabim në vendosjen e objekteve në skenë? Kishte një stol, njëlloj si te kopshti në Skógar dhe te pemishtja e frutave e vëllait dhe motrës në Uordsuorth, por mendohej, a kështu më duket mua, një stol i fortë në mbulesën e një qyteti të madh.

Qeni endacak rrinte ulur në një stol pishe të hollë sipër një shtroje në dhjetë gradë, kruante topet dhe i pyeste të gjithë në po ia kalonin mirë. Ishte si një shpërthim. U dha urdhër të gjithëve: *ngrini lart drejt qiellit ato duar të ndyra!* Për fat të keq, kam mbetur ende e goditur në kokë. Duhet të bëj një operacion që ta heq, pasi goditja ishte tepër e madhe.

Në taksi, rrugës për në shtëpi, i sugjerova Zogut se si mund t'i përkthejmë në islandisht vargjet e Snoop-it, reperit dhe ai më pyeti nëse stil qeni mund të përktheja "*maniera qensh*". I befasuar, më pyeti nëse e dija apo jo ç'do të thoshte "*stil qeni*". Oh, nuk do të thotë ashtu

si janë qentë? e pyeta unë. Jo, në përgjithësi, kjo do të thotë të bësh seks në pozicionin nga pas. Ah, këtë e kisha harruar krejtësisht. Nuk ka ndonjë fjalë irlandisht, origjinale? Shaka. Ai më sugjeroi që Snoop-in, ta thërrisja “Snati”, çka m’u duk madhështore. Atëherë ia filloi me vargun e parë, i cili më kujton shumë Baladat lirike të Uilliamit të dashur, të gjata dhe me ritme vdekjeje: *Gjithë ju të pastrehë pranë nesh dhe këtë mund të mos e përgënjeshtrojmë: ne s’mund t’i lemë vëllezërit tanë të pastrehë që t’u duket sikur po u vdes shpirti. Kështu, mos e rruaj fare për ato që ke, as mos e provo- ngriji ato duar të ndyra lart drejt qiellit.*

**Cili Xhejms? Ai që kam pasur në klasë shkollën
fillore në Istsajd? Ku është tani? Mund të jetë edhe
Shën Xhejmsi, një pelegrin, që mbante një guaskë në
xhep për të pirë ujë gjatë rrugës**

Në një farë pike s'po orientohesha dot në Londër. Tani jetojmë në një varkë mbi kanal, ku mund të shohësh qytetin nga poshtë e në kënde nga më të ndryshmit. Prej këtu kam mundësinë të hyj në të.

Ngjitur me varkën tonë është një teatër kukullash; shkova të shihja Kësulëkuqen dhe ujkun, por u ndjeva ligisht nga lëkundjet dhe u largova përpara se të mbaronte.

Shkova në spital, pasi ishte operuar babai. Mjekët i kishin thënë se duhet të ndryshonte ritmin; duhet të çlodhej, zemra nuk ia mbante dot ngarkesën. Por ai i kishte thënë gjyshes se do të vazhdonte njëlloj si më parë, deri sa të vdiste në vend. Dhe kështu bëri. Prej shumë vitesh ishte përpjekur të shpëtonte vendin, kishte ndërtuar shumë shtëpi dhe ferma, kishte dhënë mësim, kishte botuar libra, kishte mbajtur leksione pafund, ishte përpjekur të eksportonte prodhime industriale islandeze dhe kishte bërë shumë fëmijë. Ama, i kishte mbetur diçka pa bërë. Ai ishte vizionar, përfytyronte një shoqëri të re,

një shoqëri të qëndrueshme, por ishte ca si tepër para bashkëkohësve. I gjori burrë dhe nuk donte t'ia dinte sa shpejt rendte dhe kështu nuk mundej ta shndërronte dot në të ardhme.

Gjyshja erdhi në Angli me heroin e saj, u vendos në një pension larg spitalit, por shkante në mëngjes e rrinte gjithë ditën. Herë pas here, hidhte në ditar përshkrime për njerëzit dhe reflektime mbi vendin.

Një ditë, me t'u kthyer në shtëpi nga spitali, kishte rendur drejt e te numërori i telefonit, ku kishte gjetur mbiemrin e një burri, që jetonte në veri e, që ajo e kishte dashuruar në të ri të saj, në kohën kur sapo kishte mbaruar studimet dhe përpara se të martohej. Në atë kohë ai ishte ende shkollar, por në Islandë kishte shkuar si ushtar. Në një farë mënyre arrij ta marr me mend se gjyshja, as më parë e, as më pas, nuk kishte njohur ndonjë burrë që të vlerësonte si ai humorin, talentin dhe origjinalitetin e saj. Nga sa kuptoj, ishin takuar në një dhomë, te cilën ajo e kishte marrë me qira pasi ishte larguar nga shtëpia për të ndjekur gjimnazin.

Ai duhej të flinte në repart e të bënte luftë të vërtetë. I vetmi lajm që kishte marrë prej tij, kishte qenë nga i ati. Ca kohë më pas ky i shkruante gjyshes dhe e pyeste nëse dinte gjë për të birin e tij. Jo, asgjë.

Kur gjyshja i kishte telefonuar, doreza ishte ulur përnjëherë.

M'u duk se e pashë në një dyqan antikuaresh, ku shisnin libra të lidhur shumë bukur, sipër kukullave të teatrit dhe ca lodrave britanike. Isha duke shfletuar një libër me vizatime të Beatriks Poterit, kur një burrë i gjatë, i hollë dhe i sjellshëm, me një pallto leshi në ngjyrë të

hollë dhe një kapele të pazakontë zotërinjsh, më tërhoqi pak bishtalecin e vogël. Më kërkoi menjëherë të falur për bezdinë, por donte thjesht të më thoshte se në ç'ngjyrë të mrekullueshme i kisha flokët; ç'loj genesh kam, nëse mund të pyes?- si një përzierje rrushi të kuq dhe të përhimë.

I thashë se të kuqen e kisha nga gjyshja dhe njëkohësisht emnakja ime, pasi më kishin vënë emrin e saj. Ajo kishte flokë të kuq të ndezur, të thurur gërshet dhe me veshjet e pajisjet e patinazhit ngjante shumë e bukur ...M'u duk sikur ai do ta dallonte imazhin; po nuk ju kujtohet xhaketa e saj e vogël prej lëkure dhe se sa lirshëm rrëshqiste mbi akull? Po sikur të ishte ai, dora vetë, i dashuri i gjyshes, dashuria e saj e parë?! Gjatë bisedës, arrita t'i thoja se isha nga Islanda, por ai as edhe njëherë nuk pohoi që kishte qenë; as që kishte shkuar më tej në veri në ishujt Orkni.

Dje, megjithatë, dashuria ime e madhe dhe tragjike më telefoni krejt papritur dhe shkova ta takoja; në kafenenë e kanalit, domethënë te varka me lule dredhka. Shërbenin strudel me kanelle. Kishte bërë shumë fëmijë dhe ai kishte kaluar të atit. Nuk folëm fare për marrëdhënien tonë, por na erdhën në mendje disa imazhe tona të njëzet vjetëve më parë.

Ai po kthehej nga një koncert në Mançester me mendjen krejt të humbur dhe më tha se i ishte bërë mishi kokrra-kokrra, kur ishte shfaqur pamja e një vije të sheshtë kufiri tektonik në Þingvellir; ai që urrente nacionalizmin dhe patriotizmin. Þingvellir-i është simbol i përplasjes midis forcave të ndryshme të natyrës dhe demokracisë. Mua m'u kujtua debati që kishim pasur

në ujëvarën e Goðafoss-it një vit më parë, ku unë isha përpjekur të shpëtoja dashurinë për natyrën nga kthetrat e nacionalizmit. Më kujtohet se debatuaam gjithë rrugës me Volgsvagenin e vogël të gjyshes së tij. Po përpiqesha të bëja një dallim të qartë ndërmjet nacionalizmit nga njëra anë dhe patriotizmit nga ana tjetër. Por, ai më tha se gjithçka përfundonte përherë po aty: në dhunë kundër të huajve dhe atyre që kategorizohen si bijtë e atdheut. Dhe tani, njëzet vjet më pas, gjendemi sërish përpara të njëjtit kërcënim. Unë i thashë se kishte plotësisht të drejtë; dallimi ndërmjet nacionalizmit dhe patriotizmit nuk ishte shumë i qartë. Kështu që dola me një alternativë të re, duke m'u dashur njëzet vjet të gjeja termat e duhur: *terramaterism*, që do të thotë, dashuri apo kujdes për tokën mëmë. M'u duk disi e bukur-ndonëse mundet që të mos jetë tepër e kontrollueshme. Thua të më duhen njëzet vjet të tjerë për të gjetur një term më të mirë?

Kafeja ishte tepër e fortë dhe strudeli me kanellë tepër i përdredhur. U ngazëllyem që të dy për faktin se kishim krijuar më tepër besim te dashuria jonë. Ai s'e shtronte kështu; nuk e zuri me gojë dashurinë. As mënyrën se si e kishim mbytur besimin mes nesh me kalimin e kohës. Në atë kohë unë nuk haja dot, nuk ecja dot dhe absolutisht nuk i bija dot pianos; pas kësaj nuk mora më as mësim. Dëgjoni pareshtur Joy Division-in, por nuk na vlejti për gjë; thjesht nuk lidheshim dot, nuk kishim besim te vetja se mund ta bënim këtë.

Por për këtë nuk folëm. U morëm me dashurinë në kontekstin e saj më të gjerë: dashuria për jetën.

Për këtë bisedë, si edhe për termat e ri që kisha gjetur, i tregova dhe Zogut; mendonim se dallimi i ri

do ta kthjellonte marrëdhënien tonë me tokën mëmë në të ardhmen. Diskutuam mbarë e prapë dhe arritëm në përfundimin se tipari që e bën të dallueshme një dashuri të pjekur është kuptimi i së tërës ndaj impaktit të përgjithshëm të çdo veprimi.

Isha kacavjerrë në krevatin prej marinari në kabinë, por më hante vendi, pasi doja të ulesha poshtë e të hidhja idetë në letër M'u kujtua koncepti i vjetër që është ende në zbatim dhe mendova se terramaterism do të ishte: mëmëdheu dhe dashuria për mëmëdheun. Krahaso: *Të qeta dhe të ngrohtë, erërat e jugut zënë e fryjnë...*

Është mirë ta zëvendësosh idenë e “dashurisë për vendlindjen” me “dashurinë për mëmëdheun”, për ta pasur më të qartë marrëdhënien tënde me vendin, me të cilin je lidhur me kërthizë. Por, a nuk do të vazhdojnë të të konsiderojnë si nacionalist nëse thua se qytetarët e një vendi duhet të jenë të përgjegjshëm për mëmëdheun dhe për burimet e tij natyrore? Në rast të tillë, kjo shkon më tej se sa thjesht kujdesi për vendlindjen. Apo qysh? Praktikisht, unë mendoj se kujdesi për nënën, edhe njerë sikur të jetë, duhet të jetë i njëjtë nga ana e tërë djemve dhe vajzave të saj, pavarësisht në kanë a jo lidhje gjaku.

Mundet që së shpejti të sajojmë një formë të re korporate. Deri tani, korporatat nuk janë bazuar në përgjegjësi kolektive. Ato bazohen në përgjegjësinë individuale. Në një korporatë, sekush mendon për aksionet e veta dhe asnjëri nuk do t'ia dijë për të tërën. Ndërkohë që ne akoma nuk kemi arritur në një rrugë të përshtatshme për të ngritur korporata që të marrin parasysh interesin e natyrës dhe atë publik, ndërkohë që

aksionerët shkojnë përtej kufijve të drejtësisë, në vendin tonë ne nuk kemi shumë besim te individët me aksione të mëdha. Për fat të keq, siç na tregon përvoja, nuk kemi as te qeveria, por me gjasa mund të gjejmë një rrugë të re për të lidhur natyrën me drejtësinë. Të krijojmë një formë të re kolektiviteti, një formë të re të ndarjes së përgjegjësisë.

Mos e kam gjë pikësëpari për lundrimin me vela? Apo për udhëtimet në përgjithësi? Në fakt, po lexoja këto fjalë të Uggi-t në *Anije në qiell*: këtu më shtyri të mendoja të mos pasurit e një shtëpie nga ana ime . Ai që mendon nuk është më i lidhur me një zonë të caktuar, me tokën, apo me kongregacionet. Ai është një person i huaj. Është krejt vetëm. Është i lirë si një zog.

Po mendoj për besnikërinë. A nuk është besnikëria për atdheun që të ka birësuar ndryshe nga ajo për atdheun ku ke lindur? Besnikëria ndaj demokracisë dhe drejtësisë a është e ndryshme nga ajo për një grup apo për një familje? Unë nuk mendoj për besnikërinë thjesht për hir të besnikërisë, siç pretendojnë hot dogs-at SS me djersë dhe të kënaqur me veten. Besnikëria, në fund të fundit është tepër e përqendruar te vetja; është besnikëri për ëndrrat e njërit, të palidhura me ato të të tjerëve. Nga ana tjetër, mua më duket se besnikëria ndaj mëmëdheut nuk mund të ndahet nga lidhja me tërësinë e gjërave.

Londër,
Festa e psikanalizës,
Dielli bashkohet me Plutonin, Gay Pride

Më në fund shkova në muzeumin e Frojdit, pasi m'dhashë e mora shumë kohë për të shkuar. Atë mëngjes kur u ulëm dhe u përpoqëm të bënim planin e ditës, papritur, Zogu bëri një arsyetim i turbullt

Në sheshin brenda shtëpisë ndodhej një serrë e vogël lulesh, disa karrige të lehta dhe një tavolinë e ngushtë me një fjalor enciklopedik të hapur në një faqe ku ishte vizatuar një orkide. M'u kujtua koha kur më kishte pushtuar pasioni për orkidetë dhe mbaja ngaherë një të zezë, e cila në zbehtësinë e apartamentit tim në Paris, do të vyshkej shumë shpejt. Në katin sipër është dhoma e gjumit e Anës, e bija e babait, si edhe një foto e tij sipër shtratit! Poshtë syve të vëmendshëm të të atit, ajo përftonte përvoja të rëndësishme në fushën e psikanalizës, por kishte ndjesinë se psikanalizohej edhe nga njerëz të tjerë veç tij, mes të tjerave nga një mik i përbashkët i saj dhe i të atit, Lu Andreas-Salomeit; në të dyja katet ndodhet nga një foto e saj. Poshtë, në zyrën e madhe të baba ujkut, në dy dhomat pranë, të mirëpret fillimisht Gradiva, “ajo e cila ecën”. Një shkumës i zi ka vizatuar dy gra me fëmijë, mbase lezbike të dashuruara me fëmijë të vetëm.

Nëpër rafte shikon vëllime me lëkurë gjarpri të Mari Bonapartesit; arrij të lexoj vetëm fjalët në njërin krah:

Printemps sur mon... Ajo kishte luftuar kundër dënimit me vdekje dhe kishte shpëtuar duzina hebrenjsh nga kthetrat e nazistëve duke i korrptuar, kështu që Frojdi arriti të dilte gjallë nga Vjena. Fillimisht ajo përkthente në frëngjisht punimet e tij dhe me të u njoh pikërisht këtu. Si pioniere e psikanalizës, kishte rrethprerë veten, kishte hequr klitorin, në kuadrin e përpjekjeve ndër vite për të arritur orgazmën. Një tryezë gjashtëkëndëshe me qiri dhe me kujtimet e ëndrrave të trazuara mbi fëmijën që ishte djegur. Tavolina e mbuluar me statuja të vogla si kujtim se prej nga vinë standardet e mendimeve dhe ëndrrave tona. Ja ku është *Osirisi* im prej bronzi, ndërsa pak më tutje, e motra, *Irisi*, ende në kërkim të penisit të tij; s' dëgjon të heqë dorë, e gjora. Djali i atyre të dyve, vëlla e motër, është hyu hermafrodit i hapësirës ndërmjet botëve. Edhe *Bes-i*, xhuxhmaxhuxhi me lëkurë ngjyrë bakri, shakaxhiu kryelartë, mbrojtësi i familjeve, humorit, seksit dhe kërcimit. Duhet të marr vërtet një statujë të vogël *Bes-i* me penis në ereksion për shtëpinë e re, nëse do ta kem ndonjë ditë.

Statuja të vogla që kërcëjnë njëlloj si ato që janë gjetur në varret e qytet-shteteve greke të Tanagras, të grave të shëndosha dhe shumë të bukura të mbështjella me lule dredhka dhe instrumente muzikorë. Një mami'-krokodil e pahijshme dhe një palcë kurrizore e vizatuar në plumb. Hathori dhe Athina me bufin e saj; gjatë arratisë prej nazizmit ai i përmendi. Ata zgjasin një dorë mbrojtëse drejt nesh, i shkruante të shoqes, me të cilën mbante letërkëmbim në pjesën më të madhe të kohës. Ato fjalët m'i ndjenë më tepër thembrat e këmbëve sepse të gjitha arkivat gjenden poshtë në bodrum, por nuk m'u

dha mundësia të shkoja; duhet të regjistrohesha kohë më parë.

Doja të shtrihesha në shtrat; perdet prej kadifeje të kuqe më kujtonin dhomën e ndenjes në shtëpi kur isha e vogël. Edhe ulëset e shpuara të karrigeve prej druri. Përfytyro se sa mirë i kishte rregulluar tërë këto; çdo libër e çdo objekt e kishin vënë në vendin e tyre; një vit më vonë vdiqën. Kjo bën që, në një farë mënyre, ajo shtëpi të jetë edhe mauzoleumi i tij- madje, unë ndiej edhe ndërgjegjen e tij; ai i sëmurë, shkroi edhe në murin e varrit të vet.

**Londër,
Puckmas, hënë e plotë**

Dyqani i vogël në muzeumin e Frojdit ishte si një ankth. Atje kishte disa libra në lidhje me mjeshtrin e të bijën, si edhe letra bixhozi të punuara vetë, vetëm se gjithandej ishte mbushur me riprodhime pa shije, me filxhanë dhe pantofla, sikur po të prekje me gishta imazhet e atij burri te nderuar çliroheshe ndonjë gjë! Nuk e kuptoj dot këtë impuls pervers. Zogu ishte fund e krye i dërmuar dhe tha se, për sa i përkiste atij, një muzeum i tillë nuk duhet të ketë nevojë kaq të dëshpëruar për të shitur sende e nuk duhet të bjerë në rëndomtësinë e klientëve. Megjithëkëtë, unë vendosa të blija një kartolinë dhe të prisja gjatë në radhë.

Përballë më qëndronin një burrë me flokë kaçurrela, i mbytur në djersë, me një bluzë gri dhe një grua te regjistri po ashtu me flokë kaçurrela. Burri i tha se ishte artist dhe se praktikisht merrej me qeramikë. Oh, çfarë punimesh bëni? e pyeti ajo, ndoshta më shumë për mirësjellje se sa nga interesimi, ndonëse nuk e kuptoja dot mirë. Të paktën, gruaja nuk priti ndonjë përgjigje tepër të detajuar. Ai i tha se ishte e ndërlikuar ta shpjegonte, por disa nga punimet e tij vareshin në masa dheu dhe u përpoq t'i përshkruante format. Prita sa gjeti fjalët për këtë art tijn, në fillim me padurim e duke fërkuar gjuhën pas dhëmbëve, por mandej e mblodha veten dhe acarimi kaloi në simpati.

Mundet që Kaçurrelsi dhe unë të jemi ende në të njëjtën fazë anale të zhvillimit psikik.

Kur mbërrita së pari në Paris dhe më duhej të kërkoja për shtëpi në një zyrë të veçantë që nuk po e gjeja dot, u praktikova disa herë për ato që do i thoja nëpunëses derisa më në fund e gjeta destinacionin. Isha shumë e emocionuar si t' i shpjegoja çfarë doja dhe kisha përgatitur tekstin, e kisha mësuar përmendësh dhe ia shqiptova edhe një burri, i cili më pyeti nëse mund të më ndihmonte. Shkoja lart e poshtë nëpër korridorin e madh, ndërkohë që pastruesi dëgjonte bisedën time pa lidhje dhe në fund, më buzëqeshi me mirësi, më tha se kjo ishte vërtet interesante dhe se personi me të cilin unë doja të bisedoja ishte në anën tjetër të derës. Më përshëndeti me dorë, më uroi për kërkimin interesant dhe vazhdoi të fshinte.

Është tepër e sikletshme të mendosh se dikush interesohet për atë që ti mendon. Dhe në këtë drejtim është e pabesueshme se si botohen autobiografitë. E kujt i bëhet vonë për historitë e tua? Mbrëmë bleva një libër të vogël të Torosë në një dyqan. Kishte edhe një parathënie. Dua të pyes këtu lexuesit se cili ka interes të veçantë të më falë nëse në këtë libër marr përsipër t' u përgjigjem disa prej pyetjeve. Ai e kishte shkruar librin për t'iu përgjigjur pyetjeve, të cilat i bënte shpesh kur jetonte vetëm, krejt larg nga përpjekja për të mbajtur veten me punën e duarve të tij: a nuk je vetëm e i frikësuar, si mund ta bësh këtë gjë?

Më pëlqeu shumë ta lexoja atë libër të tij. Dhe tani po shfletoj një ese, të cilën e gjeta në dyqanin e Frojdit. Atje lexova që *Sibeli*, perëndia e shpellave, e cila në fakt, ishte e mbështjellë me lule dredhka, dashuronte *Atisin*; atë, që

ishte lindur nga një bajame dhe strehohej te një cjad, të cilit i kishin prerë gjenitalet. Sepse ai e dëgjonte shumë mirë *Sibelin*. Tingulli i zërit të saj i shëronte plagët mes kofshëve. Mandej, flet për Persefonin, e ndërthurur me një hardhi e gjelbër e me një shegë në njëren dorë, ndërsa me tjetër mbante dorën e *Demetrës*, nënës së saj. Ky çift, nënë-bijë, e ripërtërinte vazhdimisht marrëdhënien mes tyre. Vajza vdiste pa pushim dhe gjente rrugën për te *Hadesi* në ferr dhe atje banonte për një stinë të tërë. Atje e kalonte kohën duke u kujdesur për shpirtin, duke mbështjellë me fasha kokën e të vdekurit të sapoardhur, por mandej, kapej sërish te hardhia, kthehej në shtëpi dhe ia tregonte përvojat së ëmës, e cila gjithmonë i donte ato histori, pasi veshët e sa janë vetë toka.

Londër,

Fundi i Ditëve të qenit, fillimi i menstruacioneve

Sot vizitua libraritë. Së pari i thamë tungjatjeta Një ferrëgjati grindavec, që ngrinte feçkën si me dyshim. U humbën nëpër dyqanin e madh, derisa më në fund dolëm nga vorbulla dhe hoqëm dorë së kërkuari. Mu kur po dilnim e po vinim këmbën në trotuar, ai erdhi si i shqetësuar dhe më pyeti përse nuk kisha shkuar te tregu i rafteve B; unë s'kisha nga ta dija që ai do të shkonte drejt e te B-ja, pasi askush s'më kishte thënë asgjë. I kërkova falje dhe i qesha, duke i thënë se nuk e dija se ai po kërkonte vetëm librat e Tomas Bernardit.

Mbaruam shpejt. Shkuam në një kafene dhe i treguam njëri-tjetrit librat që kishim blerë. Unë bleva edhe dy vëllime të tjerë të Ruskinit. Nuk e kuptoj se si, por gjatë gjithë periudhës së studimeve, kisha qenë tepër e dhënë pas këtij autori. Një burrë, me të cilin kisha biseduar në në Uorsli, më kishte se profesori i tij në Oksford kishte qenë i fiksuar pas Ruskinit dhe ideve të tij, njëlloj si ai vishej me rroba kadifeje, fliste në të njëjtën mënyrë siç shkruante ai dhe bënte po ato gjeste e maniera. Ndoshta edhe unë do kisha vepruar po ashtu, sikur mos kisha lexuar se Ruskini, me shumë gjasa, kishte qenë pedofil.

Mesa duket, një përqindje e madhe e pedofilëve janë edhe vetë të abuzuar dhe zhvillimi i tyre estetik dhe emocional ndalon në moshën kur kanë humbur lirinë e

tyre. Ata përpiqen ta rifitojnë këtë liri duke ua marrë të tjerëve, që kanë po atë moshë kur ata humbën tyren. A është logjike?

Sonte zgjova Zogun dhe e pyeta nëse ishte pedofil, në se kishin abuzuar ndonjëherë me të. Ai nuk ma mori për keq, por më hodhi shallin e vet të leshtë mbi supe e më tha të përpiqesha të flija; jo, nuk ishte pedofil, me të nuk kishin abuzuar. Nuk kërkoi të dinte as përse ia bëra atë pyetje. Është tolerant; më tha se i dukej që isha kredhur ca si shumë thellë në librat që po lexoja në atë periudhë. Çfarëdo qoftë.

Rejkjavik

Festa e prerjes së kokës së Shën Johan Pagëzorit.

Batica e pranverës, shi i lehtë

Qyteti ka një gjelbërim të pazakontë. Një shëmtim dhe një plogështi e lezetshme përhapen gjithandej. Jo qytet i planifikuar olistik. Ku është qyteza e Guðjón Samúelsson-it? Brenda meje ka një kontradiktë të fortë: nga njëra anë, preferoj që gjithçka te shtëpitë e fshatit duhet të jetë në të bardhë të errur e me çati të kuqe; një çati në një ngjyrë të shëmtuar, praktikisht më bën të ndihem keq fizikisht. Kur ngjyrat e kishës, e verdhë krem, e kaltër dhe e kuqe gjak, kombinohen jo si duhet, zemërohem. Nga ana tjetër, jam kundër të tilla centralizimeve estetike dhe sistemike. Më duket sikur brenda meje gjenden dy inspektorë ndërtesash në detyrë, në të njëjtën kohë e secili me planin e vet.

Shkova te gjyshja në dhomën e saj të vogël. U gëzua pa masë nga pelegrinazhi që po planifikonim të bënim ditët e ardhshme. Më pyeti nëse do të vinte edhe Bufi. Po, kështu shpresonim, por më për më është i zënë me punë. I kërkova të më tregonte edhe një herë në lidhje me fëmijërinë e saj. Më përshkroi papafingon ku shpuplonin thëllëzat, më tregoi se si dilnin jashtë dhe rrokulliseshin në dëborë mbuluar me puplat e tyre. Pak më pas u bë lëmsh. Kohët e fundit i kishin diagnostikuar të ashtuquajturin turbullim të natës, çka do të thoshte humbje e ndjesisë

së kohës. S'arrinte të dallonte në ishte ditë a natë dhe as çfarë stine. S'ka rëndësi se sa sahatë më vendos ime bijë sipër komodinës, unë s'e kuptoj kur duhet të ngrihem, më tha duke qeshur. Në përgjithësi jam mësuar që jetën ta formësoj dhe ta shpie në drejtimin e duhur. Të di ku gjendem, ç'vendi i përkas. Rashë në një mendje me të: ne adashët ishim në të njëjtin vend apo në të njëjtin mosvend.

I solla të përkthyer në islandisht librin *Rropama e zileve* të Sylvia Platit. E paralajmërova duke i thënë se me gjasa nuk do ta duronte dot, por ajo më tha se po fluturonte që do të lexonte këtë autore. E lashë lakuriq me kapakun e librit mbi komodinë bashkë me të gjitha orët sipër. U puthëm dhe i thashë mirupafshim.

Në korridor, duke dalë, takova një malësor të vjetër, i cili më qortoi . Ky, sillej nëpër Hólssandur i ndihmuar nga era që i frynte pas dhe u habit shumë kur pa gjelbërimin nëpër pemë në fjordin e Öxarfjörður-it. Ai njeri s'kishte parë kurrë pemë me sy, përveç një bredhi të vogël me gunga, që në male s'para rritej shumë. Pastaj më foli për Ravenën dhe për një mozaik atje. Edhe për një ëndërr. Ishte nisur për në veri, në Fjöll, më pas kishte marrë për në Haugur drejt Vopnafjörður-it, por kishte përfunduar në Ravena! Tani i tregonte familjes së vet që nëse nuk mund të udhëtonin jashtë vendit për shkak të krizës ekonomike, mjaft të shkonin në Vopnafjörður. Ai vetë është prej andej. Unë i thashë se edhe emnakja ime ishte po prej asaj zone. Shpresoj t'u ngjisë e të puqen. Në atë shtëpi nuk ka shumë veprimtari dhe as mundësi për t'i ardhur rrotull një gruaje. Duket sikur s'ka vend për flirtim.

Pingeyrar Maresmas, verë e vonët

Shpejt do të përfundojnë ditët e shpërnguljeve. Festa e kryqit mos po mbaron gjë? Edhe ndarja e dhenve. Babai, ka për borxh që çdo ditë ta lidhë me kontekstin e botës apo të historisë së vendit: sot është shtatë gusht, dita kur morëm traktorin e parë. Po në këtë datë El Salvadori fitoi pavarësinë.

Sidoqoftë, ne duhet të fillojmë të shohim për një vend ku të kalojmë dimrin. Arkat me libra po presin dhe janë të zhuritura të dalin. Biseduam në lidhje me këtë dhe jemi në një mendje se tani që kemi vendosur të jetojmë së bashku, do të jetë më mirë të krijojmë një shtëpi të pastër. Jemi duke parë për tokën tonë dhe po shkojmë të bëjmë një udhëtim të shkurtër nëpër vend që të shohim çfarë gjejmë. Edhe pse do të jetë një udhëtim i shkurtër mund të mendojmë për ndërtimin e shtëpisë sonë të ardhme, për shembull, një shtëpie-furrë diku në shqipishtë.

I sugjerova të shkojmë të vizitojmë vendet ku kanë jetuar stërgjyshërit dhe stërgjyshet e mia, si në një lloj pelegrinazhi. Vitin e kaluar shkuam të kërkonim fantazmat e familjes së tij. Ai u tregua i gatshëm dhe tha se unë duhet të isha kallauzja e atij udhëtimi, por mua nuk më dukej se isha e aftë ta ndiqja si duhej programin. Kryesorja ishte ta përdornim atë udhëtim për të mbledhur elementet nga toka e për t'i përzier me dëshirën tonë për

një bashkëjetesë më të mirë. Vendosa të bëja një listë me çfarë kishim pro dhe kundra në pemën familjare: çfarë duhet të shmangnim dhe çfarë duhej të merrnim si model.

Dhe ja ku e gjetëm veten në Pingeyrar, ku kishin jetuar disa nga stërgjyshit e mi; nuk më kujtohet tamam cilët. Tre pela ngjyrë shegë dolën të na takonin dhe pastaj vazhduam me makinë drejt një manastiri të braktisur shumë kohë më parë. Mu atje te rripi i rërës ku ishte ndërtuar manastiri, zura të mendoja për konvergjenat, duke përfytyruar peshqit që ndiqnin rrymën nga ishujt britanikë dhe nga Europa e që përmenden në sagat e mbretërve dhe shenjtorëve të krijuara në shekujt trembëdhjetë dhe katërbëdhjetë, në këtë vend.

Doja të ndaloja për gjatë, t'i hidhja një vështrim gurit të kishës me mijëra yje në tavan dhe mijëra xhama në dritare, por nuk m'u kujtua ndonjë veçanti. Shpesh, kur shkon të vizitosh më në fund një vend që ke dashur ta vizitosh, harron se çka të ka shtyrë për të pasur këtë dëshirë. Por ajo të rikthehet shpejt. Kisha ishte më e brishtë se sa dukej në largësi dhe vendosej në sektorë më të vegjël sa nuk gjeje dot një vend në zemër deri sa largoheshe sërish. Në prapavështrim. Në këtë kishë janë bërë zotime ndaj Shën Nikollait, në përkushtim të të cilit është ndërtuar- fëmija -dashuria- Santa i mirësjellshëm.

Do të më pëlqente vërtet të thoja disa lutje në këtë kishë, por ishte aq e mbushur me turistë sa vinte shumë pak era shenjtëri. Vendi i teatrit me kukulla rrëzë murit të jashtëm, ofronte një mundësi për lutje. I kishte shpëtuar shkatërrimit gjatë Reformës, kryesisht për mungesë fondesh, por kuptohej qartazi se klerikët nuk donin ta shkatërronin atë skulpturë prej alabastre, tek e

cila drejtonin dëshirat e tyre, atë platformë të bukur të ëndrrave të tyre.

Në hajat gjendet një gur i madh varri, ku është gdhendur një kafkë me krahë dhe me tri plagë nga një majë shtize, qysh nga koha kur njerëzit aspironin cirkun e gjykimit. Është e pabesueshme si nuk është kryer asnjë përpjekje për gërmime arkeologjike. Është vërtet e pakuptueshme. Manastiri ka qenë një qendër e madhe dhe e rëndësishme e veprimtarisë letrare, ku përktheheshin dhe shkruheshin vepra origjinale. Sot është një vend pelegrinazhi për ata që janë të dhënë pas leximit! Por këtu s'gjen dot as edhe një libër të vetëm. Turizmi është çuditërisht i kufizuar.

I kërkova tipit që po na tregonte kishën, nëse i njihje njerëzit te ferma ngjitur, që nga periudha kur kishte ardhur gjyshja ime, bashkë me emrin Oddny. Një herë më thanë një histori të turpshme; një mallkim për shtëpinë dhe familjen. Dhe kur u kacavora te gardhi i fermës për të vizituar varrin e familjes, të quajtur Varri i Oddny-ve, me gëmusha të kuqe si rrush stafidhe dhe vadhë, përftova një rrymë elektrike në thithkë, sa mendja më shkoi përnjëherë te ai turp. Jo, ai tipi nuk e kishte dëgjuar këtë histori.

M'u duk me vend të kisha ndjesinë e krenarisë familjare apo sido që të quhej dhe për herë të parë të ndieja nderin e familjes të lënduar nga disa histori të shpëlara në lidhje me shpërfilljen e vendeve, madje edhe me papërgjegjshmërinë dhe harbutërinë kundrejt vizitorëve. A kishte vdekur njeri te pragu i derës? Jo, ai s'kishte dëgjuar askënd të kishte bërë diçka të tillë. Pyeta dikë tjetër. Është vërtet e çuditshme të të shqetësojë diçka e tillë, por ja ç'të bëjnë vitet që kalojnë. Isha pafundësisht e lehtësuar kur djali tha se kishte dëgjuar se katragjyshja

ime kishte patur një histori dashurie, e gjora grua.

Ka shumë mundësi që flokët e kuq t'i kem prej këtij vendi. Më kujton të kuqen e manaferrave, lumin dhe plazhin kur hidheshin mesazhe brenda nëpër shishe. Ishte mirë gjithashtu të kujtoje edhe shkarkimin elektrik, si një kujtesë për përrulësinë dhe mikpritjen e vërtetë, nëse do të zbuloja ndonjë gjurmë të arrogancës së prijësve, pasi pjesa më e madhe e të parëve të mi në këtë zonë kanë qenë derë e madhe. Teksa ecja nëpër fushat me bar të thatë më vinte keq dhe mallkoja gjendjen ku ishin katandisur zonat rurale. Ku është shpirti, vetëmjaftueshmëria, mikpritja, guximi dhe sjelljet e pavarura por të përunjura?

Me thënë të drejtën nuk kam dëshirë të kthehem pas në ditët e arta. Nëse dikush ka qenë i pari i vendit, me siguri e ka bërë në kurriz të të tjerëve; padrejtësia dhe pabarazia ishin dhe janë tepër të ngulitura. Por unë do të parapëlqejja që më e mira nga e kaluara e të parëve, një qëndrim i caktuar kundrejt fshatit dhe mosindustrializimit, të shpjerë në një zhvillim ndryshe, në mënyrë që të mund të merren majat e fijeve pa i shkukur me gjithë rrënjë.

Në vend që të kthejnë gjithçka në ferma të mëdha, që të shtojnë stallat e bagëtive duke shtuar borxhet e duke i detyruar njerëzit që të zënë punë me kohë të pjesshme si shoferë kamioni, ne mund t'u jepnim mundësinë më shumë personave që të kishin tokën e tyre, sado e vogël dhe kësisoj të ishin të vetëmjaftueshëm dhe të kënaqur. Më mirë kështu, se sa të rrafshonim gjithçka me ekskavatorë. Mund të bënim një tjetër qendër turistike. Një koçek gruri, për shembull, mund të kthehej në një qendër kërkimore, e cila veprimtaritë e saj i bazon në artet e vjetra. Lutje dhe punë. *Ora e labora*. Është e mundur të punohet edhe me

të tjerë mjete përveç ekskavatorëve.

Më parë, ne përpiqeshim të gjenim rrethin e gjykimit, por pa sukses. Zogu im i dashur ka dalë nga makina dhe bisedon me të atin në telefon. Unë bëj më mirë të iki, po shpenzoj shumë kohë duke marrë informacion; po prodhimi më i madh i librave në Islandë, është bërë pikërisht këtu. Po ashtu edhe përkujdesja për njerëzit e sëmurë dhe të varfër. Një sanatorium dhe një qendër letrare në të njëjtin vend!

Më ra ndërmend të gjeja librin Profecia e Merlinit, në Bretasögur dhe kur shkova në qytet e lexova. Një tabelë këtu shkruante se Bergur Sökkason-i, ishte shkrimtari më modern në shekullin e katërmbëdhjetë, ku mes të tjerash kishte shkruar edhe sagën e Shën Nikollait dhe të kryeengjellit Mihal. Duhet të pranoj se kurrë nuk kisha dëgjuar për këtë Sökkason-in.

I telefonova Bufit dhe e pyeta për historinë e turpshme, mos i kishte zënë gjë veshi për ndonjë diçka të fëlliqur të kryer te pragu i derës, por jo, nuk i kujtohej hiçgjë. Mbjaj mend gjyshin e plakut Máli-Ólafur, i cili me sa dukej debatonte në lidhje me dënimin me vdekje të Agnes-it dhe Friðrikut, por më kot. Ne gjithnjë kemi menduar se janë dënuar për incest. Nga vjen ky keqkuptim? Sidoqoftë, dashuria e tyre ka qenë plot pasion. Edhe kriminale, ama. Fola në telefon me adashen time, vajzën e vogël të Bufit; ajo është vërtet një krijesë e mrekullueshme. Tani jetojnë të dy në fshat- familje e vogël - dhe ai më tha se tashmë janë gati për të korrur rrepat dhe lakrën. Epo, makina po pret, udhëtimi vazhdon. Ndalesa tjetër është në Blönduós. Pardje i kaluam pranë dhe vura re një vend që mund të merrej me qira dhe lirë. Ishte në qendër dhe

kishte shumë për të parë. Pa pikë ironie! Kisha harruar se gjyshi dhe gjyshja ime, kanë jetuar ca kohë këtu. Kishin ndërtuar edhe një shtëpi për vete, por mandej u vendosën në Rejkjavik. Arsyeja që dhanë: varfëria. Kjo është tërë ajo që di. Por historia se si e ndërtuan shtëpinë është e bukur në rrëfimin e Þórbergur-it, i cili e kishte dëgjuar nga dekani dhe mua ma kujtoi babai: Gvendur harabeli që po ndihmonte katragjyshin, ngriti çekanin lart dhe tha se shtëpia duhet të ndërtohej atje ku do binte çekani.

Bóla Ivymas, Hënë e plotë

Ndaluam në shtëpinë e veçuar dhe vizituam hallën e babait tim. Bleva shtatë trëndafila në të kuq e portokall të ndezur. Zogu hodhi idenë që t'i çonim në të njëjtin numër sa edhe motra e vëllezër ishin dhe mua më duhej të pyesja babain se sa të vërtetë ishin . Mandej, duke ngjitur shkallët, dola me mendje jashtë pemës familjare. Ajo na tha mirëserdhët, por shtoi edhe se nuk kishte asgjë për të na gostitur. Më erdhi keq që nuk kishim blerë ca çokollata që të qeraste mysafirë të tjerë.

Në mur qëndronin të varura qëndisma: njëra ishte një trëndafil i fildishtë, tjetra një portret i kompozitorit Shubert, si edhe një mozaik i një thëllëze dimri. Tezja tha se i kishte punuar duke kënduar nën zë gjatë vetmive të saj. Paskëtaj me një zë të qeruar dhe të lartë na këndoi disa vargje për një violinë, që vazhdonte ende të binte. Na tha se shpesh i kërkonin të këndonte kur njerëzit mblidheshin mbrëmjeve në fshat dhe ajo ngaherë kishte pranuar. I pëlqente shumë të këndonte, njëlloj si e ëma dhe si i ati, po, po; ata kishin qenë të jashtëzakonshëm për të kënduar dhe për të thurur vargje. Mu kujtua nëna e saj, stërgjyshja ime dhe nxora diçka nga çanta e dorës e ia dhashë. Ishte një stof i qëndisur me kryq ku shkruhej: *peshqir 1919*. Ajo e pa me kujdes dhe respekt. I thashë se atë thesar ma kishte dhënë njëfarë Ketilsdóttir-i ;

stërgjyshja e kishte punuar për babain e saj dhe e kishte lënë pas kur ishte larguar. Natyrisht, ka më tepër kuptim që ta mbash ti, i thashë, duke qenë se bëhet fjalë për nënën tënde. Ajo e mbështolli menjëherë të gjorin stof dhe me shumë vendosmëri ia bëri, jo faleminderit, nuk e marr dot e dashur. Pas kësaj nuk ndenji më me mua. Doli dhe seç tha disi vrazhdë, ndonëse si duke kërkuar falje dhe shtoi se duhet të kishte qenë njeri me gojë të sertë dhe se ishte e bindur se njerëzit, kur bëjnë fëmijë, duhet t'i rrisnin vetë, sado të varfër që të jenë.

Im vëlla erdhi të më takonte; po ishte gjë e këndshme të kujtonim se si gjyshi merrej me ne . Recitonim poezi së bashku, ai luante në instrument dhe këndonte; gjyshi më mësoi këngët, që i pëlqenin më tepër babait, ma do mendja se ajo duhej ta kishte admiruar vërtet Steingrímur Thorsteinsson-in dhe Þorsteinn Erlingsson-in . E pyeta në kishte pasur fëmijë; s'e mbaj mend. Jo, ai nuk mund ta linte gruan e vjetër shtatzënë, thonin njerëzit. Por im shoq ishte tepër i këndshëm dhe i mirë një mjeshtër i vërtetë për të gdhendur, njëlloj si babai. I thashë se ishte vërtet për turp, por që dija shumë pak mbi ata njerëz, pasi im atë, njëlloj si ajo, ishte rritur në një shtëpi fëmije. Babai yt dukej se nuk ishte tepër i interesuar për “familjen e tij të vërtetë”, siç thonin, ndonëse vinte shpesh dhe interesohej për të atin. I thashë gjithë ç'mundja. Gjyshi na dërgoi një kartolinë të lezetshme për Krishtlindje që e kishte punuar në dhomën e vet të punës, ku kishte kile me shishe me bojë dhe letra pa fund. Do të doja të jetoja atje, i thashë.

Më pyeti se si po ia kalonim bashkë; oh, sigurisht, rehat. Këndoi një këngë për erërat e hazdisura të jetës dhe u ndje kaq e trullosur sa iu desh të shtrihej. Më kërkoi t'i

mbaja dorën. I thashë se atë pasdite do të dilja dhe do të shkoja te kullota e dhenve ku kishte vdekur gjyshi. Ah, po, i uruari. Vdiq vetëm, por e bija rronte me plakun dhe e mbante mirë. Nuk do ta harroj kurrë kur pyetën tim shoq nëse e shoqja ishte nga ajo familje rrogoz. Dhe mandej, po ata njerëz më kërkuan të këndoja për ta! Kurrë s'kam thënë jo; ata thjesht na mallkonin për zakonet tona. Im vëlla thoshte se unë kisha zërin e mamasë. Dhe tani, ja, rri këtu dhe qëndis e këndoj; është shumë gjë e bukur të qëndisësh dhe të këndosh. Po, moj bijë, shko të rrënojat dhe përpiqu ta prekësh shpirtin e tij përmes tokës; unë mendoj se duhet të jetë ide e mirë. Ç'gjë pa fat ishte të vdisje në kullotat e dikujt tjetër dhe jo në shtëpinë tënde. Atë e dëbuan nga shtëpia dhe paskëtaj nuk pati më tokë të vetën. Njerëzit nuk e marrin dot as me mend se sa e rëndësishme ishte në atë kohë që njeriu të kishte tokën e vet.

E pyeta nëse dinte ndonjë gjë për mallkimin e njëmbëdhjetë grave që mendohej të ishin nga fisi ynë, çka bëri që familja jonë të rrënohej për pesë breza; pa rrënjë, pa tokë, pa qetësi. Po, ajo me siguri e dinte atë histori. E kishte dëgjuar nga të huajt kur e kishin braktisur, larg nga gëzimi i familjes së saj të varfër. A mund ta falësh nënë tënde? e pyeta, ndoshta pa takt, por s'ma mori për keq. Po, mendoj se jam në gjendje ta fal. Ndonëse nuk jam tepër e sigurt. Ata ishin thjesht me qira dhe nuk kishin hapësirën e tyre për të rritur fëmijët. Unë me tim shoq blemë një tokë këtu te rripat e rërës, çka ishte një bekim i vërtetë, por s'bëmë kurrë fëmijë. Kështu, gjithçka është, edhe brenda, edhe jashtë.

Na falënderoi me gjithë zemër që i shkuam për vizitë,

ndonëse i erdhi keq që nuk kishte asgjë me ç'të na gostite, ndonjë gjë për të ngrënë a ndonjë ëmbëlsirë. Pa shikojë pak atë thëllëzën. Oh, është shumë e bukur i thashë. Atë fotografi e ka bërë mbesa jonë. Udhëtonte bashkë me të atin, vëllain e gjyshit nëpër gjithë vendin. Jepnin shumë shfaqje në kremtimet me poezi popullore. Edhe ne mund të kishim bërë një udhëtim të tillë, por babai nuk ishte tepër praktik si njeri, i gjori burrë. Mençurinë e kishte në drejtime të tjera. A është akoma shtëpia që ndërtoi këtu në Blönduós? Jo, ka shumë kohë që është shembur. Gjithçka u shemb...

Rrugës për në shqopishtë qëndruam të dy në heshtje. Unë vrisja mendjen nëse duhet të ktheheshim pas e të shkonim në Bjarnarfjörður në Strandir te ferma e gjyshes sime, në Klúka, a si i thonë ndryshe në Svanshóll. Ohhh, ku jetonte magjistarja, e cila i ishte kundërvënë Kishës dhe ku ai, pasi kishte vdekur kishte arritur të çante qefinin në varrin pagan në kodrinën e fermës së tij? pyeti Zogu me kërshtëri. Unë nuk e dija. Gjithsesi shkuam më tutje. Mos bëjmë mirë të shkojmë herës tjetër që do të dalim? e pyeta dhe po, vura re se kjo ishte më e realizueshme, duke parë kohën që kishim në dispozicion.

Më pas ai më kërkoi t'i tregoja për këtë stërgjyshen time. Mua më kujtohej disi me turp e pakogjë. Përveç se kishte punuar në një fermë në veri dhe se e kishin shpërblyer me një medalje që kishte shpëtuar një njeri nga mbytyja pa ditur të notonte vetë. E kishte marrë e futur në shtëpi. Mandej u bë një amvisë e mirë në Grímsstaðholt në Rejkjavík, ku i pëlqente të ftonte miq dhe njerëz nga krahina e saj në shtëpi, të recitonin balada bashkë me të shoqin dhe fëmijët e saj. Dikush më tha se në fakt, ajo

e ruante traditën e baladave që po shuhej me kalimin e kohës dhe kur njerëzit ishin të prirë t'i harronin. Ishte në siklet nga toni i vjetruar dhe i bezdisshëm, i metrikës së tyre. Takimet në shtëpinë e saj, njëfarë Salloni i së dielës, hodhi bazat e krijimit të Shoqërisë së poetëve. Stërgjiysi kishte një fonograf cilindër dhe përveç botimit të librave regjistronte edhe baladat. Ata dinin melodi pa fund dhe me ditë e net të tëra gërshetonin baladat që nuk mbaronin. Oh, po halla e babait tim, përse nuk rrinte me ta?

Pasi kaluam shqopishtën, u sollëm ca nëpër barin me gjemba dhe pamë rrotull për rrënoja duke ndjekur udhëzimet e ekspertit të trashëgimisë kulturore. Por megjulla ishte kaq e dendur, sa mezi shihej më shumë se një pëllëmbë larg. Në njërën kodër kishte lëndina me sanëz dhe me barhënë, në disa të tjera kishte brengëçë alpinë dhe sanëz dëbore, që më bënë të mendoj se ashtu duhet të ketë qenë edhe kur ishte shtrirë ai. Doja të recitoja një ndër poemat e tij, por në atë çast s'më kujtohej asnjë. Mu sikur më kishin ngrënë me sy. Por Zogu më erdhi në ndihmë dhe më recitoi një baladë me metrikë të paqartë teksa kërkonim për rrënoja të tjera:

*Muzgu i mbrëmjes së jetës sime
Përpiqem me zor të shoh përpara, atje ku vërej
Përtej varrit tim, vështroj me habi, ftohtë,
Gërmën e alfabetit gjermanik që kam skalitur në këtë anë
Te shqyta e shpresave të pathëna.*

U kthyem duke ecur mbi barin me gjemba nëpër megjull e duke dëgjuar blegërimat. Mandej poemat zunë të më vërshonin në mendje.

Shkuam me makinë te përmendorja e Bóla-s ku jetonte ai. Rruga dikur kalonte këndeje, por tani është më e ulët.

Foka prej guri është e mbuluar me një tip myshku në ngjyrë bakri dhe unë mendoj se quhet *glæta*; e vështroj në librin e madh të kërpudhave. Poshtë pemëve të bërshenit është plot me bar pranveror dhe drurë. Varre të thellë dhe qetësi. Ngritëm çadrën jashtë gardhit. Bie shi i fortë dhe mendoj se duhet të ngrihemi herët në mëngjes. Nuk mund të shkruaj më tepër për momentin pasi harrova të blija një fener. Shkrepëset janë të lagura dhe s'ka asnjë shenjë *brennivín*-i. Në këtë terr nuk kam asnjë dritë.

Emnakja ime, gjyshja me një fjalë, përpara se të ndaheshim pardje, më tha se veçoria jonë dalluese ishte ruajtja e qetësisë e se s'duhej të qaheshim kurrë. Unë do të shtoja edhe se poeti, i cili prehej këtu ishte disi grindavec. Më kujtohet se si në mbledhjet e familjes sonë, njerëzit ishin gati të mëshironin veten. Disa të tjerë qortoheshin për dështimet e të tjerëve, edhe kallogretë, nëse nuk kishte kënd tjetër për të qortuar. Jam e vetëdijshme për këtë pririje. Po e shkruaj.

Unë duhet të kem lindur me bindjen se këtë vend, në shekullin e nëntëmbëdhjetë drejtësia ishte pak më poshtë se sa padrejtësia dhe po ashtu, se është gjë e mirë t'ua lesh në një poemë brezave të tjerë për të kujtuar ekzistencën e asaj padrejtësie. Ky poet u dëbua nga shtëpia e tij, ku jetonte me gruan e dashur dhe fëmijët. Fermerët rrotull, lakmitarë për trojet e tij e akuzuan se vidhte bagëti; ishte e lehtë të sajoje gënjeshttra të tilla duke qenë se ai ishte gërnjar dhe dukej si njeri i egër. Por kundër tij nuk u provua asgjë, asnjë provë, as dëshmitarë, as gjyq. Emri i

tij u nxi dhe familja mbeti pa shtëpi.

Te mburoja e shpresës sime, them një lutje për më tepër drejtësi. Për njerëzit, kafshët dhe për tokën. Dhe më e mira ndër ato që na jep nëna tokë dhe atdheu do më shpien te vatra ime familjare. Copat e gurëve me gerrat e alfabetit gjermanik më kujtojnë se kam zemër të fortë, por gjithashtu edhe se si një trishtim i mrekullueshëm mund të jetë kaq pranë tokës.

Hólsfjöll

Shqopishtja në verën e vonë ë verën e vonë, Çerek hëne, dritë veriu

Te varri shkula ca bar dhe e mora me vete, duke i ndjerë aromën gjithë kohës. Kjo më shpuri më pranë ditëve të atëhershme. Por, mesa duket ka një vrimë në anën femërore të familjes, një pështjellim gjeografik të trashëguar dhe, megjithatë, unë vështroj ngulazi në hartë, kaluam vendin e lindjes së gruas, për të cilën pardje mësova se ishte gjyshja e stërgjyshes sime... Gjyshi i saj mendohej të kishte qenë një rrobaqepës francez, nga Etretat-i. Kur katragjyshi im vizitoi një herë varrin e gruas, për të cilën thuhej se kishte gjënë gjyshja e tij, me gjasa ka recituar një vjershë, të cilën më kujtohet se ishte shumë e bukur, por që nuk e mbaj mend, përveç një vargu, të cilin e përsëris me vete, pasi më vërtitet në kokë- shoferi im i gjorë, që duron këtë tmerr: *nderi ynë ka zënë myshk, nderi ynë ka zënë myshk...*

Këtu, në kasollen ku po rrimë sonte, koleksionet e poezive janë në vendin e tyre dhe për lehtësimin tim e gjeta vjershën:

*Këtu te varret e të parëve tanë
Nderi ynë ka zënë myshk.
Rroftë e u lartësoftë emri ynë
Në furinë e valëve vigane .*

Rrugës këtu në Fjöll pamë barakën e bariut ku Bensi malësori kërkonte strehë për vete dhe për bagëtinë gjatë stuhive. Më kujtohet kur mora shokun tim të vjetër, vrojtuesin e zogjve dhe nga ferma e qëmotshme e solla këtu bashkë me fizarmonikën. Kisha një dëshirë të fortë për të gatuar në hotelin e verës, apo thjesht një dëshirë të fortë gjatë verës. U ulëm për ca kohë mbi llavë, që atë natë shkëlqente, dhe kënduam këngë. Aromë drite.

Për ca kohë, më vinte zor nga vetja që i kisha kërkuar të luante këngën *Qofshi të bekuar ju o fshatra*. Fillimisht ai nuk pranoi, duke thënë se kjo këngë ishte kënduar te varret e njerëzve nga zona e liqenit ... Por unë nuk hiqja dorë dhe në fund, bëri ç'bëri dhe e këndoi në kujtim të Bensi malësorit. Gjyshi im, ai i birësuar duhet të ishte pagëzuar pas tij, mendova. Përndryshe, të gjithë detajet janë thujse të tytë për momentin; përgjatë rrugës përpiqem të edukoj Zogun të rrijë urtë, pasi më pyet vazhdimisht për gjëra të ndryshme, por përgjithësisht nuk merr asnjë përgjigje nga unë.

U lehtësuam që ia dolëm të qëndronim në një kasolle torfe të thatë këtu mbi shqopishtë; tenda ishte tepër e lagur që të mund të futeshim. Nuk jemi më Eggert-i dhe Bjarnidhe, sidoqoftë, ata kurrë nuk do të bënin kaq shumë rrugë së bashku. Verilindjen Bjarni e mbulonte vetë.

Ura te lumi Jökulsá, të cilën e kishte ndërtuar babai i vërtetë i tim eti dhe babai, që kishte birësuar, është e bardhë dhe e fuqishme. Lumi i akullt është i fortë dhe i ndotur dhe mua gjithmonë më kujtohet punëtori i lundrës me admirimin dhe drithërimat e tij. Sveinn Pálsson-i e përshkruan kalimin e lumit me një varkë të vogël dhe pranon se si e kishte kapur llahtara kur kishte parë rrymën,

por edhe si kishte vazhduar besimplotë. Pas ndërtimit të urës, gjyshja mori një taksi nga Rejkjaviku për në veri; kaloi nëpër urë me babain në krahë. E kishte marrë me forcë nga motra e vogël në Rejkjavik.

Unë s'arrij t'u besoj fjalëve të mia kur pashë Zogun, i cili praktikisht nuk ka rrënjë familjare këtu në Fjöll. S'është e thënë që fijet të shtrihen gjithnjë jashtë rrënjëve të familjes. Dhe megjithatë, babai nuk donte të ishte fermer dhe u largua herët nga shtëpia. Ai gjithmonë të vinte këtu në veri, sa herë kishte kohë; në fakt kështu vazhdon akoma. Veriu, veriu, veriu, ne gjithmonë do të shkojmë drejt veriut.

Pardje, Bufi tha se ai vetëm kohët e fundit ka filluar ta vlerësojë tamam se sa të papërsëritshme janë zonat e shkreta të veriut; në jug, çdo copë e vogël toke është e banuar. Ai gjithnjë shkon në veri, sido që të jetë koha. Pardje, kur u njoftua se një sipërmarrës pasanik i ndyrë kinez do të blinin tokë atje, më telefonoi dhe më tha se nuk do ta besonte kurrë që do të vinte një ditë që vargjet e Poetit Mal, do të tingëllonin me një mprehtësi aq të fortë: *Tani veriu më iku nga shikimi, tani unë s'kam më shtëpi*. Unë shpresoj çiltërsisht se njerëzit do të bëhen bashkë dhe nuk do të pranojnë t'ua shesin. Çfarë dimë ne për qëllimet e blerësve? A është e drejtë, në përgjithësi, që një copë kaq të madhe toke, të zotërohet nga privatë?

Zotërimi privat i hapësirave të mëdha të tokës duket se është anakronik. Ne duhet ta rimendojmë marrëdhënien ndërmjet zotërimit privat të tokës dhe posedimit publik të burimeve. Më në fund, Uji ka filluar të deklarohet ligjërisht si burim. Po si i bëhet për sa i përket shkretimit, bukurisë dhe hapësirave shpirtërore, po atmosferës?

Më kujtohet kur në pranverë, pasi kishim mbledhur vezët e patave, Zogu thoshte se po e kuptonte thellësisht se posedimi i tokës ka një rëndësi jetike në jetë dhe fakti që babai nuk ka bërë asnjë kërkesë për ndonjë copë tokë, ishte një e keqe, e cila nuk i dilte dot.

Unë qesha dhe i thashë se mendoja se zotërimi i tokës ishte diçka e së shkuarës; një mendim i vjetruar. Për ne do të ishte më se e mjaftueshme sikur të kishim mundësinë të vinim këtu në këtë kasolle prej torfe kur të donim, e ku mund të ushqenim në paqe kujtimet tona. Ndërkohë që ai dhe babai ynë po ndërtonin kasollen e tyre prej torfe, unë dhe mamaja bridhnim sa në Romë e sa në Paris. Qëndronim nëpër rezidenca artistësh dhe ndiheshim më mirë të udhëtonim sa nga një vend në një tjetër, se sa rrinim të kapura pas një kolibeje të vetme.

Tani e shikoj që e kisha gabim. Oferta e biznesmenëve kinezë më hapi sytë dhe më ndriçoi vizionin e së ardhmes. Lidhja me tokën nuk do të pritet kaq lehtë. As nuk do të mbahet vetëm në mos kultivohet, njëlloj si dheu. A keni një copë tokë tuajën nëse doni që lidhja juaj me një vend të forcohet? Ç’thotë Konfuci për këtë?

Duhet të jeni të aftë të gëzoni më të mirën e kësaj pa e zotëruar faktikisht, sepse kushdo që e ka në zotërim nuk do ta përdorë në një mënyrë, e cila nuk i lëndon të tjerët. Nëse dëshironi të thoni diçka në lidhje me përdorimin e tokës, duhet që patjetër të keni në zotërim një terren. E tillë është situata.

Për të mbushur ujë zbritëm te një shtëpi aty poshtë sepse pellgu ishte tharë. Na qerasën me kafe dhe na treguan një hartë të vjetër, e cila fliste për ofertën e biznesmenëve kinezë. Një ndërmjetës kishte thënë se

oferta ishte e jashtëzakonshme dhe se duhej ta praninin edhe sikur të vdisnin; ngurrimi ishte baraz me humbjen.

Shpjegimi i dhënë për interesimin e këtij biznesmeni kinez në Islandë ishte një pulovër islandez që e paskëshin thurur enkas për të, tridhjetë vjet më parë.

Unë e kuptoj plotësisht se si njerëzit dashurohen me ata që thonë se do të prodhojnë dhe do të zhvillojnë. Është e natyrshme. Aq më shumë nëse zhvillimi prek edhe zonën. Aq më shumë efekt bën kjo në një vend ku shpërthen në ajër televizori për shkak të gjeneratorëve dhe ku uji mjafton sa për të bërë një dush të shkurtër. Unë u përpoqa t'i bindja se mund të arrijnë në një zhvillim të qëndrueshëm edhe me mënyra të tjera dhe jo detyrimisht duke qëndruar nën sjetullën e korporatave. Sepse ideali i zhvillimit të qëndrueshëm nuk është jetesa nëpërmjet bujqësisë për të gjithë. Më saktë, bujqësia i shërben interesave të tokës dhe kësisoj bëhet e mundur jetesa e brezave që do të vinë. Këto përsiatje të miat u pranuan pozitivisht, ndonëse shpejt dolën në pah edhe mangësitë. Më ofruan një suxhuk.

M'u kujtua se si një herë babai, i lodhur nga pjesëmarrja në një debat të hapur në Hrossaborg, tha se në këtë vend, ashtu si edhe në shumë të tjerë, njerëzve u ushtrohej trysni për të ndenjtur urtë. Ai i respektonte fermerët e vjetër, por thoshte se, pasi kishte reflektuar për një kohë të gjatë, kishte arritur në përfundimin se për realitetin ku ishim rritur ne, ishte plotësisht i vlefshëm termi patriarkat shtypës. Me lëvizje të duarve, ai ia bënte se njëlloj si bari i thatë nëpër fusha, asgjë e pakëndshme nuk ishte eliminuar. Thjesht e kishin dystuar dhe mbuluar me torfë.

Po kasollja jote prej torfe mos është gjë shtypje? Epo, nuk e di. Mbase është një paralajmërim. Por është një simbol më shumë i aftësisë për të jetuar i patrazuar nga patriarkati. Për të pasur mundësinë të jetosh me një kasolle dhe të thuash çfarë të duash! Dhe shiko, në gjithçka që bën vështro malet. Duhet të jetë goxha e vogël ajo kolibja jote, është e pamundur të bësh tjetër gjë, përveç se të sodisësh malet. Biznesmeni kinez me sa duket qenka i dhënë pas vetmisë dhe shkretimit. Po sikur t'ia shesë tokën dikujt, i cili nuk është ndonjë ruajtës i thekur i ambientit, siç pretendoka kinezi për veten?

A mundet ky potencial shitjeje të jetë një përfundim logjik i një pune të gjatë prej dekadash të fermerëve të cilët kanë për bazë konsumizmin? Na u kujtua Mödrudalur-i, i cili nuk konsiderohej kushedi se ç'bujk i mirë pasi sillej gjithnjë disi çuditshëm. Ai i kishte dërguar babait një letër të gjatë poetike mbi muzikologjinë dhe i telefononte rregullisht gjyshes në rrjetin e telefonisë rurale për ta pyetur se si i ishte dukur ndonjë këngë e re që kishte dëgjuar në radio. Dhe ajo ishte në një mendje me të se Herðubreið-i ishte më i bukur nga Mödrudalur-i. Jo, nuk ia thoshte. Kur isha fëmijë, mendoja se nga këtu dukej vërtet kështu, por kur u bëra adoleshente u rebelova kundër asaj pamjeje dhe mu duk më i bukur Mödrudalur-i me asimetrinë e vet si një gjoks i sapodalë.

Hólsfjöll

Dita e shatërvanit të myshku të kënetës, hëna në zmadhim

Sot bënte disi ftohtë jashtë dhe u futëm brenda në skabinë për të lexuar. Zogu preu drutë për zjarrin; këtu brenda është tepër nxehtë dhe këndshëm. Ai po lexon një tjetër libër të Tomas Bernardit, *Ndreqjet*, në lidhje me sozinë e Uitgenshteinit, i cili kishte ndërmend t'i ndërtonte të motrës një shtëpi të përsosur. Uitgenshtajni u kthye në Islandë një ditë bashkë me një shok dhe i ra kaluar mbi kalë kryq e tërthor vendit. Mes të tjerave, kërkonte një copë tokë për vete. Mandej ndërtoi një kasolle në një mal në Norvegji, një kolibe të vockël ku mund të jetonte i vetëm me mendimet e tij. Më duket vërtet e pabesueshme se sa nevojë mund të ketë një njeri për paqe dhe qetësi, në mënyrë që t'i përkushtohet plotësisht mendimeve të tij.

Tani po lexoj një raport të Bufit, i cili ka lindur në të njëjtën ditë me Uitgenshtajnin. Raporti bën fjalë mbi kërkimet për origjinën e vendbanimit të Hólsfjöllit. Kur jetoja në Paris dhe dëgjova që ai do të shkonte të bënte vetë gërmime në veri, si një qen pas një kocke të padukshme, e admirova për shakanë; për atë veprim absurd dhe për dëshirën për të ndjekur filozofët drejt së panjohurës e në kërkim të relikteve, në të ftohtë e në një tokë ku të përulan era. Persona të ndryshëm u përpoqën t'i ndryshonin mendjen. Por ai ishte më kokëfortë se

djalli dhe kështu u nis të punonte me gjithë të pajisjet që nevojiteshin për të hapur një gropë të madhe deri në shekullin e dhjetë. Duket se qysh atëherë vendi kishte qenë i pabanuar.

Ai kryesonte kërkimet në Hóll, madje edhe më tej në disa zona të egra. Me shokun e vet, cjamin e një ferme, që endej aty rrotull dhe dëgjonte historitë e tij, ia kishin kaluar mirë së bashku. Bufi më tha se në pranverë ne të dy, motër e vëlla duhet të ngrinim atje një fermën tonë. Me dhen. Ai duhet të ishte vendi ynë; po mendonte të paraqiste një ofertë dhe të ndërtonim një shtëpi ku të jetonin familjet tona; babai, nëna dhe gjyshja mund të vinin të jetonin me ne. Mua më pëlqeu shumë ideja. Mund të sillnim edhe një shtypshkronjë të vjetër. Por këto ëndrra diskutoheshin përpara se biznesmeni kinez të ngrinte çmimin....

Në raport, ai fliste për një përrallë popullore në lidhje me banorët e parë të Hóll-it. Atje kishte jetuar njëfarë Guðrún-i nga Jökulsárhlið-i, një njeri goxha mendjehollë dhe malësori Gunnsa, të cilin e dëbuan kur u zbulua se mbante fëmijën e të vëllait. Ky kishte shkuar në mal me dy cjepër, mandej në një kodër dhe më pas kishte kultivuar tokën, kishte peshkuar trofta dhe kishte ndërtuar një shtëpi të lulëzuar. Pas ca kohe te ai kishte shkuar edhe i vëllai bashkë me vëllezërit dhe motrat e tjerë dhe kishin jetuar në paqe dhe në harmoni për shumë vite, lart nga vendbanimet e njerëzve të tjerë dhe mosbesues kundrejt ligjit.

Ndonjëherë, e kemi të vështirë të kuptojnë përse ka njerëz, që kërkojnë vende kaq të humbura, përveç se

prej ankthit absolut. Kjo do të thotë se nuk merret fare parasysh bukuria, paqja dhe qetësia dhe se asgjë nuk vlerësohet.

Në raportin e Bufit shtjellohet teoria e tij mbi të ashtuquajturën ekonomi të rezervateve të kullotave. Kjo bën të mundur që njerëzit, të cilëve u duhet të kullojnë bagëtinë në dimër, në vend që t'i mbajnë kafshët brenda, të kenë mundësinë të pajtojnë shumë bari, të cilët qëndrojnë me bagëtinë e tyre nëpër stane, qoftë edhe për disa vite. Mua më duket disi zbavitëse se si përshkruan me kaq entuziazëm burrërinë në atë raport duke e quajtur: bariu i pavarur.

Më kujtohet konsulenti kur doli të ecte me babain nëpër ara dhe pasi u kthyen kishin arritur në përfundimin se fushat me bar ishin të lënduara nga ngrica. Babai u kthye pas me mundim dhe vështroi i zymtë duke i ofruar konsulentit një dele me qumësht. Ai arsyetim m'u duk si dënim me vdekje dhe kuptohej se gjyshit i vinte turp. Sikur ishte ai përgjegjës për të ftohtin dhe ngricën. Sikur ai vetë të ishte bërë shterpë.

Gjyshi nuk e shkonte dot ndër mend që toka mund të përdorej për tjetër gjë veçse për bujqësi. Dhe tokën që kishte, ia la trashëgim vetëm njërit djalë, atij i cili donte të bëhej bujk, ndërkohë që vajzave dhe djalit që ishin larguar nga shtëpia nuk u la asgjë. Sipas zakonisht.

Unë jam mësuar të përçart këtu në ditarin tim, në mënyrë që mos ta mërzis bashkëbanorin tim, pavarësisht se ai është përçartës për vete. Thjesht nuk dua ta bezdis kur lexon, as kur jam gati për mendime tepër të rëndësishme dhe irrealë. Por gumëzhima ime lidhet me tatëpjetën e këtij vendi. Stanet e mëdha të bagëtive janë

si një përmendore për lëvizjen e mjerë të bujqve. Lëvizja e bujqve në shkallë të gjerë, lëvizja e industrisë së madhe. Përse të mos ketë industri shtëpish fshati e fermash të vogla, në një tjetër sistem ekonomik? Nuk ka mbështetje dhe ndihma për zhvillimin e ngadaltë: gjithçka duhet të ndodhë menjëherë, duhet të jetë e madhe. Në vend që të ushqehen njësi të vogla, të pavaruara me marrëveshje për përfitime të ndërsjellta, fermerët mësyjnë me plane ekspansioni, të cilët, jo që nuk shënojnë rritje, por përkundrazi, i shpien drejt tatëpjetës, çka ishte e parashikueshme, pasi nuk ishte konceptuar për një bujqësi të qëndrueshme.

Unë mendoj se fermerët duhet të psikanalizohen dhe të rimendojnë lidhjet e tyre me tokën dhe me mashkullërinë. Dhe të mos jenë thjesht fermerë. Të gjitha çerdhet e fëmijëve në botë duhet ta bëjnë tyren e ta kenë në program këtë.

Nesër në mëngjes do të shkojmë me makinë drejt Sandurit. Mandej do të marrim drejt veriut për në Vopnafjörður, drejtimi i kundërt i Kristianit tonë të dashur Malësorit-poet. Shpresojmë që vargjet të kthehen e të qarkullojnë dhe Veriu të mos na ikë nga sytë.

Ás në distriktin e Kelda-s, Festa e hauzeve dhe e kredharakëve me brirë

Shkuam në Ásbyrgi dhe qëndruam vetë në pellgun e patave të egra. Më kujtohet se si isha ulur në një shkëmb buzë gjolit kur kisha qenë nëntë vjeçe dhe më dukej se ai ishte një vend i përsosur për të menduar. Poshtë bëhej një potere e madhe te harqet e kthesave të bazaltit dhe unë doja që Zogu ta dëgjonte, por nuk doja të shqetësoja qetësinë. Lulet e rrukës së drurit kishin rënë poshtë dhe manaferrat po piqeshin. Ecnim zbathur, i këpusnim i hanim. Zogu ndihej shumë mirë që provonte një paqe emocionale në atë vend të mrekullueshëm. Nuk ndiheshim si turistë, pasi mua, më dukej sikur isha edhe paksa zotëruesja e atij vendi e që mund t'i ndaja ndjesitë me të. Mandej u kujtova për një episod ogurzi. Kur drrerët e veriut u dëbuan. Reshtëm së ngrëni manaferra, ndonëse kishin shije gjaku.

Po qëndroja te pragu i derës së shtëpisë së vjetër ku stërgjyshja kishte jetuar bashkë me fëmijën e saj, kur papritur u shfaq një zyrtar, me të cilin qëlloni që kishim qenë shokë në fakultetin e filozofisë. Ishte bërë rojtari i Parkut Kombëtar! A jeni e interesuar për këtë shtëpi? Atje jetonin rojet; një shtëpi e mirë, shtëpi pjellore. Ai ishte shefi dhe na ofroi për të ngrënë duke na thënë se kishte një grua të mirë dhe dy djem. Mandej na foli për jetën në fshat. Se si ajo i jepte një këndvështrim më të thellë për

shoqërinë dhe e ndihmonte ta vlerësonte më tepër. Mezi prisnin festën e mesdimrit. Do të përgatisnin gjithçka për mrekulli, apo kështu na dukej neve. I admironim që kishin lënë qytetin dhe kishin përqaftuar jetën e fshatit, që përgatisnin marmelatë dhe bar të thatë.

Na dhanë një palë dylbi për të vështruar zogjtë dhe na treguan vendin nga ku mund të vrojtonim kredharakët me xhufkat e tyre të kuqe në kampin veror të Ástjörn-it. Unë doja të gjeja shtegun që kishte marrë motra me dhentë, atje te shkurnaja ku gjithnjë shkonin të shikonin bufin me bri të shkurtër. Por nuk më bëhej, nuk mund ta përballoja dot. Ama gjeta ca lule, të cilat nuk i kisha hasur më parë dhe që s'para rriteshin në këtë vend, një livadh me kasolle të verdha, emigrantë të bukur që ishin vendosur në cep të fushës me bar të thatë.

Dikur, gjyshja thoshte se i vinte keq që e kishte shitur pjesën e saj të fermës, copën e tokës të trashëguar nga e ëma. Stërgjyshja, duke qenë një pioniere e të drejtave të grave, i kishte çuar vajzat të shkolloheshin dhe u kishte lënë tokën trashëgim. Pasi mbeti e ve, ajo dhe fëmijët e saj punuan si skllevër, mandej blenë një copë terren nga qeveria dhe nuk patën kurrë nevojë për ndihmën nga distrikti sepse nuk kishte borxhe për tokën që zotëronte.

Babai e mbante mend mirë atë; ishin miq të ngushtë dhe ajo i kërkonte t'i premtonte t'i betohej se toka do të mbetej brenda familjes. Me kalimin e kohës Agjencia Islandeze për Mbrojtjen e Mjedisit i bëri një kërkesë për t'ia blerë dhe asnjëri prej tyre nuk kishte plan të shkonte e të merrej me bujqësi. Gjyshja ishte e kënaqur që toka do të kthehej në park kombëtar, tha babai me një vështrim dyshues. Ajo, shiti jo vetëm pjesën e saj të tokës, por

edhe pelën ngjyrë të dheu të çelët dhe kërriçin. Kjo duhet të ketë ndodhur ngaqë i vinte keq që ajo nuk kishte ndërmend ta shiste pjesën që kishte tani.

Snartarstaðir, Núpasveit Eklips, dita e Muzeumit

Për ne ishte frymëzim vërtet i madh që u kthyem te shtëpia e fermës. Gjithë rrugës ndihesha e emocionuar dhe e pyesja një e dy Zogun nëse po bënim mirë që po shkonim; s'është hiç e hijshme të bezdisësh njerëzit, të shkelësh në prona private e të fusësh hundët me kërshtëri andej-këndeje. Ai më jepte zemër të mos bëhesha merak e më këshillonte që thjesht të shkoja e të prezantohesha. Çka edhe e bëra; nuk mund të kthehesha dot pas. Gruaja, e cila jetonte atje më priti me shumë ngrohtësi. Kohët e fundit merret me fermën dhe ka bërë në plan të kryejë punime në shtëpi dhe të shtojë rendimentin e tokës. Shtëpia e vjetër ku jetonin stërgjyshja dhe gjyshi ishte shembur nga një tërmet i fuqishëm, por ata kishin ndërtuar një të re. Tanimë, toka u përkiste atyre dhe nuk kishin më borxhe.

I ramë rrotull hangarit të vjetër. Gruaja më foli për ndërveprimet e saj me hallën time të madhe, me të cilën ndonjëherë rrinin e rrëfenin histori dhe këmbenin manaferra. Këto dërgoheshin në veri bashkë me urimet nga një grua me kujtesë të mirë. Histori mbi fermën nga koha kur ekzistonin ende mullinjtë me erë, gjeneratorët për rrymë elektrike për shtëpitë, trofta në përrua dhe shumë vizitorë. Kur bimët përdorëshin për të bërë ngjyra dhe ilaçe dhe thëllëzat shpëtonin jetë njerëzish. I kujtohej

gjithçka nga fëmijëria e saj, vendet ku hante manaferra. Manaferrat nuk kanë asgjë magjike. I kujtohej edhe një histori e ardhur nga jashtë vendit, kur halla e babit ishte në shkollë në Norvegji dhe shkoi në shtëpinë e një kuislingu për të riparuar një mur që po shembej. I zoti i shtëpisë mbeti pa mend kur zbuloi se ajo ishte islandeze. A krijoi miqësi me të? O zot, të atit i binte bretku për të mbajtur bagëtinë, fut këtu edhe përpjekjet për të shtuar aftësitë mashkullore të kreut të bagëtive. Ajo i tha se ishte tepër e befasuar të zbulonte se ky njeri me tërë këtë entuziazëm për të dëgjuar mbarështimin ishte një nazist. Mandej kishte përshkruar murin që po shembej dhe tregonte si e kishte ndrequr.

Po shkonim të pyesnim nëse mund t'i hidhnim një sy oborrit të kishës, por na thanë se e kishin zhdukur. Oh? Po, për ta bërë më të lehtë zbulimin e mjedisit aty rrotull. Tani atje ka një fushë me bar të thatë. Ç'mu desh që e pashë! *Nderi ynë është mbuluar me myshk*. Mendoja se ajo duhej të ishte varrosur atje dhe u hidhërova, ndonëse nuk duhej të kishte ndodhur shumë kohë më parë. Stërgjyshja ime, një mesogrua, e cila shkonte lart e poshtë nëpër atë zonë dhe linte fëmijët, duhet ta kishte marrë vetë çështjen në dorë kur disa dhen kishin ngecur në llucë dhe vendi ishte goxha larg nga thertoret. Ajo i theri vetë dhentë në kishën e zonës dhe mishin ua shpërndau të gjithëve. Gjyshja jote duhet të jetë varrosur në oborrin e kishës. Oh, po. U lehtësova, por ndihesha ende e trishtuar.

Ferma është vërtet e bukur, ndonëse historia i rrëshqet ancorimit. Llava dhe fushat e pakultivuara e të mbuluara me bar, malet në largësi dhe mandej deti.

Ai shkoi te deti. U hodhi një vështrim gjërave që kisha larë. Dhe tani jam në kafenenë e një muzeumi të zonës, ku nëpër eksponate kanë vendosur qëndisimat e fustaneve të dasmës së stërgjyshes. Ishin edhe pantoflat e qëndisura dhe syzet e zbukuruar me imazhe fletësh, libra të lidhur nga libralidhësi i distriktit, i cili lidhte çdo broshurë nga distrikti dhe çdo libër të vogël që blinte Shoqëria e Leximit, më së shumti botime të huaja, të cilat populli i zonës i përkthente vetë dhe i botonte në sasi të vogla. Ai kishte bërë gjithashtu edhe kapele të bukura gëzofi. Cila kokë i mban tani këto dije? Nën cilën kapele gëzofi gjendet? Por tani, duke qenë se ka një ringjallje të interesit, kanë filluar të përdoren gjithandej materialet e papërpunuara të zonës, si në stilim dhe në prodhim, por makinat nuk punojnë më dhe dijet janë në varr.

Pórshöfn në Pistilfjörður

Po ajo ditë

Dolëm nga fshati Kópasker dhe përpara se të merrnim rrugën për në Vopnafjörður blemë disa produkte vendore, mes të cilëve edhe mish qengji të konservuar. Për tërë gjatësinë e rrugës së re, në të dyja anët kishin vënë parmakë mbrojtës. Është vërtet lehtësim i madh, tha Zogu. Mua m'u kujtua koha kur bashkë me Bufin ndërtonim gardhe dhe një kushëriri ynë, një burrë goxha i madh në moshë na jepte urdhra. Ne hakmerreshim duke folur me njëri-tjetrin me një gjuhë pakuptim që e kishim mësuar nga Pinokio, njeriu kukull. Bisedonim për gjëra nga më të ndryshmet si flora, fauna, retë, por kushëriri ishte bindur se ne po planifikonim ndonjë revoltë kundër tij, kështu që filloi të mos ndihej i sigurt dhe na kërkonte me ngulm të mësonim gjuhën e tij.

Ishim në *Eyri restaurant* në Pórshöfn, e kishim dalë për të notuar dhe për t'u zhytur në vaskën e ngrohtë, ku në fletët me mbulesë plastike mund të lexosh informacion në lidhje me fshatin dhe me faktin që dikur, vendasit ishin të varur nga rrobaqepësit francezë.

Ndonëse këtu s'është vendi dhe as koha për të shkruar, më duhet thjesht të hedh diçka në letër, si për shembull: çfarë po mendoja rrugës për në Melrakkasléta.

Kur ne protestonim se si islandezët i kishin shitur kompaninë e tretë më të madhe të energjisë një korporate

të huaj, e cila kishte përveç se kishte përfituar nga legjislacioni për zonën gri, kishte edhe një emër të keq në botën e sipërmarrjes, shumë njerëz më pyesnin nëse e kisha me tërë mend që po bëhesha nacionaliste kaq e thekur. Dy burra deklaruan se më mbështesnin, por sepse siç thanë, kishin qenë të përkushtuar ndaj nazizmit. Ja, këto më vërtiteshin në mendje edhe tani sepse e dija që do të më pyesnin se çfarë kisha kundër biznesmenit kinez.

Nuk kam asgjë kundër atij kinezi apo kinezëve në përgjithësi. Kam parë më shumë filma kinezë se sa amerikanë, besoj. Por Kina është një superfuqi dhe brenda kuadrit të saj lulëzojnë korporatat, kapitalizmi. Është një vend kolonialist, i cili nuk nguron të thyejë shtete të vogla si Tibeti, të shpjerë tanket nëpër biblioteka, manastire, spitale apo shkolla. Njëlloj si vikingët kur shembën manastiret irlandeze rrugës për në Islandë. Hakmarrje e Karmicut.

Nëse i kundërvihesh shitjes së trojeve, virgjërisë së natyrës dhe energjisë së vendit tënd një biznesmeni dhe një korporate, që kanë plane në shkallë të gjerë, nuk mund të akuzohesh aspak për nacionalizëm. Nacionalizmi, apo nazizmi, dallohen nga mënyra se si përjetësojnë në plan afatgjatë dhunën kundër individëve, kundër atdheut e kundër fermave të vogla. Gjithçka vetëm e vetëm për një megafermë. Për ekspansion. Ekspansion për hir të ekspansionit.

Nëse je mbështetës i Kópasker-it, tymosjes së mishit të qengjit, nuk do të thotë aspak t'i konsiderosh islandezët si më të mirë se të tjerët nga një këndvështrim gjenetik apo kulturor. Po ta mendosh një çikë është krejt tjetër gjë... por mua më duket gjë e mirë që të kem një

përgjigje, pasi kështu e gjen veten në mes të llogores së luftës politike, atje nuk para përmbahen për të të vënë damka; atje qëllojnë drejt e në syrin e tretë të kafshës.

Vopnafjörður Dita e xhunglës dhe varkave me vela

Ngulëm tendën poshtë disa shkëmbinjve, atje ku gjyshja kur kishte qenë vajzë bënte torta me çokollatë. Terreni është i përshtatur për kamping, me furnizim elektrikiteti, ujë të ngrohtë, dushe dhe tualete. Me pamje nga fjordi. Kutërbimi i skumbrive nuk na bezdis dhe qulli i një punishteje të zonës s'është i keq; shpresojmë të na dalë koha që të shkojmë te pika e shpërndarjes ose atje ku e prodhojnë.

Dje, rrugës për këtu bëmë një kthesë për në Langanes. Muzeumi i Sauðanes-it ishte mbyllur për shkak të disa rrethanave, të cilat nuk vareshin nga askush. Mbase prej diellit. Qysh më parë, teksa ecnim përgjatë bregdetit me natyrë të egër e të panjohur, zuri të më brente ndërgjegjja. M'u bënë ca si ogure të liga për barin që mund të mbetej i thatë etj, por akoma pas tërë atyre vitesh doja ta shihja atë njeri. Kishte qenë më i riu ndër fshatarët atje dhe unë dhe Bufi e quanim Tarzan, pasi i ngjante aktorit që luante rolin; të dy çmendeshim për atë film, bënim sikur ishim Tarazani dhe Xhejni dhe vrisnim mendjen si të krijojmë një gjuhë majmunësh...kur ia thashë Zogut, ky, si me bezdi më tha nëse ishte mirë të mos shtyheshim aq larg. Aq larg si? Unë nuk e kuptoja çfarë donte të thoshte. Tani, po arrij ta kuptoj; eh, është disi e sikletshme. Jo, jo, nuk u shtymë aq larg. Ia bëmë vetëm ooo dhe oo oo

oo. Pak a shumë është i njëjti sistem si centrali telefonik i fshatrave, një e shkurtër, dy të gjata për këtë fermë, tre të shkurtra për atë tjetrën.

Mbetëm të befasuar në vend, kur bujku i ri i distriktit doli te dera e haurit të bagëtive me një qengj të murrmë si në bakër e me një këmbë të thyer që e kishte gjetur te fusha me bar të thatë. Me kominoshet prej lëkure dhe me trikon prej leshi ngjante Tarzani në vend. U magjepsëm .

Kur po ecnim në rrugë me makinë dhe e pashë në traktor duke lëruar tokën, brenda meje u zgjuan majmunët. Vrisja mendjen në vishej akoma me kominoshe lëkure? Epo domosdo, një mashkull duhet t'i mbrojë herdhët nga një i ftohtë i tillë.

Thashë se do të afrohej për të na përshëndetur si vizitorë që ishim, por me siguri duhej t'ia kishte lënë të bijës të merrej me turistët. Në vend të saj na doli e shoqja, Xhejni, me një bukuri që të linte pa frymë. Qëndruam përpara shtëpisë dhe bëmë gjithë atë muhabet. E pyeta si shkonte “turizmi kulturo-ekologjik” dhe prodhimet organike. Oh, po shkon shumë mirë, kemi qëndrueshmëri, kemi ndërtuar shtëpinë e miqve me dru të sjella nga plazhi. E pyeta për ngjarjet e Fjöll-it vitin e kaluar, ku kishin detyruar me forcë banorët të largoheshin. Nuk e di më tha; ata s'para flasin shumë. I thashë të përshëndeste vëllain e majmunit.

Në plazh gjeta një guaskë gjigande, si e bardhë në të verdhë.

Është herët dhe ndriçon. Jam ulur në tendën e hapur. Dielli shkëlqen dhe djeg nga vrimat e hapura në qiellit. Më zgjoi një korb me një krrokamë të veçantë në intervale triminutëshe, njëlloj si zile arlami! I jam mirënjohëse pasi nuk do kisha dashur kurrë ta humbisja këtë çast të diellit. Mandej, korbi e ndryshoi ritmin dhe mori një melodi moderne, i ndjekur nga korbat e tjerë me flokë të gjatë e nga ca derrkuca qumështi dhe pak më vonë fluturoi tutje. M'u kujtua dashuria ime e madhe për korbat, humori i tyre, si edhe koha kur një korb më ndihmoi të kullosja tufën e bagëtive.

Kisha pesë qengja, nga ata që quhen qengja mali dhe duhej t'i kullosja duhej i ngarë në drejtim të kundërt me akrepat e sahatit. Gjendesha poshtë pishnajës dhe gati kisha mbaruar me kullotjen e po bëhesha gati të kthehesha në shtëpi, kur një korb, m'u ul pranë dhe më krakëlliu me një tingull të çuditshëm që nuk e kisha dëgjuar ndonjëherë nga asnjë zog duke më lënë të kuptoja se bagëtia kishte ikur shumë larg. Ishte një njoftim tepër i rëndësishëm. Renda menjëherë dhe i arrita, pastaj korbi, ariu i bekuar i manaferrave më priu dhe unë duke ndjekur këshillën e tij e ktheva bagëtinë në shtëpi.

Dua ta provoj realisht veten për diçka, nuk dua t'ia di se për çfarë, mbase më vjen nga kujtimi i gjyshit që ishte

bujk a mbase nga bujku, gjyshi im që vinte me mua për të kullotur kopetë. Njeriu vërtet nuk e di se përse dëshiron të bëjë një punë aq të mirë. Mbase thjesht për jetën dhe për vdekjen.

Pastaj u ktheva në Vopnafjörður me kamion, shkova në një ballo ku sfidova kurvar Alfën në një kërcim e më pas fleta në varrin e poetit. Mirë, ornitologu po rri ende shtrirë në dyshekun e gjumit dhe po dremtit. Më mirë t'i bëj një kafe.

Dje, ne nxënësit e ndyrë shkuam te pishina dhe u lamë - ishim marrë me bagëtitë që pillnin një dhi dhe vinte një aromë e ëmbël, por pas një çike na erdhi për të vjellë.

Shpresonim që pishina nuk do të ishte e mbushur me turistë dhe ashtu doli; ishim vetëm ne dhe pamë një fajkua që luante te lumi i salmonit. Pimë kafe dhe u çlodhëm te vaska e nxehtë.

Në fshat vjen një kutërbim skumbrish. Fabrika gërhet natë e ditë. Ata tinguj janë të lezetshëm më thotë daja im i dashur; kjo do të thotë se në fshat ka jetë. Mbrëmë ishte në të mira; i ra fizarmonikës me një stil të veçantë, disi nervoz, por që të bënte të luaje me jetën tënde. Kërcyem ca në sallon e pastaj më tregoi pikturat e stërgjyshes duke më thënë që kishte qenë grua tepër e rafinuar. Në këto anë gjithçka e marrin me humor, e ndiej, por mundet edhe që të ketë ndonjë brengë, ndonëse bie krejt aromë tjetër nga distrikti i Þingeyjar-it, ku nyjet në fyt janë gjithnjë e më të hidhura.

Më dha një regjistër me emrat e vendeve dhe të disa dokumenteve me vlerë të shkruar nga ai vetë dhe nga disa të tjerë, të cilat i kishte mbledhur në dy dosje të trasha.

Më tha t'i mbaja. Mendonte se ishte më mirë t'i kisha unë, gjithnjë nëse do të pranoja. Çfarë besimi! Kështu, i thashë të bëja fotokopje të dokumenteve në Rejkjavik dhe t'ia dërgoja përsëri. Do ta mbaj patjetër fjalën.

U hodha një sy të shpejtë aty-këtu dhe ishin vërtet të çmuar. Ato bënë radhitjen e burimeve të ndryshme të disponueshme në “fermat fitimprurëse”, për grumbullimin, gjuetinë, koleksionim, gërmimet dhe përdorimin e të ardhurave shtesë: jorganë me pupla, vula, salmon, trofta, zogj deti dhe vezët e tyre, lëndë druri për energji gjeotermale, shpella, masa lehtësuese për peshkim.

Pastaj u nisëm për në Krossavik, ku kishte jetuar stërgjyshja bashkë me gjyshin tim. Një kushëri doli të na takonte përpara shtëpisë dhe na foli për vendin. Ai vinte çdo vit nga Gjermania dhe qëndronte në fermë me familjen e tij. Më informoi se të parët tanë kishin qenë të parët e vendit. Oh vërtet? Po, po, kështu thonë, u dëgjohej fjala në gjithë krahinën. Konkretisht, çfarë do të thotë kjo? Është një kategorizim për status ekonomik apo për stil poetik? Ne nuk ishim të sigurt, por u ndamë me një mirupafshim të përzemërt, e cila më kujtonte shkrimtarin Gunnar Gunnarsson. Që të dy e kishin njëlloj formën e buzës së poshtme.

Ishim shumë të uritur dhe te ferma e vjetër, u ulëm në një kafene gjithë zbukurime. Aty, gjyshja vidhte rrush të thatë dhe pasi e fuste në xhep rendte për te papafingoja e lodrave ku e ëma mbante ca lodra franceze të porositura me katalog: një burrë, i cili hidhej përpjetë po t'i jepje një hapje, si edhe një dyqan i vogël lodrash me karamelë të forta dhe kuti cigaresh. Babai i gjyshes mbante gjithmonë

cigare për miqtë. Kur paguan për cilësinë të del më lirë, thoshte. Praktikisht gjithnjë kishte pasur mundësi ta bënte. E pyeta gruan në detyrë nëse kishte dëgjuar ndonjëherë nëse stërgjyshi im kishte qenë harbut apo urdhërues. Jo; ai kishte qenë njeri i ndershëm dhe fotograf i zoti, më tha, ndonëse, me gjasa, pak i pispillosur. Besoj se gjeta edhe dhomën e miqve, ku pashë një sixhade dekorative dhe një shtambë mbi një tas xhami. Ndonjëherë, kur bëheshin shumë miq, fëmijët i vinin të flinin në tendë në oborr. Qeshnin pa kuptim dhe këndonin po ashtu vargje pa kuptim; e bënin që t'i zinte gjumi. *To ra lora lina, violina...*

Është e çuditshme të vish në një vend, për të cilin ke dëgjuar shumë. Tani që jam brenda vendit tim, ndihem akoma edhe më larg tij, se sa në kohën gjyshja na përshkruante çdo cep e çdo plasë të vogël, çdo ngjyrë e çdo figurë, sikur të ishte duke përshkruar jetën emocionale të asaj shtëpie në të njëjtën kohë.

Mora një broshurë mbi feramat në shqopishte dhe u krodha në përshkrimin se si njerëzit jepnin fjordin për shkak të mungesës së tokës- ndihem fajtores sepse vetëm kohët e fundit kam lexuar se si të parët e të parëve të mi në Bustarfell kishin zaptuar tokë; veç kësaj edhe për faktin që njerëzit ishin të detyruar të largoheshin dhe të vendoseshin nëpër kodra e nëpër kasolle.

Në katin e sipërm takuam një grua, e cila merrej me kërkime për këtë vendbanim dhe për historinë e tij. Edhe një burrë, i cili ishte kërkues në një qendër të vogël. Po qëndronim në dhomën ku kishin jetuar katra-katragjyshërit e mi e, ku të gjithë mblidheshin pranë stufë së madhe dhe prej nga ku mund të shihnin fermën

e vjetër nga dritarja. Këtu, ata u jepnin këshilla për drejtimin e punëve pasardhësve kanadezë të Islandës, të cilët ktheheshin në vendin e tyre të vjetër dhe donin të vizitonin fermat e familjeve të tyre. Dhe si reagojnë ? e pyeta. Me të vënë këmbën në tokën e të parëve, ia plasin të qarave. Po të tjerët, që ishin bashkë me ta, ç'kishin që qanin? Sepse ka një lidhje të fortë e të veçantë me historinë, e cila duket se i mallëngjen të gjithë, edhe kur nuk është tyrja.

Vopnafjörður Dita ADN-së

Vizituam një kushërirën tonë, e cila gjithnjë i dërgonte gjyshes kulaç, marmelatë dhe urime; na ftoi në një serrë të mrekullueshme lulesh. Ishte me xhama e prej andej mund të shihej i tërë fshati dhe fjordi, sigurisht edhe lulet, të cilat i rriste me një mjeshtëri të rrallë artistike. Me dëshirën e Perëndisë, është bërë shëronjëse dhe sapo ka mësuar një metodë të re, e cila besoj se do të më hyjë në punë për kërkimet e mia gjenealogjike: shërimi me ADN

Mbrëmë pasi u kthyem te tenda, unë u solla ca rrotull, ndërsa Zogu donte të më sillte një kanxhë në mënyrë që të më dukej vetja si komandante! Isha pak e shqetësuar pasi më kishte thënë se kishte frikë prej meje ngaqë jam tepër komanduese si natyrë. Kjo përshtypje i ishte krijuar qysh kur dëgjoi për ato historitë mbi familjen time, ku gratë ishin të pavarura, të pazakonta dhe po ashtu imponuese apo sido që ta quash...urdhëruese. Shënim për veten: kujdes nga kjo...

Kushërirra na tregoi për teze Salínan, e cila kishte mësuar gdhendjen e drurit dhe farkëtimin. Ajo gdhendte fragmente pikturash dhe qëndiste figura të rralla. I vëllai tha, kishte një ndjenjë të fortë konservimi dhe donte që shtëpia e vjetër në fermën e Bustarfell-it, të ruhej, prandaj e ktheu në muzeum pikërisht në atë kohë kur njerëzit

ishin në kulmin e përbuzjes ndaj fermave të vjetra.

Shkuam me makinë në Bustarfell. Është vërtet e këndshme të shkosh atje; ferma e vjetër është gjithë ajër. Vështruam njëri-tjetrin kur kuratori na tha se të dielave në mëngjes luhej gjithnjë në organo. Pastaj, duke pëshpëritur më tha se duhej ta rikthenim këtë zakon në shtëpinë tonë dhe të luanim disa prej këngëve të atyre mëngjeseve të dielash. Kështu është shkruar në librin e zakoneve të mira.

Kishte edhe një dritare të vogël, nga ku gjyshja kur zgjohej dëgjonte pulat dhe zbriste për te to. Kjo më bëri të mendoja për kuzhinën e papës në Avinjon, për oxhakun tetëkëndësh dhe për barnatoren. Mandej shkova te papafingoja e djemve dhe u kujtova për shkrimet e Guðfinna Þorsteinsdóttir-it nga Teigur-i, e cila e quante veten Erla Poetessa dhe përkthente *Muzikantët e humbur* të Uilliam Heinesenit. U kujtova se Guðfinna kishte shkruar, mes të tjerave, edhe për një burrë, i cili quhej Jóhan Lakuriqi, pasi kishte një prirje të fortë drejt ekzibicionizmit. Ky e kishte humbur fare mendjen, kishte braktisur fermën dhe sillej vërdallë me tetëmbëdhjetë dengje që i vareshin, mbushur me ushqime, ilaçe dhe bojë shkrimi. Ajo, gjithashtu përshkruan Jón Eyjólfsson-in, i cili, përpara se të merrte edhe rrugët kishte qenë punëtor ferme në Bustarfell. Stërgjyshja i kishte dhënë një porcion të madh qulli me qumësht deleje, pasi dinte t'i kulloste mirë. Prej tij, të gjithë shërbyesit dhe punonjësit e tjerë merrnin porcione shtesë. Jóni nuk pranonte, por gjyshja nguli që ta merrte patjetër me vete. Ai e futi në torbë bashkë me kostumin e tij më të mirë prej leshi ngjyrë të murrme. Por një tjetër punëtor i fermës, një njeri i lig e

xheloz, u përvodh deri te papafingoja dhe shkundi torbën. Kështu, kur Jóni e hapi, kostumi ishte llangosur i tëri me kima. Më pas, Jóni mori rrugën dhe e quajtën “violina”, pasi kishte mësuar çdo këngë përmendësh dhe kur donin të kërcenin, njerëzit i kërkonin të këndonte. Kjo ndodhte përpara se të mbërrinte fizarmonika; ai i njihte të gjitha ritmet, edhe ato automatiket e kohës. Ishte gjithashtu edhe postier jo zyrtar dhe, ndonëse nuk dinte të lexonte, ua çonte saktë letrat të gjithëve pa u ngatërruar kurrë. Si një gjysh i urtë, shtëpinë ua la atyre me më pak fat. Për vete mbahej me ushqimi dhe veshje nga banorët e fermave e kamura.

Na ftoi një tezja ime nga Bustarfell-i. Jeton ngjitur me fermën e vjetër, kësisoj ka mbetur brenda familjes siç kishte qenë qysh kur një fisi ynë, Úlfheiðu-i, ishte kthyer nga mërgimi dhe ishte vendosur në shqopishte ku kishte mbijetuar duke ngrënë myshk dhe trofta islandeze. Tezja na tregoi një dorëshkrim të historisë së Bustarell-it, ku e njëjta familje kishte jetuar qysh nga epoka e reformës. Doja ta shihja të botuar atë libër. Mandej e pyeta për ditarin e Salínas-it, pasi e zonja e shtëpisë në Refsstaður më kishte thënë nën zë se ekzistonte. Ishte tepër dramatike të shfletojë faqet e atij ditari, sa gati mbeta pa frymë dhe nuk dija ç’ të ngulisja më parë në kujtesë. Përmbante të gjitha llojet e recetave dhe fragmente raportesh. Pa emocione, vetëm rreshta. Mandej i hodha një vështrim punëve të saj të dorës. Disa ishin të pambaruara. Pas kthimit nga perëndimi, ku kishte shkuar të merrte të vëllanë, ajo vuante nga diçka dhe ishte sëmurë me ethet e tifos dhe encefalit. Me sa duket, nuk ishte aq e zonja si amvisë shtëpie, por ishte e aftë për të tjera gjëra. Por ne dimë

shumë pak. Thua ta ketë dashuruar të vëllanë aq shumë, sa nuk ishte në gjendje të donte njeri tjetër? Zogu më pyeti, duke më vështruar buzagaz. Sidoqoftë, puna shkoi që në fund vrau veten. Në qafë kam një varëse floriri me emrin e saj. Kam gdhendur mburojën time të shpresës.

Rrugës në kthim vizituam varrin e Salinas-it. Për një kohë të gjatë varri nuk kishte rrasë. Turp thua? Shkuam edhe te varri i Poetit të malit, i cili kishte vdekur nga pija në një papafingo pranë detit. *Terri zbret, dielli i mesdimrit ulet, një rune gjermanike e ngrysur me pamje mizore, qesh mbi dëborën e shtruar.*

Tani po nisemi. Dhe e tërë koha zhduket. Rruga jonë na shpie drejt lindjes.

Skriðuklaustur Sturlungsmas

Personi i parë që pashë kur u futa brenda ishte miku im i dashur Muggur-i. Me kostumin që kishte veshur dhe nga të çaluarit dukej shumë më i vjetër. Rrinte e skërmitëj pranë lumit. Doja të prekja rrjetën dhe t'i afrohesha, por u përmbajtja. S'ka prekje.

Te Djemtë e dheut, filmi, që ajo gruaja norvegjeze apo gjermane shfaqte nëpër gjithë vendin dhe tregonte kasolle të tipit Quonset dhe mjedise për mbledhje, ka një shprehje të mrekullueshme, teksa Muggur-i shikonte trishtueshëm ndërtesën e Borgut: Pas tij, fshati ishte i paqtë dhe i mirë, jeta ishte e qetë, por e mbushur me ëndrra fantastike për të ardhmen. Unë nuk e di nëse në këtë vend mund t'i afroresh edhe më tepër atij shkrimtari. Përpara pasdites, ndihesha sikur po e arrija, sikur rrija ulur me të për një kohë të gjatë në zyrën e tij dhe vështroja me fletët e kapura me ngjitëse. Ia shfletova ca disa prej librave dhe te *Vajtimet e Kasolles* gjeta disa vargje, të cilat më sollën ndër mend një ditë si kjo: Dita dhe nata, rryma të jetës, e cila lëviz pareshtur nëpër kalimet e pandjeshme të pasurive drejt një pronari apo një vdekjeje të re.

Mandej gëluan turistët me anijet turistike, disa autobusë dhe tingëllima instrumentesh mes publikut. A nuk mendoni se jeni me fat që përfunduat këtu në fund të ditës së festivalit rajonal? Gara me thasë dhe mundje me raven. Drejtuesi

i lojës bërtiste në mikrofon dhe zhurma mbërrinte deri te ne. Nga padurimi, unë shtrëngoja dhëmbët dhe mallkoja gjullurdinë.

Herë pas here kam përfytyruar të ulesha këtu në paqe e në qetësi dhe të lidhja veten time me vendin, të përpiquesha ta kuptoja këtë dëshirë të Gunnar-it për të qenë në krye të një prove. Ai u kthye nga jashtë si një shkrimtar i famshëm dhe u vendos këtu në thellësi të luginës. Ndoshta dëshironte të provonte veten para bujqërve të babait të tij, ndonëse ky kishte vdekur. Apo, pas vitesh të trazuar në Europë, u ngulit në këtë zonë, e cila e kishte rritur kur kishte qenë fëmijë. Në dukje, iu desh një kohë e gjatë që të gjente shtëpinë e duhur.

Doja të shëtisja përgjatë zonës dhe të gjeja një lidhje me të sepse, në radhë të parë, kjo nuk është ferma me godinat më të bukura; por jam e sigurt se ajo e shpalos veten pasi ke qëndruar ca më të gjatë. Te Sonata e Detit, Gunnar-i shkruante: gjatë një shëtitjeje të qetë me kalë nëpër banesat e hapura dhe në natyrën e egër, një vrojtues i vëmendshëm mëson gjëra, të cilat nuk do t'i mësonte dot ndryshe. Ata, të cilët duan të dinë si shikohet dhe si dëgjohet, natyra ua hap kanat dyert e saj, ditë dhe natë.

Po, do të ishte padyshim mirë të qëndroja këtu për ca kohë. Vetëm mos harro që nuk duhet të tradhtosh gruan e të mos biesh në depresion. Ata hoqën dorë pas nëntë vjetësh. Shtëpinë e mrekullueshme ia lanë qeverisë me marrëveshjen se do të kthehej në qendër për projekte të pasurisë kulturore, bibliotekë, vend kurash dhe galeri arti. Atje po bëhet një shfaqje për Gunnar-in dhe të shoqen. Por si mund të shkosh më pranë tyre?

Isha duke shqyrtuar ekspozitën mbi gjermimet në manastirin e vjetër. Në galeri, një djalë i vogël po sodiste

me shumë vëmendje dhe mandej, kur u përplasëm njëri me tjetrin, mbetëm të dy të shastisur. Ai u tmerrua shumë dhe dukej si i dërrmuar. I thashë se ashtu ndihesha edhe unë dhe morëm frymë thellë. Eh, e di ia bëri. Dhe shtoi se përpiqej ta shmangte për vete, por zakonisht harronte. Edhe unë, i thashë. Koncerti kishte filluar dhe hoqa dorë nga gjetja e një lidhjeje me shtëpinë. Dola jashtë në diell dhe u ula në kodër. Kisha bukë dhe ca trofta që m'i kishte dhënë gjyshja në Egilsstaðir. Gjithnjë më përgatiste ushqime të shijshme për drekën e piknikut. Shkonin shumë mirë me një birrë dhe me rock n'roll.

Në zonën ku ishin gjetur rrënojat e manastirit dhe të spitalit, pasdite grumbullohej turma dhe grupi *Zërat Thules* këndonte shërbesa të vjetra, vargje ëndrrash. Ishte e këndshme të kishte mundësinë të bashkoheshe me ta dhe të këndoje nën qiellin e hapur.

Sléttaleiti, Net Jupiteri

Në Sléttaleiti, në rajonin e Suðursveit-it morëm për pak ditë me qira një shtëpi të vjetër fshati. Ndamë me mirëkuptim hapësirën mes nesh duke zgjedhur atë që pëlqen më shumë për vete e që tjetrit nuk para ia ka edhe aq shumë ënda. lumtur Kështu, unë jam vendosur lart me pamje nga kodrat, ndërsa ai poshtë përballë detit. Zakonisht mua më pëlqen të shikoj detin, por mes tij dhe shtëpisë kalon rruga dhe më duket se kam më tepër vështirësi të shpërfill trafikun.

Për t'i bërë më të lehta gjërat mes nesh shkrova orarin ditor. Kur të zgjohemi, pasi të kemi ngrënë mëngjes dhe të kemi pirë kafënë, pasi të kemi ecur dhe peshkuar, do të bëjmë seks dhe do të flemë. E provuam gjatë atyre tri ditëve; e ndryshonim planin dhe gëzoheshim kur e zhvidhosnim krejtësisht dhe e përmbysnim kokëposhtë, por gjithsesi, ndarja e ditës në orare është tepër e rëndësishme. Të dish ta ndash në hapësira të drejta e siç duhet kohën, është kryesorja ndër gjithë të tjerat. Vetëm se kjo nuk mund të bëhet, një herë e mirë. Brenda çdo ndarjeje kohore duhet të ketë ca elasticitet, madje edhe brenda vetë hapësirës së ndarë duhet të ketë vend për diskutime. Edhe për këmbime opinionesh.

Mua realisht më pëlqen të zgjohem me të çelur agimi. Por tani e kuptoj se jam më tepër si Sesami te *Sonata e*

detit, i cili gëzohej “Næaeturnæði”, qetësi e natës. Unë as nuk e dija se ekzistonte kjo fjalë. Næturnæði.

Dej shkuam në Bjöllugil Ravine. Makina eci mirë duke u tundur nëpër zhurmën e lumenjve të akullt. Ndalua në një pikë furnizimi, nuk mund të ktheheshim dot pas për shkak të rrëshqitjeve të dheut dhe na u desh të merrnim një shteg të ngushtë, shumë pranë me buzën e përroskës. Atje u ndjeva e trallisur. Rastësisht kishim ndjekur gjurmët e një dashi dhe jo të një njeriu. Rrugës në kthim i mbushëm xhepat dhe çantat me thupra shelgjesh të verdhë. Zogu e citonte vazhdimisht Þórbergur-in ngaqë kishte lexuar librin e tij mbi këtë zonë dhe mbi banorët e saj, duke përshkruar çdo ngastër toke me mjeshtëri të madhe artistike.

Duket se pikërisht në këtë përroskë murgjit irlandezë, të quajtur *papar*, hidhnin zilkat e tyre dhe fluturonin për te kolonët Norse. Unë ndihem e ngazëllyer sërish nga këto historitë e ngulimeve të *papar*-ëve dhe tani, Bufi po dokumenton çdo shpellë të jugut. Por puna është se për vendbanimet *papar*-e nuk ka prova ose ka shumë pak, sepse ata janë praktikisht prehistorikë, si edhe të gjitha vendngulimet në Islandë. Vras mendjen se ç’lloj pamjeje do kenë pasur. Mundet, si gratë, si burrat, të mos e kishin vrarë mendjen për pretendime për të zotëruar tokën e për tu ngulitur. Dhe në këtë kuptim, ata nuk mund të konsiderohen, as si kolonë dhe, as si njerëz të tokave të pashkelura.

Në këtë shtëpi është këndshëm. Shkrimtari Einar Bragi, i cili gjatë fëmijërisë kalonte periudhën e verës, ia dhuroi Bashkimit të shkrimtarëve islandezë. Por unë nuk jam e sigurt në kishte pasur kaq shumë tokë. Të paktën, jo aq shumë pavarësi. Pasi këtu nuk ka asnjë vend ku të

hedhësh plehrat. Mbase plehrat janë një problem kudo në Islandë. Nga të mos kushtuarit vëmendje ndaj plehrave dhe progresit mund të sëmuresh.

Kisha vënë në plan të shkruaja, por u kapa pas leximit të disa botimeve të vjetra të gazetës *Birtingur* dhe artikujve të Einar Bragit. Dhe unë, gjithashtu kam krahasuar versione të ndryshme të poemave të tij. Ai i ndreqte dhe i botonte përsëri dhe udhëzonte lexuesit që të digjnin versionet e mëparshme. Kur lexova këtë më hipën të dridhurat; m'u duk se e kuptova realisht nga i vinte. Nga keqardhja. Apo nga detyrimi për të ndrequr. Nga ana tjetër është e pamundur të shkatërrohen versionet e vjetra; është e këndshme t'i lexosh të gjitha bashkë.

Mirë pra, në bazë të orarit, duhet të shkoj të pjek një fileto të vogël në qymyr, të cilën sapo e sollti Zogu im i dashur. Paskëtaj më duhet të bëj një shëtitje nëpër mal, të shkruaj dy orë dhe të përqafohem natën.

Sigurisht, njeriu nuk ka nevojë ta zotërojë tokën ku banon. Ka shumë shtëpi të bukura në të gjithë vendin dhe botën ku mund të rrish me fare pak shpenzime. Por, nisur nga pushteti i të drejtave të mia si anëtare e Bashkimit të Shkrimtarëve, unë rekomandoj që të bëhet diçka për plehrat. Të sigurohem që cikli është i rregullt. A nuk duhet të mendohet për cikle të rregullta në Islandë?

Peshku ishte i sapozënë dhe përdridhej në tigan. Spazma vdekjeje për darkë.

Nuk ka histori të re në lidhje me zbulimin e një rruge të vjetër, të cilën ushtarët e Boudica-s, mbretëresha e Druids-ve, kishte përdorur në betejat e saj kundër ligjeve romake. Jam e lehtësuar të mësoj se ata ende shohin rrugët, të cilat të shpien diku tjetër, përveç ekspansionit mizor.

Sléttaleiti në Suðursveit Saucemas

Këtë mëngjes shëtitëm andej poshtë nga muzeumi i Þórbergur-it dhe u habita kur pashë se sa pak libra të shkrimtarit kishte te raftet në papafingo. Shumica ishin pislleqe për turistët: jastëkë me zogj deti dhe bufë. Ku është shpirti i shkrimtarit? O Zot, merri të gjitha mbeturinat e paturpësive nga unë, mërmëriti Zogu. Ai vriste mendjen nëse dyqani turistik, një kasolle e vogël pranë muzeumit do të ishte i mbyllur. Kështu mund të ecësh nëpër botën e Þórbergur-it e jo në atë të dëshpërimit islandez ndaj turistëve, të cilët nuk blejnë sa duhet. Unë e di se mund të duket si arrogancë dhe marrëzi. Në fund të fundit, çfarë njohurish kam unë në lidhje me administrimin e një sipërmarrjeje? Po shkrimtari a mund të jetë pak më tepër i dukshëm?

Nga ana tjetër, kjo puna me shtëpitë e shkrimtarëve dhe artistëve është me të vërtetë diçka që të shtang. Dukuri e çuditshme. Është e dhënë faktike, se vetëm shtëpitë e meshkujve janë kthyer muzeume. Apo si? Për momentin, nuk më kujtohet shtëpia e një gruaje të vetme, që të jetë bërë muzeum. Mirë, Muzeumi Gerður mban emrin e një gruaje, por nuk ka qenë shtëpia e saj. Mbase mund të jetë anakronike të bësh muzeume për to tani. Do të ishte më me vend t'u kushtojë një hapësirë të caktuar të hapur? Apo? Mund të hapësh një muzeum, më tha nipi

i vogël kur po ecte nëpër kaosin tim. Të gjithë shtëpitë në një farë mënyre janë muzeume. Njerëzit rrethojnë veten me gjëra, të cilat u kujtojnë jetën që dikur dëshironin të jetonin.

M'u kujtuan shtëpitë muze: Hnitbjörg-u, shtëpia e Einar Jónsson-it, (ai dhe e shoqja flinin në shtretër të ndarë; ajo nuk kishte të drejtën e një shtëpie më vetëvetëm ai); Shtëpia me kube Ásmundur's dhe galeria Ásmundur, që të dyja kishin qenë shtëpitë e tij, me hapësirë të mjaftueshme për të gjithë; shtëpitë Halldór Laxness dhe Gljúfrasteinn Halldor me sallonin e njohur; Muzeumi i Skriðuklaustur-it dhe Sigurjón-it, si edhe rindërtimi i shtëpisë së Þórbergur-it te vendi ku kishte lindur. M'u kujtuan edhe shtëpi të tjera në këtë moment. Përveç, po, apartamentit të Bulgakovit në Kiev, i cili është një muzeum i paharrueshëm, aq i paharrueshëm, sa mezi më ka mbetur ndonjë kujtim. Por atje kishte me siguri një shpirt te gjërat. Te ai vend.

Kirkjubæjarklaustur Fillimi i kullotjes së kopeve

Pardje më doli në ëndërr kuarci i kuq që përdorej në shtypshkronja dhe mandej, në një ekspozitë pashë një pikturë, e cila lidhej me kuvendin që ka ekzistuar këtu. Sonte më doli në ëndërr bukurshkrimi, një grua me një rën dorë në fasha dhe me kokën të mbështjellë me fletë. Sot kundrova detin nga dera e kuvendit. Përbëhej nga një numër ndërtesash të mbledhura tufë. Kushedi, murgeshat që luteshin në qeli të ndara, dilnin e takoheshin në oborrin e manastirit apo në dhomën e punëdores. Jetesën e fitonin duke bërë punë dore. Mandej mendova për punimet e tyre dhe m'u duk sikur e kuptova më mirë shprehjen “puno dhe lutu”. Kjo duhet të ketë të bëjë në një farë mënyre me dashurinë. Në këtë kuvend, për një periudhë të caktuar kohe ka jetuar murgeshë Oddny, emnakja ime, e motra e prijësit Siguri i Bardhë. Të dy ishin të afërt. Si Osvaldi dhe Eba te Morthumbria dhe, në të dyja rastet, vëlla e motër kishin punuar fort së bashku për të ndërtuar një jetë të përkushtuar. Çështja shtrohet, nëse kjo lidhje vëlla e motër është apo jo një alternativë për vëllazërimin? A është ekskluzivisht thelbësore për vëlla- motërimin, siç është edhe për vëllazërimin? Mundet që guri i zbukuruar me gjethe të jetë shenjë e dashurisë ndërmjet vëllezërve dhe motrave që përfshin gjithçka, por nuk është kurrë përjashtues e s'mban gjë të fshehtë.

Së bashku shkuaam në një si punë kishe të hapur. Nuk u përfshimë dhe aq shumë, por gjithsesi diçka bëmë; atmosfera ishte dramatike. Një gur vullkanik heksagonal i ngrënë nga deti, kishte krijuar një platformë në mes të kullotës. Rrugës në kthim takuam priftin dhe ai na tha, krejt papritur, se celtët mblidheshin jashtë dhe se në traditat e tyre martesat kishte pasur një kuptim krejt tjetër. Unë rrenda pas tij dhe doja të dëgjoja më tepër, nëse kjo mund të jetë qenë një si traditë e dorës së dytë, e cila ekziston më tepër në nënvetëdije. Por ai kishte ngut; më tha se përpara mesnatës duhej të shkonte në tri vende.

Mbrëmë zhvillohej një festival rajonal dhe unë dhe Zogu, shoqëruesi im me pendë, përqipemi të shkojmë në të gjitha eventet, për të mbështetur kulturën vendore nga njëra anë dhe për të qenë në formë sportive nga ana tjetër. Atje, të gjithë artistët ishin tepër të angazhuar; organisti luante gjithë kohën, këndonte kori i kishës, projektoheshin filma dhe zhvilloheshin koncerte. Zogu më pyeti nëse kisha dëshirë të bënim një shfaqje të mirë në atë festival, por unë i thashë se duhej të vizitonim muzeumin dhe tregun e artizanatit Atje dëgjova dikë që fliste për djegien e plehrave dhe për pasojat e ndotjes. Politikë dhe ndotje vendore. Mandej, një banor i zonës më tha se dikur murgeshat shkonin e takoheshin me murgjit, të cilët jetonin në Álftaver; aty, njëlloj si pulëbardhat e veriut, çiftëzoheshin në shpella të vogla në shkëmbinj të zi dhe kakariseshin nëpër natë.

Skógar-i poshtë Eyjaföll-it Festa e rënies së kryqit

Po përpiqem të rri e qetë dhe të mbaj frymën, por nga sytë më dalin lot dhe në gojë kam një si nyje. Po shikonim lajmet dhe i pari fare, ishte ai i shitjes së Hólsfjöll-it. S' u besojta dot syve. Telefonova në shtëpi dhe fola me babain dhe nënën; ishin mërzitur, por thanë se për fat të mirë, nuk ishte shitur ende. Vërtet ishte nënshkruar vërtet një kontratë detyruese, por që nuk mund të kishte vlerë ligjore, pasi bëhej fjalë për shitje sipërfaqeje tepër të mëdha terrenesh ndaj blerësve të huaj.

Vëllezërit e babait, vëllezërit në familjen që e kishte birësuar, mendonin se nëse një tokë, të cilën ua kishte lënë gjyshi donin ta shisnin apo ta punonin vetë, ishte çështje e tyre private.

Në lajme, një zëdhënës deklaroi se ky ishte një investim tejet pozitiv dhe se pas këtij do të ofroheshin edhe sipërmarrës të tjerë, çka do të thoshte se veriu ishte i sigurt. Poho! Gjithashtu se sipërmarrësi kinez nuk synonte të fitonte; ai ishte një idealist romantik dhe ruajtës i natyrës. Sa mirë dinë ta heqin veten! Të gjitha këto i kisha dëgjuar edhe më parë, i dashur. Jo më kot kam studiuar evoluimin e lordëve modernë kolonialë. Veç kësaj, e ka shikuar njeri kontratën? A ka ndonjë pikë, e cila parashikon ruajtjen e mjedisit? Cilët janë ndërmjetësit e kësaj kontrate? Konkretisht, me emër. Nuk do të habitesha aspak nëse

janë të përlyer në korrupsion, si shumë kohë më parë kur një marrëveshje e mirë sipërmarrjeje bëhej në interes të publikut. Gjëja më e keqe është se disa njerëz, praktikisht besojnë se kjo do t'u sjellë ndonjë thërmijë. Aq më tepër u duhet kujtuar se nuk jemi një popull që po vdesim urie. Ai që s'pranon të të shpëtojë u djegtë në zjarr, mund të thuhej shumë kollaj për një rast të tillë. Po Snoop Dogg-u çfarë ka thënë? *Ngrijini ato drejt duar drejt qiellit?*

Dhe Stjani, poeti malësor, Kristján-i ynë, çfarë do të kishte thënë?

*Krejt i vetëm në acarin e natës,
Sillem nëpër rërën e shkretuar.
Shtëpi nuk kam, asgjë s'kam më
Veriun sytë ma kanë harruar.*

Pingvellir

Një komplot korbash

Gurë e driza nga dalin manaferra

Jam në një kasolle druri me pamje nga liqeni Skjaldbreiður . Ejola më ka ftuar të rri këtu në shtëpinë e saj. Mbrëmë më tha se i duhet të largohet dhe më pyeti nëse kisha dëshirë të rrija, po qe se doja qetësi.

Mes të tjerave, biseduam se sa shumë është bërë në Islandë qysh nga rrënimi ekonomik. Dheu ishte më pjellor dhe i mbushur me filiza të bukur. Por ato do të kenë gjithmonë nevojë për ushqim dhe ti duhet të ushqesh familjen tënde më tha. Familjen time të vogël? Është mirë t'i bëj të gjitha planet tani, kur ora biologjike po më rreh akoma. Këtu shoh hënën, sapo doli nga një re, e verdhë në të kuqe dhe thujse e plotë.

Këtu s'kam fare frikë. Ngrohtësia e miqësisë e mbush tërë vendin. Librat, muzika dhe shtatë korbat të bëjnë ta ndiesh nëse po afrohet ndonjë rrezik. Dhe një buf i mbushur, i cili e di se si janë gjërat.

Pi çaj të gjelbër, ha alga deti të kuqe flakë dhe bajame.

Zogu do të vijë të më marrë nesër. Më ka marrë malli, por them se është mirë që njeriu të rrijë ca vetëm, të mendojë e të vrojtojë pozicionin e diellit, siç thotë mamaja.

Dola jashtë herët dhe mbusha një kaçile me manaferra dhe boronica. Dua të ulem vetëm, të ha boronica me

krem, të mendoj për ekzistencën, të kundroj liqenin; nuk është vend edhe aq i keq për të jetuar. Pardje më telefoni gjyshja dhe më pyeti në mund të kisha mirësinë të kaloja nga dyqani dhe t'i blija ca boronica dhe një çikë krem; i kishte ardhur një neps i paparë. Njëloj si edhe mua. Ishte një telefonatë vërtet e pazakontë. Kur mbërrita tek ajo, e gjeta që po jepte shpirt.

Ajrosa shtëpinë që të ndihej më mirë. U përpoqa të bëja ashtu siç bënte mamaja kur sëmuresha unë; merrte me një pece të lagur dhe ma vinte mbi ballë, pastaj më lante fytyrën e më rregullonte jastëkët.

Nuk jam tamam e hidhëruar, por ndihem thellësisht e humbur. Tani edhe njeriu më gallatë në botë për mua, po largohet.

Te përmendorja, poshtë bustit të poetit, me të cilin ajo ishte e lidhur shpirtërisht, ishte shkruar një varg nga një poemë e tij: nëse takon nënën time, kudo që të jetë, përshëndete nga unë me një pëshpërimë.

Po, do ta bëj e dashur, me kënaqësi. Dhe mbase do të të pyes, nëse do të takosh gjyshen time me kapelën e bardhë dhe ajo nuk e di ku po shkon, të lutem, a do t'ia tregosh rrugën për në shtëpi? Po ku ishte shtëpia e saj? Ku jetoi në këtë tokë? Ku kaloi më tepër kohë? S'e kisha pyetur kurrë.

Pingvellir.

Ekuinoksi i vjeshtës

Këtu pranë shtëpisë ka një trampolinë dhe përpara se dielli të thotë mirupafshim unë heq këpucët dhe kridhem duke vështruar ishujt. Është disi e çuditshme të hidhesh e vetme e për një kohë të gjatë Mendoja që nëse do të kisha fëmijë, do t'i paralajmëroja të hapnin sytë nga shufrat metalike. Vrava mendjen nëse është e mundur të vesh disa jastëkë mbrojtës rozë të fortë apo të mbjellësh myshk në tërë gjatësinë. Gjynah sa keq e kanë lënë myshkun. Më kujtohet gjyshja kur më tregonte se si bashkë me motrën në periudhën e Krishtlindjes silleshin nëpër kodrinat e pyllit të veshura e të bëra dëng me rroba leshti dhe lëshoheshin poshtë në dëborë. Unë zija e qaja. Gjë e çuditshme të hidhesh dhe të qash në të njëjtën kohë.

Mendoja se si, nëse i Gjithëfuqishmi dhe natyra do të vendosin që të bëhem me fëmijë, është tepër vonë t'ia tregoj gjyshes dhe që ajo t'u thotë vjersha. Por unë e shkunda mirë, u hodha pak më tepër dhe vendosa të përpiqem t'i mësoj vetë ato vjersha. Do të bëj çmos t'ua përcjell tërë gëzimin e saj. T'u dhuroj një pjesë të atyre kujtimeve të bukura.

Gurët e varrit Bellmas-i nën qiell të hapur

Gjatë pelegrinazhit nëpër Islandë, shumë përpara se të mbërrinin në fjordin e bukur dhe të frikshëm Berufjörður, pashë përmendoren e Kristján poetit në Djúpilækur. Mbishkrimi thoshte se lutjet e Kristján-it për Zotin, që konsistonin në fjalët bukur, qetësi, mirësi, janë me “i” në fund. Dhe do të ishte këndshëm të dije se çfarë ka në mendjen e ujit.

Bufi hapi gurët e varrit. Së pari gjeti një palë tespihe të mrekullueshme të shkuara në tel dhe një kordon ombelikal të lashtë. Mandej gjeti një grua të vjetër me një dhëmballë pjekurie të veshur dhe gjunjë të mbledhur. Dukej se u përkiste viteve 700. E nga kuptohet? Epo, e tregon shtresa vullkanike. Mbi varr gjendet hi që nga viti 730. Mandej doli në dritë një zilkë e vogël- po s’thuhet dot me siguri, pasi është ende e mbuluar me baltë dhe nuk mund të pastrohet përnjëherë. Specialisti i objekteve beson se duhet të jetë një zile shtëpie. Për të njoftuar të zotin e shtëpisë për orarin e lutjeve.

Me gjithë Zogun po rrimë në një çadër aty pranë. Çadra është e mbushur me gjethe dredhke, nuk e vure re? më pyeti. Unë qëndroj shtrirë brenda dhe shikoj ëndrra mbi varrin e hapur. Çfarë do të zbulohet akoma dhe çfarë do të thotë kjo? Ndihem tepër e ngazëllyer që jam gati të shpërthej. Varre pagane dhe hyjni të varrosura, varre

pagane dhe hyjni të varrosura.

Ata dolën për një shëtitje nga kodrat këtu pranë, kurse unë do të marr një sy gjumë, gjysmë zgjuar, gjysmë dremitur. Poshtë meje, nën dhé, ka forma, të cilat s'ma lenë mendjen të qetë. Pesëkëndësh të gjelbër të errët. Tetëkëndësh ngjyrë bakri. Katrorë blu të thellë. Një fermë e krijuar në shumë forma. Nga shtyllat e avullit të fermës demokratike, më mbërrin duhma e barnave mjekësorë; jo, nuk po flas për fermën e Commonwealth-it por për fermën demokratike. Ndonëse nuk e kam idenë se ku duhet të ndërtohet një fermë e tillë, e di se atje do të kem paqe dhe qetësi. Nëse s'është tepër vonë. Shfarosësit e mallkuar. Jo, nuk qortoj të tjerët. Por as nuk i harroj. Mos i mbyll gjërat. Lere drejtësinë të ngrihet nga toka. Këto ëndrrat më kanë çorientuar. Them të dal nga çadra, të zvarritem, të shkoj te gurët e varrit dhe të shikoj brenda. Mbase shtrihem e rri për disa çaste që të shoh nëse do më dalë në ëndërr ndonjë gjë e këndshme. Përtej varrit tim, etje, ftohtësi. Nderin tonë e ka zënë myku.

Gurë varri,
Dita e zogjve shtegtarë
që fluturojnë në formë V-je dhe festa e Shën Françeskut,
i cili kuptonte gjuhën e zogjve


Duhej të më kishte zënë gjumi në varr dhe duhej të më kishin rënë ca papastërti mbi vete. U zgjova dhe m'u bë sikur po më merrej fryma, por ornitologu dhe arkeologu më ngutën. Më ngritën siç ngrihet një plakë e sëmurë. M'u desh një moment sa të merrja veten e të shkundesha M'u bë sikur George Batalle-i dhe Michel Leiris-i ishin pas meje dhe përpiquesha t'u përgjigjesha-oui, oui. Mandej dëgjova Leiris-in që tha gjithë mençuri: *Et j'ai choisi, pour le signe sous lequel les placer le nom tout a fois floral et souterrain de Perséphone, arrachéphone, arraché ainsi à ces noiseur terrestres et haussee jusqu'au ciel d'une tête de chapitre...*

Pastrova papastërtitë nga qafa dhe goja dhe u ula në gjunjët e ornitologut siç më ishte parashikuar për të ardhmen. Më thanë se ne duhet të ndërtojmë një fermë për vete si ato të shekullit të katërmbëdhjetë, në një zonë të egër, me një banjë avulli dhe me shtypshkronjë, ku kujtimet e stinëve të shtypen dhe almanakët të rilinden. Më thanë gjithashtu, se ne duhet të jetojmë me familjet tona dhe me miqtë e mirë, të ngremë një ekonomi shtëpiake të qëndrueshme e me kulturë të konsoliduar, duke përdorur teknologjinë e fundit, të krijojmë një miqësi të rrënjosur

thellë e të lidhur me tokën, por me dyer të hapura ndaj detit.

Familja jonë e zgjeruar mund të jetojë herë në ndonjë zonë të egër, herë në shpellë apo në pemë, herë në ishull a në bregdet dhe ne duhet të varemi nga ciklet tona natyrore që na lidhin me detin dhe me tokën, parajsën dhe ferrin, i thashë. A ka gjasa të jetë e mundur ? Po, sigurisht, kjo patjetër që mund të jetë e mundur për të lëvizur nga një vend te tjetri, duke ndryshuar gjërat, thanë ata.

Mund të fillojmë të ndërtojmë një shtëpi zogjsh, me lutjen e vjetër të varur te dera: Paçi sa më pak shqetësime e sa më tepër bekime dhe në atë derë të trokittë vetëm lumturia.



Plani i rrënojave

Festat islandeze te Vendi i dashurisë dhe rrënojave

Dita e parë e verës (is. *Sumardagagurinn fyrsti*): Një feste publike e përvitshme në Islandë, e cila kremtohet të enjten e parë pas 18 prillit. Tradicionalisht, ka qenë një festë e rëndësishme, ku njerëzit këmbenin dhurata dhe shtronin darka, por sot festimi i saj ka rënë (përveç ceremonive publike, paradave etj).

Festa e kryqit (is. *krossmessa á vori*) 3 maj; përkujton zbulimin e kryqit të vërtetë të Krishtit në Jeruzalem, nga Shën Helena (252-330 p.k.) nëna e perandorit romak Konstandinit të Madh (272-337). Për islandezët, është një ditë “prekëse” ku bujqit dhe punëtorët shtëpiakë ndryshojnë punëdhënësit.

Dita e qerasë (is. *eldaskildagi*) 10 maj, dita kur dhentë e marra me qera, pasi kanë ndenjur gjatë dimrit me të zotët e fermave dhe priftërinjtë, në pranverë kthehen te pronarët e tyre. Është dita kur mblidhen qeratë.

Dita e Republikës së Islandës: (is. *lýðveldisdagurinn*, që gjithashtu quhet *Djóðhátiðardagurinn* apo “Festa Kombëtare”) 17 qershor; përkujton themelimin e Republikës së Islandës dhe pavarësinë nga Danimarka) në po atë ditë, më 1944.

Festa e prerjes së kokës: 29 gusht; përkujton martirin e Johan Pagëzorit, të cilit iu pre koka me urdhër të Herod Antipasit me kërkesën e Salomesë, vajzës së gruas së tij dhe kësaj të fundit.

Festa e Shën Gallit: 16 tetor; sipas legjendës, misionari irlandez Shën Galli (550-646 pas.k) mbante nga pas një ari, të cilin e kishte hasur dhe zbutur një natë në një pyll, në atë zonë ku sot ndodhet Zvicra.

Festa e dimrit të Shën ÞORLÁKUR-it: 23 dhjetor, Þorlákur Þorhallsson (1133-1193), ishte një ipeshkëv nga deti i Skálholt-it në Islandën e jugut dhe është shenjtori mbrojtës i Islandës (Zyrtarisht i njohur si shenjtor nga Kisha katolike në vitin 1984).

ÞORRI: Emri i muajit të katërt të dimrit sipas kalendarit të vjetër islandez, mesi i janarit-mesi i shkurtit

Dita e burrave të shtëpisë (isl. *Bóndadagur*): dita e parë e muajit në Þorri. Në këtë ditë, i zoti i shtëpisë, duhej t'i uronte mirëseardhjen muajit duke rendur jashtë i veshur vetëm me një bluzë, duke futur vetë njërën këmbë në ndërresat e gjata dhe duke e tërhequr tjetrën zvarrë. Sot, ditën e *Bóndadagur*-it, “e zonja e shtëpisë” thuhet se duhet ta trajtojë partnerin jashtëzakonisht mirë me dhurata e vëmendje.

Dita e Lutjes (isl. *Bænadagur að vetri*): në Islandë, të shtunën e katërt pas Epifanisë (fundi i janarit) kur në kishë lexohet pjesa nga Ungjilli (Mateu 8:23-7) Jezusi

qetësoi detin dhe erën dhe lutjet drejtohen në veçanti për peshkatarët, përpara fillimit të sezonit të peshkimit në dimër, më 3 shkurt.

Dita e rishfaqjes: 2 korrik (ndonëse me rishikimin vitit liturgjik nga ana e Papës më 1969, ka kaluar në 31 maj); është festa kur përkujtohet vizita e Marisë shtatzënë me Jezusin të Elizabeta, kushërira e saj, e cila ishte shtatzënë me Johan Pagëzorin. Në bazë të Ungjillit sipas Llukës, Johani, duke njohur natyrën hyjnore të Jezusit kërcëu nga gëzimi në prehrin e Elizabetës deri në atë pikë sa kjo e fundit e bekoji Marien, e cila iu përgjigj me manjifikatin (“Shpirti im lëvdon Zotin”, një psalm, i cili këndohet në këtë ditë feste.

Dita e mesverës (Isl. *Jónsmessa*): 24 qershor; gjithashtu edhe disa e Shën Johanit (Festa e lindjes së Johan Pagëzorit).

Dita e zonjë së shtëpisë (isl. *Konudagur*): Njëlloj si *bóndadagur*-i (Dita e të zotit të shtëpisë), gratë trajtohen jashtëzakonisht mirë nga burrat dhe të dashurit. Kjo ditë, gjithnjë e dielë, shënon fillimin e muajit të *Góða*-s, muaji i pestë i kalendarit të vjetër islandez (java e tetëmbëdhjetë e dimrit, e cila përkon me mesin e shkurtit dhe mesin e marsit).

SKERPLA: Emri i muajit të tetë sipas kalendarit të vjetër Islandez, i cili përkon me 21 majin.

Festa e verës së Shën ÞORLÁKUR-it: 20 qershor, përkujton transferimin e relikteve të tij në atë ditë në vitin

1198 (shih më sipër Shën Þorlákur-i).

Festa e Shën Françeskut: 4 tetor. Thuhet se italiani Shën Françesku nga Asizi (1181-1126) kishte një dashuri të madhe për të gjitha kafshët e në veçanti për zogjtë.

MBI AUTOREN

ODDNÝ EIR, ÆVARSDÓTTIR KA LINDUR NË VITIN 1972. Ka kryer doktoraturën në Universitetin Paris-Sorbonne, si edhe disa kërkime studimore mbi muzeumet e Islandës. Ka shkruar tre romane autobiografikë, ka përkthyer libra dhe ka botuar punime mbi letërsinë. Ka organizuar veprimtari mbi artet pamore dhe ka hapur një hapësirë të arteve pamore në Nju Jork dhe Rejkjavik (Dandruff Space) në bashkëpunim me të vëllain, Uggi Ævarsson. Së bashku, drejtojnë shoqërinë botuese Apaflasa (Monkey Dabdryff). Autorja ka punuar edhe si redaktore në Web site-n Náttúra,info. Heim til míns harta, u kandidua për çmimin kulturor të gazetarisë DV në vitin 2009. Vendi i dashurisë dhe rrënojave (Jarðnæði) kandidoi për Çmimin e Letërsisë islandeze në vitin 2001 dhe në vitin 2012 fitoi Çmimin letrar për autoren grua.

Xhimi Lazri

Xhimi Lazri është një përkthyes me përvojë. Numëron mbi 50 libra të përkthyer, ndër të cilët:

- Svjetljlana Aleksejeviç: “Lufta nuk ka fytyrë gruaje”
- Mo Yan: “Ndryshime”
- Nadine Gordimer: “Një armë në shtëpi”
- Ahmet Hamdi Tanpinar: “Instituti i rregullimit të kohës”
- Tahar Benzhalun: “Nata fatale”
- Lu Hsin: “Thirrje për armë”
- Elif Shafak: “Kopilja e Stambollit”
- Zhorzh Simenon: “Lufta e nervave e Komisarit “Megre”
- Orhan Kemal: “Batakçiu”
- Melania Macuko: “Vita”
- Mario Levi: “Stambolli ishte një përrallë”
- Tahsin Yucel: “Vatandaş”
- Zhak Atali: “Të bëhesh vetvetja”
- Ahmet Umit: “Porta e dervisheve”
- Davide L’Hermitte: “I përjetshmi Majkëll Xhekson”
- Enis Batur: “Molla”
- Adrienne Rich: “Lindur nga gratë”
- Murat Uyrkulak: “TOL Historia e një hakmarrjeje”
- Raffaele Nigro: “Ditari për Shqipërinë”
- Gul Irepoglui: “Kopshti i tulipaneve” Hija ime”
- Xhuzi Kuçari: “Burrin e sotëm mos e lër për nesër”
- Ayfer Tunç: “Këto çikërrima të viteve 70”
- Clodine Galea: “Dashuria e një gruaje”
- Hakan Bıçakçı: “Një vrimë në apartament”
- Annelies Verbeke: “Fli”

- Sibel K. Turker “Vdekja e poeteshës”
- Tiziano Ferro “Tridhjetë vjeç dhe një bisedë me babanë”
- Hande Altaly “Djali luan me dashurinë”
- Muge Iplikçi “Lajmëtari”
- V.Ceruzo & P.Comito
& B. De Stefan “Bosët e rinj të mafias
- Birgül Oğuz “Hah”

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Eir, Oddny

Vendi i dashurisë dhe i rrënojave / Oddny Eir ;
përkth. Xhimi Lazri ; red. Rexhep Hida. – Tiranë :
Fan Noli, 2017 ... f. ; ... cm.

Tit. origj.: Land of love and ruins

ISBN 978-9928-203-98-4

1.Letërsia islandeze 2.Romane

821.113.3 -31